

Shtëpia Botuese Hakikat, vepra No: 3

RREFIMET E AGJENTIT ANGLEZ

**dhe
Armiqësia e Anglezëve Ndaj Islamit**

Përkthyer në turqisht
M.Sıddîk Gümüş



Hakikat Kitâbevi

Darıüşşefeka Cad. 53/A P.K.: 35

34083 Fatih-İSTANBUL/TÜRKİYE

Tel: 90.212.523 4556-532 5843 Fax: 90.212.523 3693

<http://www.hakikatkitabevi.com>

e-mail: info@hakikatkitabevi.com

JANAR-2025

Miratuar nga drejtoria e Xhami'ul-ez'her:

Shoqata Ihlas në Turqi është e lejuar të botojë dhe të shpërndajë pesëdhjetëdy librat, titujt e të cilëve kalojnë në referencat e këtij libri.

El-Kahire 14.12.1994

Ez'heri sherif idaretul-buhus
vette'lvetterxheme mudir-i am K.K

Këshillë: Misjonerët mundohen të përhapin krishtërimin, Çifutët mundohen të përhapin fenë dhe mëndimet e tyre të shtrembëra, shtëpia botuese Hakikat me qendër ne Stamboll mundohet të përhapë Islamin, ndërsa masonët mundohen të zhdukin fenë. Ata që janë të mençur e të ditur arrijnë ta kuptojnë se cila nga këto është e drejtë dhe duke ndihmuar për përhapjen e kësaj bëhen shkak për shpëtimin e të gjithë njerëzve. Nuk ka shërbim më me vlerë për fenë sesa ky shërbim që i bëhet të gjithë njerëzimin.

Shtypi:

İhlâs Gazetecilik A.Ş.
Merkez Mah. 29 Ekim Cad. İhlâs Plaza No: 11 A/41
34197 Yenibosna-İSTANBUL Tel: 90.212.454 3000

ISBN: 978-975-8883-24-0

PARATHENIE

Allahu teala në Kur'anin kerim në ajetin e 82 të sures Maide thotë: "Armiqtë më të mëdhenj të Islamit janë Çifutët dhe Mushrikët (ata që i bëjnë shok Allahut)". Ai që ka nxjerrë shpifjen e parë për ta shkatërruar Islamin nga brënda ka qenë çifuti nga Jemeni Abdullah bin Sebe. Krijoi sektin (**Shi'i**) si alternativë e (**ehli synetit**) që është Islami i vërtetë. Çifutët që dalin në pah çdo shekull si dijetarë të sektit (**Shi'i**) vazhdojnë ta fuqizojnë këtë sekt. Për dëmet që Çifutët i kanë bërë Islamit flitet gjatë në librat: (**Hijanetu-ul-jehud**) i botuar në Kuvajt nga (**Mektebet-us-sahabet-il-islamijje**), dhe në librin (**Err-rrexhlus-sanem**) të botuar në Bejrut. Pas ngjitjes në qiell të Isait "alejhis-selam" dhe me shkrimin e Ungjillëve të gabuar shumica e Krishterëve u bënë (**Mushrikë**). Ata që nuk u bënë mushrikë, për shkak se nuk i besuan Muhammedit "alejhis-selam" u bënë (**kafirë**). Këtyre dhe Çifutëve u thuhet (**Ehli kitab**). Me zbritjen e Islamit priftërinjtë e humbën pushtetin e tyre që kishin në periudhën e mesjetës. Këto për të zhdukur Islamin krijuan bashkësi misionerësh. Ato që përparuan më shumë në këtë drejtim ishin Anglezët. Në Londër u krijua posaçërisht **Ministria e Kolonive**. E kanë sulmuar Islamin me ushtri, politikë dhe hile çifutësh që nuk i arrin mendja e njeriut. Hempher është vetëm një nga mijëra agentë Anglezë që punonte nën urdhërat e **Ministrisë së Kolonive**. Ky në vitin 1713 (Hixhri 1225), u njoh në Basra me 14 vjeçarin Nexhdi Muhammed, e mashtroi atë për vite me radhë dhe e bëri që të krijonte sektin **Vehabi**. Në vitin 1737 (Hixhri 1150) me urdhër të **Ministrisë së Kolonive** e shpallën haptazi këtë sekt të ri.

Hempher është një misioner Anglez, i cili nën urdhërat e organizatës Angleze të Kolonive ka kryer detyrën e agentit në Egjipt, Irak, Iran, Hixhaz dhe në Stamboll, në qendrën e Islamit, me qëllim për të mashtruar muslimanët dhe për t'i shërbyer Krishtërit. Armiqtë e Islamit sado shumë që janë përpjekur të zhdukin Islamin asnjëherë nuk kanë për t'ia arritur qëllimit të tyre për shuarjen e këtij nuri (drite)të Allahut, sepse Allahu teala në Kur'anin kerim në ajetin e 9 të sures **Hixhr** ka thënë : "Ne ta dërguam ty këtë Kur'an. Patjetër Ne do ta mbrojmë atë". Pra ka thënë: Kafirët nuk do të mund të vejnë dot dorë mbi të, nuk do të mund ta dëmtojnë dot atë, kurrë nuk do të arrijnë ta shuajnë dot atë nur. Muslimanët për 14 shekuj me radhë duke ndjekur rrugën e ndritur të Kur'anit kerim, kanë përparuar në dituri, shkencë, kulturë, zanat, tregëti, politikë etj. Kanë ndërtuar perandori të mëdha e të fuqishme. Rreth vitit 1789 (Hixhri 1204) pas revolucionit Francez shumë të rinj të Krishtere duke vënë re shthurjen e kishës dhe të priftërinjve, tiraninë, vjedhjet dhe gënjeshttrat e tyre, filluan të bëhen muslimanë ose të pafe. Me largimin nga feja të Krishterët filluan të përparojnë në shkencë, sepse Krishtërimi bëhej pengesë për zhvillimin e shkencës dhe diturive të nevojshme për jetën. Edhe disa muslimanë që kanë lexuar librat e

këtyre të rinjve që shajnë të gjitha fetë dhe librat mashtruese të Anglezëve, janë bërë të paditur dhe janë larguar nga feja. Me largimin nga Islami filluan të prapambeten në shkencë, sepse Islami urdhëron njerëzit që të përparojnë në shkencë dhe të punojnë për këtë botë.

Baza e politikës Angleze është të përdorë për përfitimet e saj dhe të çojë në Angli pasuritë e të gjithë botës e sidomos të shteteve të Afrikës dhe Indisë dhe gjithashtu të përdorë si skllavër njerëzit e këtyre shteteve. Ato që përqafojnë fenë Islame e cila urdhëron drejtësinë, dashurinë për të tjerët dhe ndihmesën e të varfërve, u bëhen pengesë Anglezëve në qëllimet e tyre dashakeqe.

Këtë libër e kemi përgatitur të ndarë në tre pjesë:

Pjesa e parë janë rrëfimet e agjentit Anglez. Në këtë pjesë tregohen gënjeshttrat dhe planet e poshtra të Anglezëve për të zhdukur Islamin. Kjo pjesë përbëhet nga shtatë ndarje.

Në pjesën e dytë tregohen, vënia në jetë e planeve të poshtra të Anglezëve, mashtrimet që i kanë bërë drejtuesve të shteteve për t'i detyruar të punojnë për to, torturat e paimaginueshme që i kanë bërë muslimanëve dhe mënyra se si kanë shkatërruar Indinë dhe Perandorinë Osmane. Kjo pjesë është mbushur me argumenta të dijetarëve të ehl-i synetit që do t'i shërbejnë muslimanëve të cilët janë mashtruar nga Vehabitë, që të zgjohen dhe të kuptojnë të vërtetën.

Pjesa e tretë është përkthyer nga **“Hulasat-ul-kelam”** dhe argumenton se feja e vërtetë është Islami.

Sot muslimanët në të gjithë botën janë ndarë në tre grupe. Grupi i parë janë muslimanët e vërtetë të cilët ndjekin rrugën e Es'habëve kiram. Këto quhen **“Ehl-i synet”** ose **“Syni”** ose **“Firka-i naxhije”**. Grupi i dytë janë ato që janë kundërshtarë të Es'habëve kiram. Këto quhen **“Shii”** ose **“firka-i dal-le”**. Grupi i tretë janë armiq edhe të Synive edhe të Shii've. Këto quhen **“Vehabi”** ose **“Nexhdi”**, sepse këto për herë të parë janë shfaqur në qytetin Nexhd të Arabisë. Këto quhen **“Firka-i mel'une”**, sepse në librat **“Kiyamet ve Ahiret”** dhe **“Seadet-i Ebedije”** shkruhet se këto i quajnë muslimanët mushrikë. Pejgamberi i ka mallkuar ato që i quajnë muslimanët kafirë. Një person që i përket cilitdo nga këto tre grupe n.q.s i bindet vetëm nefsit të tij dhe nuk e ka zemrën të pastër, atëherë fundi i tij është xhehenemi. Çdo njeri për të pastruar zemrën e tij nga gjynahet dhe nga kufri duhet të thotë sa më shpesh **“La ilahe il-lall-llah”** dhe për të mbrojtur zemrën nga shejtani, shokët e këqinj dhe kufri që vjen si pasojë e leximit të librave të dëmshëm duhet të thotë sa më shpesh **“Estagfirrullah”**. Duatë që janë në përshtatje të ligjeve të Islamit pranohen patjetër. Ato që i kanë përçarë muslimanët në këto tre grupe janë Cifutët dhe Anglezët.

Shënim: Shkrimet brënda kllapave katrore [] janë të shtuara nga autori.

**Pas eres së re
2001**

**Hixhri shemsi
1380**

**Hixhri kameri
1422**

Pjesa e Parë

NDARJA E PARE

Hempheri thotë: Britania jonë e Madhe është shumë e madhe. Dielli lind mbi detet tona dhe perëndon po mbi detet tona. Pushteti jonë është pak i dobët në Indi, Kinë dhe në kolonitë tona në Lindjen e Mesme. Këto shtete nuk janë plotësisht nën pushtetin tonë, por këtu ndjekim një politikë shumë të suksesshme. Të gjithë këto shtete do të futen nën pushtetin tonë shumë shpejt. Për këtë arsye kemi dy detyra të rëndësishme.

1-Të punojmë për të mbajtur nën pushtet shtetet që tashme janë nën pushtetin tonë.

2- Të punojmë për të futur nën pushtetin tonë shtetet që nuk kemi arritur t'i fusim akoma.

Ministria e kolonive për t'ia arritur këtyre qëllimeve ka ngritur nga një komision për secilin nga këto shtete. Kur fillova detyrën në ministrinë e Kolonive, Ministri pati besim tek unë dhe më dërgoi me detyra tek një firmë e cila punonte në Indinë lindore. Kjo në pamje të jashtme, kjo ishte një shoqëri tregëtare, por detyra e vërtetë e kësaj shoqërie ishte shqyrtimi i mundësive për të pushtuar Indinë.

Qeveria jonë nuk kishte asnjë shqetësim përse i përket Indisë, sepse India përbëhej nga rraca të ndryshme, gjuhë të ndryshme, dhe njerëz me qëllime të ndryshme. As nga Kina nuk kishim ndonjë shqetësim, sepse nuk kishte mundësi që fetë kryesore në Kinë Budizmi dhe Konfuçizmi, të ringjallehin. Këto ishin dy fe të vdekura që nuk kishin të bënë fare me jetën. Gjithashtu tek këto popuj mungonte ndjenja e atdhetarizmit. Të dy këto shtete nuk e shqetësonin fare qeverinë tonë, por nuk linim pa marrë parasysh ngjarjet që mund të ndodhnin në të ardhmen. Për këtë arsye kishim plane afatgjata për të përhapur ngatërresa, varfëri, injorancë, bile edhe sëmundje ngjitëse. Mund t'i fshihnim fare lehtë qëllimet tona të vërteta duke u maskuar me sjellje të ngjashme me kulturën e këtyre shteteve. Ndërsa shtetet Islame ishin shumë shqetësuese për ne. Bëmë disa marrëveshje me njeriun e sëmurë [me këtë nënkupton perandorinë Osmane], të gjitha këto ishin në favorin tonë, specialistët e ministrisë së Kolonive thonin se ky njeri i sëmurë do të jepte shpirt në një kohë më të shkurtër se një shekull. Gjithashtu bëmë edhe disa

marrëveshje të fshehta me Iranin dhe vumë në drejtim të këtij shteti njerëzit tanë që i kishim bërë më parë masonë. Drejtuesit që filluan të mernin rryshvet, të drejtonin keq, që nuk ia kishin haberin nga feja dhe ishin të dhënë pas grave të bukura, i dobësuan shumë këto dy shtete, por megjithatë, për shkak të arsyeve që do të rendis më poshtë kishim frikë se mundimet tona nuk do të jepnin rezultatin e duhur.

1-Muslimanët janë shumë të lidhur me fenë Islame. Çdo Musliman është i lidhur pas Islamit të paktën aq sa është i lidhur çdo prift me fenë e Krishtere. Siç dihet, priftërinjtë preferojnë të vdesin e nuk heqin dorë nga Krishtërimi.

Muslimanët më të rrezikshëm janë Shii'të e Iranit, sepse ato i quajnë Kafirë dhe pisllek të gjithë ato që nuk janë Shii. Për Shii'të të Krishterët s'janë gjë tjetër veçse pisllek që mban erë. Natyrisht që çdo njeri mundohet me të gjitha mënyrat të flakë tej pisllekun. Një herë i bëra këtë pyetje një Shii'ti: "Përse keni këtë mendim për të Krishterët". Përgjigja e tij ishte: "Pejgamberi i Muslimanëve ka qenë një njeri shumë i ditur. I kishte futur kafirët nën një presion shpirtëror të tillë që bënte të mundur që të gjenin rrugën e drejtë e cila është Islami, feja e Allahut. Edhe shteti bën po të njejtën gjë me njerëzit që i konsideron të rrezikshëm, i mban ato nën presion. Pislleku për të cilën e kemi fjalën nuk është material, por një presion shpirtëror dhe nuk e kanë vetëm të Krishterët, por edhe Synitë e të gjithë kafirët. Bile edhe mexhusitë e vjetër të Iranit quhen të pisët."

E pyeta: "Bukur! Por edhe Synitë dhe të Krishterët i besojnë Allahut, Pejgamberëve dhe ditës së Kijametit, përse të quhen të pisët?" U përgjigj: "Janë të pisët për dy arsye: E para, shpifin rreth hazreti Muhammedit, thonë se ka qenë gënjeshtar^[1]. Edhe në sipas shprehjes (mund t'i bësh

[1] Në të vërtetë ata që e akuzojnë Pejgamberin tonë si mashtrues janë vetë Shiitët dhe të Krishterët. Për itikadin e Shiitëve që nuk përshtatet me Kur'anin kerimin dhe me Hadithet e Pejgamberit, nuk fjalët dhe veprat e tyre të shëmtuara flitet gjatë në librat e Ehli synetit (**Es-savaik-ul muhrika**), (**Tuhfe-i isna asherrijje**), (**Tejjidi ehli sunnet**), (**Nahije**), (**Es'habi kiram**), (**Huxhexhi katijje**) dhe (**Milel ve Nihal**) në këto libra gjithashtu është dhënë përgjigja e çdo pyetjeje. Autori i librit (**Savaik**) Ahmed ibni Haxher Mekki vdiq më 1566 (Hixhri 974) në Meke, autori i librit (**Tuhfe**) Abdul Aziz vdiq më 1824 (Hixhri 1239) në Delhi, autori i librit (**Tejjid**) imam Rrabani Ahmed Faruki vdiq më 1624 (Hixhri 1034) në Serhendi sherif, autori i librit (**Nahije**) Abdul Aziz Ferharevi vdiq më 1824 (Hixhri 1239), autori i librit (**Es'habi kiram**) Abdulhakim Arvasi vdiq më 1943 (Hixhri 1362) në Ankara, autori i librit (**Huxhexh**) Abdullah Suvejdi vdiq më 1760 (Hixhri 1174) në Bagdad dhe autori i librit (**Milel**) Muhammed Shihristani vdiq më 1154 (Hixhri 548) në Bagdad.

keq atij që të bën keq ty), i quajmë ato (të pisët). E dyta, të Krishterët shpifin gjëra të shëmtuara rreth pejgamberëve. P.sh thonë se Isai “alejhis-selam” pinte verë dhe u kryqëzua se ishte i mallkuar.”

Unë i tmerruar i thashë: “Të krishterët nuk thonë kështu”. Ndërsa ai: “Ti nuk e di mirë, në **Librin e shenjtë**, kështu shkruhet”. Unë heshta sepse mbase për të dytën jo por për të parën kishte të drejtë. Nuk kisha dëshirë ta zgjasja më tepër debatin, sepse megjithëse isha veshur si Musliman mund të dyshonin tek unë. Për këtë arsye tregohesha i kujdesshëm që të qëndroja gjithmonë larg debateve.

2- Islami një kohë ishte fe e sovranitetit dhe e drejtësisë. Muslimanët ishin njerëz fisnikë dhe të dashur. Është e vështirë tu thuash tani këtyre njerëzve të nderuar “tani jeni skllëvër”. Nuk është e mundur të ndryshosh historinë e tyre dhe t’u thuash: “prestigji dhe madhështia që kishin fituar ishte vetëm si shkak i rrethanave të atyre kohëve, ato kohë për ju ikën e nuk mund të kthehen më”.

3- Shqetësoheshim shumë se Osmanllinjë të dhe Iranianët mund ta kuptonin se çfarë ishim duke bërë dhe të na i prishnin të gjitha planet. Në të vërtetë të dy këto shtete ishin dobësuar shumë, por egvizstenca e një shteti qëndror që kishte nën zotërim pasuri armë dhe qeverisje, nuk na lejonte të ishim të sigurtë dhe të qetë.

4- Shqetësoheshim shumë nga dijetarët e Islamit, sepse dijetarët e Stambollit, El-Ez’herit, Irakut dhe të Damaskut ishin pengesa të pakapërcyeshme për t’ia arritur qëllimeve tona. Ata ishin njerëz që nuk mashtroheshin nga qejfet kalimtare të kësaj bote, por përgatiteshin për t’u futur në Xhenetin e premtuar në Kur’nin kerim dhe nuk lëshonin aspak pe nga principet e tyre. Populli u bindej dhe u shkonte nga pas atyre. Edhe Sulltani vetë kishte frikë nga ata, synitë nuk ishin aq shumë të lidhur pas dijetarëve sa ishin Shiitët, shiitët nuk lexonin libra, ata njihnin vetëm dijetarët dhe nuk i jepnin rëndësinë që i takonte Sulltanit, ndërsa Synitë lexonin shumë libra dhe i respektonin dijetarët dhe Sulltanin.

Kemi bërë shumë mbledhje për këtë çështje, por fatkeqësisht në çdo herë kemi parë se rruga përpara nesh ishte e mbyllur. Raportet që na vinin nga agjentët tanë ishin përherë zhgenjyese dhe rezultati i konferencave ishte gjithmonë zero, por megjithatë asnjëherë nuk futeshim në pesimizëm, sepse ne jemi mësuar që të marrim frymë thellë dhe të bëjmë durim.

Në një mbledhje mori pjesë edhe vetë ministri, priftërinjtë më të mëdhenj dhe disa specialistë. Ishim gjithësej 20 vetë. Kjo mbledhje zgjati 3 orë dhe nuk u arrit dot në asnjë përfundim, por një prift tha: Mos u shqetësoni! Sepse krishtërimi u përhap vetëm pasi vuajti 300 vjet mundime, shresojmë që Mesia të na shohë nga bota

e panjohur ku ndodhet dhe të na ndihmojë që qoftë sikur edhe pas 300 vjetësh t'i nxjerrim kafirët [këtu e ka fjalën për muslimanët] nga qendra e tyre. Ne duhet të armatosemi me një besim të fortë dhe me një durim të madh! Për ta marrë pushtetin në duart tona duhet të përdorim të gjitha mjetet dhe të provojmë të gjitha rrugët. Duhet të mundohemi ta përhapim Krishtërimin mes Muslimanëve. Edhe po t'i marrim rezultatet tona pas shumë shekujsh përsëri mirë është, sepse prindërit punojnë gjithmonë për fëmijët e tyre.)

Në qendrën e Ministrisë së Kolonive u mbajt një konferencë në të cilën përveç Anglisë morën pjesë edhe diplomatë nga Franca dhe Rusia. Isha, me shumë fat. Ngaqë kisha marrëdhënie të mira me ministrin mu dha mundësia të merrja pjesë edhe unë në atë konferencë. Në konferencë u bënë planet që të veprohej si në Spajnë, pra duke i nxjerrë muslimanët nga feja e tyre t'i kthenim ato në besim [t'i bënim të krishterë], por përfundimet që u arritën nuk ishin ashtu siç dëshironim. Unë i kam shkruar të gjitha fjalimet që u mbajtën në atë konferencë në librin me titull **“Ila melekut il-Mesih”**.

Është shumë e vështirë të thash një pemë që ka zënë rrënjë thellë, e më pas ta shkulësh e ta flakësh atë tutje, por ne duhet t'i lehtësojmë vështirësitë e të dalim fitimtar mbi to. Krishtërimi ka ardhur në këtë botë për t'u përhapur. Këtë detyrë Mesia na e ka ngarkuar neve. Muhammedin e ka ndihmuar gjendja në të cilën ndodheshin popujt e lindjes dhe të perëndimit në atë periudhë. Kur u larguan ato kushte morën me vete edhe belanë [e ka fjalën për Islamin]. Tani vërejmë me kënaqësi se gjendja ka ndryshuar plotësisht. Me anë të përpjekjeve të mëdha të ministrisë sonë dhe të shteteve të tjera të Krishtere muslimanët kanë filluar të prapambeten, ndërsa të krishterët po forcohen. Ka ardhur përsëri koha të marrim përsëri vendet e humbura shekuj më parë. Përparësia e Britanisë së Madhe është zhdukja e Islamit.

I nderuari imam Rrabbani në vëllimin e parë të librit të tij **“Mektubat”** në letren e 275'të thotë:

Për ju kjo dhuratë e Allahut është bërë e mundur duke i'u mësuar të tjerëve dituritë e Islamit dhe duke përhapur njohuritë e Fikhut. Në ato vende ishte përhapur injoranca dhe bid'ati. Allahu teala iu dha juve dashurinë e njerëzve të Tij të dashur. Ju bëri ju si shkak për përhapjen e Islamit, prandaj duhet të mundoheni me të gjithë forcën tuaj të mësoni dituritë e Islamit dhe ligjet e fikhut. Këto të dyja janë kreu i çdo lumturie, shkaku i lartësimit dhe i shpëtimit. Mundohuni dhe punoni shumë! Dilni në pah si njerëz të fesë! I tregoni njerëzve atje rrugën e drejtë duke i mësuar atyre Urdhërat dhe Ndaletat e fesë! Në ajetin e 19 të sures Muzzemmil thuhet: **“Patjetër që kjo është një këshillë, për ata që duan të fitojnë kënaqësinë e Allahut”**.

Pjesa e Parë

NDARJA E DYTE

Në vitin 1710 (Hixhri 1122) Ministria e Kolonive më dërgoi në Egjipt, Irak, Hixhaz dhe Stamboll, me detyrën për të bërë spiunazh dhe për të mbledhur njohuri të nevojshme që na duheshin për të përçarë Muslimanët. Në të njëjtën datë ministria ngarkoi po me atë detyrë që isha ngarkuar edhe unë edhe 9 persona të tjerë, të përgatitur dhe të guximshëm. Ne na dhanë me vete krahas parave, njohurive të nevojshme dhe hartës, edhe nga një indeks që përfshinte emrat e dijetarëve dhe prijësve të fiseve. Nuk më harrohet kurrë! Kur u ndamë me sekretarin na tha: (E ardhmja e shtetit tonë varet nga suksesi juaj. Prandaj duhet të punoni me të gjithë forcën tuaj.)

Unë u nisa me rrugë detare drejt Stambollit që ishte edhe qendra e Hilafetit (Vendi ku ndodhej Halifeja, prijësi i muslimanëve, kryeqyteti i muslimanëve) Përveç detyrës sime kryesore atje më duhej të mësoja edhe Turqishten në mënyrë të përsosur. Më parë në Londër kisha mësuar shumë Turqisht, gjuhën e Kur'anit, Arabishten dhe gjuhën e Iranit, Persishten, por ta mësosh një gjuhë është gjë tjetër dhe ta flasësh atë si populli vendas është gjë tjetër. N.q.s e para mund të mësohet brënda disa vjetësh e dyta do disa fishin e kësaj kohe për t'u mësuar. Që njerëzit të mos kishin kurrfarë dyshimi ndaj meje duhet që ta mësoja Turqishten bashkë me të gjitha imtësitë.

Nuk shqetësohesha fare se mund të dyshonin ndaj meje, sepse muslimanët janë njerëz jo dyshimtarë, zemërçelur dhe me qëllime të mira, ashtu siç i ka mësuar peygamberi i tyre Muhammedi "alejhis-selam". Ata nuk dyshojnë për çdo gjë siç bëjmë ne. Gjithashtu edhe qeveria Turke nuk kishte një organizatë që mund të arrinte të zbulonte agjentët.

Pas një udhëtimi të lodhshëm mbërrita në Stamboll. Thashë se quhesha Muhammed dhe fillova të shkoj në Xhami, vendin ku bëjnë ibadet muslimanët. Më pëlqeu shumë Disiplina, pastërtia dhe bindja e Muslimanëve. Në një moment thashë me vete: (Përse luftojmë me këta njerëz të pafajshëm? Vallë këtë gjë na ka urdhëruar neve Mesia?) Por u ktheva menjëherë nga ky medim i djallëzuar dhe vendosa që ta kryej detyrën time në mënyrën më të përsosur.

Në Stamboll u njoha me një dijetar të nderuar me emrin

Ahmed. Ky ishte një njeri me virtyte të larta, i pastër si nga pikpamja shpirtërore ashtu edhe nga ajo fizike, ishte i sinqertë, kishte një zemër të pastër dhe ishte njeri mirëbërës, këto virtyte të larta që i gjeta tek ai nuk i kam parë tek asnjë nga dijetarët e fesë sonë. Ky njeri ditë e natë mundohej që t'i përngjante Muhammedit “alejhis-selam”, sipas tij Muhammedi “alejhis-selam” ishte njeriu më i lartësuar dhe më i përsosur ndër të gjithë njerëzit, sa herë që e përmendte atë i mbusheshin sytë me lot. Isha shumë me fat se asnjëherë nuk më pyeti se kush isha ose nga isha. Mua më thërriste (Muhammed efendi). I përgjigjej çdo pyetjes sime dhe sillej me mua me dashuri dhe me dhembshuri. Mua më quante si një misafir që kisha ardhur në Turqi dhe jetoja në Stamboll për të punuar dhe për të jetuar nën hijen e Halifes së Muhammedit “alejhis-selam”. Unë me këtë pretext qëndroja në Stamboll.

Një ditë i thashë Ahmed efendiut: “Nëna dhe babai më kanë vdekur. Vëlla e motër nuk kam. Mua nuk më ka ngelur asgjë si trashëgimi. Kam ardhur në Stamboll, për të punuar dhe për të fituar dhe për të mësuar dituritë e Kur’ani kerimit, pra kam ardhur në qendrën e Islamit për të fituar edhe dynjanë edhe ahiretin. U gëzua shumë nga fjalët e mia dhe tha: “Ty duhet të të tregojmë respekt për këto tre arsye”. Po i shkruaj fjalët e tij njëlloj siç i kam dëgjuar:

Ti je musliman. Të gjithë muslimanët janë vëllezër.

Ti je mysafir. Resulullahu “Sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem” ka thënë **(Respektojini mysafirët!)**.

Ti ke dëshirë të punosh. Ka një hadith sherif që thotë **(Ai që punon është miku i Allahut)**

Këto fjalë më pëlqyen shumë. Thashë me vetë (Ah sikur edhe krishtërimi të kishte gjëra kaq të drejta dhe të vërteta sa këto, por për fat të keq nuk ka asnjë), por ajo gjë që më çudiste shumë ishte se duke qenë një fe kaq madhështore, si kishte arritur Islami të dobësohej për shkak të disa njerëzve mendjemëdhenj dhe që nuk ia kishin fare haberin nga jeta.

I thashë Ahmed efendiut “Kam dëshirë të mësoj Kur’ani kerimin”. Patjetër më tha, ta mësoj unë. Filloi të më mësonte duke filluar që nga sureja Fatiha. Para se të fillonte të lexonte Kur’anin merrte abdest dhe më bënte edhe mua që të merrja. Pastaj filonte të më mësonte duke u ulur në drejtim të kibles. Gjatë leximit shpjegonte edhe kuptimin e atyre gjerave që lexonim. Kisha shumë vështirësi me leximin e disa fjalëve. Brënda dy vjetësh e lexova Kur’ani kerimin nga fillimi deri në fund.

Gjëja që muslimanët e quajnë abdest kryhet me larjen e disa

pjesëve të trupit: 1) Larja e fytyrës, 2) Larja e krahut të djathtë nga gishtat e deri tek bërrylat, 3) Larja e krahut të majtë nga gishtat e deri tek bërrylat, 4) Lagia (bërja mes'h) e flokëve, pjesës mbrapa veshëve dhe e qafës, 5) Larja e të dy këmbëve.

Unë bezdisesha shumë nga përdorimi i misvakut. **“Misvaku”** është një degë peme të cilën muslimanët e përdorin për të pastruar gojën dhe dhëmbët para se të marrin abdest. Mendoja se kjo degë peme ishte e dëmshme për gojën dhe dhëmbët. Ndonjëherë më çante dhe me gjakoste gojën, por megjithatë isha i detyruar ta përdorja. Të përdorje misvak në prani të tyre ishte një synet i rëndësishëm i pëjgamberit. Thonin se kjo degë peme ishte shumë e dobishme. Dhe me të vërtetë më vonë gjakosja e gojës mu ndërpre. Tek unë nuk ngeli asnjë shenjë nga era e keqe e gojës që e kanë shumica e Anglezëve.

Gjatë kohës që ndodhesha në Stamboll qëndroja pranë një hyzmeqari xhamie në këmbim të një shume të vogël parash. Emri i hyzmeqarit ishte Mervan efendi. Mervan ishte emri i njërit prej sahabeve të Muhammedit “alejhis-selam”. Ky hyzmeqar ishte një njeri nevrik. Mua më mburrej me emrin e tij dhe më thoshte “Po të lindi djalë vendosi emrin Mervan, sepse Mervan është nga muxhahidët e mëdhenj të Islamit.

Ushqimin e darkës na e përgatiste Mervan efendiu. Ditën e festës së muslimanëve, të Premten nuk shkoja në punë. Ditët e tjera të javës punoja me pagesë javore tek një marangoz i quajtur Halid. Meqë punoja vetëm nga mëgjesi e deri në drekë mua më jepte gjysmën e pagesës që i jepte punëtorëve të tjerë. Marangozi në kohën e lirë fliste shumë mbi virtytet e Halid bin Velidit. Halid bin Velid është një nga sahabet e Muhammedit “alejhis-selam” dhe një nga muxhahidët e mëdhenj. Ka bërë disa pushtime të ndryshme për Islamin. Marangozit i vinte keq që Omer bin Hattabi e hoqi atë nga detyra ^[1]

Marangoz Halidi ku punoja unë ishte një njeri i pamoralshëm dhe shumë nevrik. Megjithatë nuk e di përse, por mua më besonte shumë. Mbase e kishte këtë besim ngaqë asnjëherë nuk i dola nga fjala. Kur ishte vetëm nuk i jepte shumë rëndësi Islamit, por kur ishte me shokët i kryente porositë e Islamit. Namazin e Xhumasë e falte, ndërsa për të tjerat nuk e di.

Mëngjesin e haja ne dyqan. Pas punës shkoja në xhami për të falur namazin e drekës e qëndroja aty deri në namazin e Ikindisë.

[1] Kur edhe Ubejde bin Xherrah i cili u emërua në vend të Halid bin Velidit vazhdoi të korrite fitore u kuptua se fitoret nuk vinin prej Halidit por vinin me ndihmën e Allahut.

Pas namazit të Ikindisë shkoja në shtëpinë e Ahmed efendiut dhe qëndroja aty dy orë për të marrë mësimë Kur'ani dhe të gjuhës Arabe e Turke. Çdo ditë të Premte i'a jepja atij pagesën time javore sepse më jepte mësim shumë mirë. Me të vërtetë që mi mësonte shumë mirë Kur'ani kerimin, detajet e fesë Islame dhe gjuhën Arabe e Turke me të gjitha imtësitë.

Kur Ahmed efendiut e kuptoi se isha beqar pati dëshirë të më martonte me një nga vajzat e tij, por unë nuk e pranova këtë propozim të tijin, por ai këmbëngulte shumë dhe më thoshte se martesë ishte syneti i Pejgamberit dhe se Pejgamberi kishte thënë **“Ai që i kthen shpinën synetit tim nuk është prej meje”**. Kur e kuptova se kjo mund të arrinte deri aty sa të ndërpriteshin marrëdhëniet midis nesh i thashë “Unë jam impotent”. Duke thënë këtë bëra të mundur që miqësia jonë të vazhdonte si më parë.

Pasi kalova dy vjet në Stamboll i thashë Ahmed efendiut se kisha dëshirë të kthehesha në atdhe. Kur dëgjoi këtë më tha “Mos ik, përse dëshiron të ikësh? Në Stamboll ka çfarë të dëshirosh. Allahu teala këtij qyteti i ka dhënë të mirat e kësaj bote dhe ahiretit njëkohësisht. Më pate thënë që nëna dhe babai të kanë vdekur e motër ose vëlla nuk ke. Pra qëndro në Stamboll”. Ahmed efendiut ishte mësuar shumë me mua. Prandaj nuk dëshironte që të largohesha nga Stambolli dhe ngulte këmbë që të qëndroja aty, por detyra ndaj atdheut më detyronte që të kthehesha në Londër t'i dorëzoja ministrisë një raport të gjerë mbi qendrën e Hilafetit dhe më pas të merrja detyra të reja.

Gjatë qëndrimit tim në Stamboll, çdo muaj i dërgoja ministrisë së Kolonive raport mbi ngjarjet që shihja këtu. Një herë në një raport shkrova n.q.s njeriu i cili punon pranë meje kërkon të bëjë livata (pederasti) me mua, si të veproj. Përgjigja ishte “N.q.s kjo gjë ta lehtëson arritjen e qëllimit mund ta bësh”. Kur e lexova përgjigjen u nevríkosa shumë, sikur e gjithë bota më ishte rrëzuar përsipër. E dija edhe më parë që ky veprim i shëmtuar ishte i përhapur në Angli, por asnjëherë nuk e mendoja se eprorët do të ma urdhëronin diçka të tillë, por çfarë t'i bësh nuk kisha rrugë tjetër përveçse ta pija gotën deri në pikën e fundit. Prandaj heshta dhe vazhdova të kryej detyrën time.

Kur erdhi momenti të ndahesha nga Ahmed efendiut, më tha: “Biri im! Allahu teala të ndihmoftë! N.q.s vjen përsëri në Stamboll dhe mëson se kam vdekur, më kujto. Këndo një **Fatiha** për shpirtin tim! Do të takohemi ditën e Mahsherit pranë Resulullahut”. Me të vërtetë edhe unë u preka shumë dhe derdha lotë, por detyra ishte mbi ndjenjat.

Pjesa e Parë

NDARJA E TRETE

Shokët e mi ishin kthyer përpara meje në Londër dhe kishin marrë urdhëra të reja nga ministria. Edhe unë kur u ktheva mora urdhëra të reja, por fatkeqësisht vetëm 6 vetë kishim mundur të ktheheshim.

Nga katër të tjerët, sipas atyre që na tregoi sekretari i ministrisë, njëri ishte bërë musliman dhe kishte qëndruar në Egjipt, por megjithatë sekretari ishte i gëzuar, sepse ai nuk e kishte treguar sekretin. I dyti kishte shkuar në Rusi dhe kishte qëndruar aty. Ky ishte me origjinë Ruse, sekretari nuk mërzhitej, sepse ky kishte qëndruar në Rusi, por shqetësohej, sepse mendonte se ky ishte agjent Rus dhe ishte futur në ministrinë tonë për të grumbulluar informacione për Rusinë dhe pasi e kishte kryer detyrën e tij ishte kthyer përsëri në atdhe. Ndërsa i treti gjithmonë sipas atyre që na tregoi sekretari kishte vdekur nga sëmundja e kolerës në një qendër bamirësie diku afër Bagdatit. Të katërtin ministria e kishte ndjekur deri në lumin San në Jemen, një vit rresht kishin marrë raporte nga ai, por më vonë me gjithë përpjekjet e ministrisë nuk kishin rastisur dot në gjurmët e tij. Ministria humbjen e këtyre katër agentëve e cilësonte si një fatkeqësi të madhe, sepse jemi një popull i pakët në numër, por me detyra të mëdha. Prandaj çdo njeri ka një rëndësi të madhe për ne.

Sekretari, pasi mori raportet e mia, bëri një mbledhje për t'i bërë një analizë të hollësishme raporteve të të katërve prej nesh. Pasi shokët dorëzuan raportet e tyre në lidhje me detyrat që kishin marrë edhe unë e dorëzova raportin tim. Disa pjesë nga raporti im i mbajtën shënim. Kryetari, sekretari dhe disa punonjës të tjerë të ministrisë më përgëzuan për punën që kisha bërë, por megjithatë isha në vend të tretë. Vendin e parë e kishte zënë shoku im George Belcoude, ndërsa vendin e dytë Henry Franse. Turqishten, Arabishten, Kur'anin kerim dhe ligjet e Islamit i kisha mësuar shumë mirë, por nuk kisha arritur t'i paraqisja ministrisë ndonjë raport që tregonte pikat e dobëta të perandorisë Osmane. Pas mbledhjes e cila zgjati 2 orë sekretari më pyeti për arsyen e këtij dështimi. Iu përgjigja "Detyra ime kryesore ishte të mësoja gjuhët, Kur'anin dhe Islamin. Prandaj nuk arrita dot t'i kushtoj shumë kohë punëve të tjera përveç këtyre, por këtë herë do t'iu kënaq me

punën time”, sekretari më tha: “Padyshim që ti bëhesh i suksesshëm, por unë kisha dëshirë që të bëheshe ti i pari” dhe vazhdoi:

“Hempher! Detyrat e tua të reja janë dy:

Përcaktimi i pikave të dobëta të muslimanëve që do të na e bëjnë të mundur të futemi në trupat e tyre e t’ia ndajmë kockat nga njëra-tjetra. Kjo është rruga për të dalë fitimtar ndaj armikut.

Kur t’i kesh përcaktuar këto pika të dobëta dhe të veprosh ato që të thashë [Pra të përçash muslimanët dhe t’i hedhësh ato kundra njëri-tjetrit] do të fitosh medaljen e ministrisë, si agjenti më i suksesshëm.”

Qëndrova gjashtë muaj në Londër. Aty u martova me vajzën e xhaxhait Maria Shvay. Në atë kohë unë isha 22 vjeç ndërsa ajo 23. Maria Shvay ishte një vajzë shumë e bukur me një zgjuarësi mesatare dhe një kulturë normale. Ato ditë kalova momentet më të bukura dhe të lumtura të jetës sime. Gruaja ime ishte shtatëzënë. Në ato kohë që po prisnin mysafirin e ri më erdhi urdhëri për të shkuar në Irak.

Më hidhëroi shumë ardhja e këtij urdhëri në një kohë që po prisja ardhjen në botë të djalit tim, por rëndësia që i jepja atdheut dhe ambicja për të dalë i pari mbi shokët ishin më të larta se ndjenjat e burrit dhe të prindit. Për këtë arsye e pranova urdhërin pa u tutur aspak. Gruaja ime dëshironte shumë që ta shtyja punën deri sa të lindte fëmija ynë, por nuk i dhashë rëndësi fjalëve të saj. Ditën që u ndamë qajtëm që të dy. Gruaja më tha “Mos i ndërprit asnjëherë letrat! Edhe unë do të të shkruaj ty në lidhje me follenë tonë të re dhe të rëndësishme që po krijojmë”. Këto fjalë nxitën një furtunë në zemrën time. Për pak sa nuk e anullova udhëtimin, por dita të dal fitimtar mbi ndjenjat. U ndava prej saj dhe shkova në godinën e ministrisë për të marrë këshillat e fundit.

Pas gjashtë muajsh e gjeta veten në qytetin Basra të Irakut. Në këtë qytet një pjesë e popullit ishin Syni dhe një pjesë Shii. Në Basra që ishte një zonë ashiretesh (fisesh) jetonin Arabë, Persianë dhe pak të krishterë. Atje u takova për herë të parë në jetën time me Shiitë dhe me Persianë. Meqë e hapa fjalën po flas pak mbi Shiitët dhe Synitë:

Shiitët: “Thonë se i binden Ali bin Ebi Talibit i cili është djali i xhaxhait të Muhammedit “alejhis-selam” dhe burri i vajzës së Tij, Fatimesë. Gjithashtu thonë se Muhammedi “alejhis-selam”, pas tij ka caktuar Halife Aliun dhe 11 imamët që janë bijtë dhe nipërit e tij”

Sipas mendimit tim Shiitët kanë të drejtë përsa i përket Hilafetit të Aliut dhe i të dy djemve të tij Hasanit dhe Hysenit. Me ç'kam kuptuar nga historia e Islamit Aliu ka qenë një njeri i zgjedhur dhe me virtyte të larta, që e meritonte të bëhej Halife. Edhe caktimi i Hasanit dhe i Hysenit me dukej diçka e mundur, por ajo që më bënte të dyshoja ishte caktimi i djalit të Hysenit dhe i tetë prej nipave të tij, sepse në kohën kur Muhammedi “alejhis-selam” ka vdekur Hyseni ishte akoma një fëmijë, si ka mundësi ta dinte se Hyseni do të kishte tetë nipër. Po të supozojmë se Muhammedi “alejhis-selam” ka qenë me të vërtetë pejgamber, ashtu si ka lajmëruar edhe Mesia mbi të ardhmen është e mundur që edhe ai ta dijë të ardhmen me ndihmën e Allahut, por sipas ne të krishterëve qënja pejgamber e Muhammedit “alejhis-selam” është diçka e dyshimtë.

Muslimanët thonë: “Ka shumë argumente që Muhammedi “alejhis-selam” është pejgamber. Njëri nga këto është Kur’ani”. E kam lexuar Kur’anin kerim, me të vërtetë është një libër shumë madhështor. Bile është më i lartë se Teurati dhe Ungjilli. Në të gjenden ligje, rregulla, cilësi morale, rregulla të edukatës etj.

Mahnitem përpara faktit se si ka mundur një njeri që nuk kishte shkrim e këndim, të nxjerrë në pah një libër kaq madhështor sa ky, si ka arritur të zotërojë një edukatë, moral, zgjuarësi dhe një personalitet të tillë, virtyte të cilat është e pamunduar ti gjeshe edhe tek ndonjë njeri i shkolluar dhe që ka lexuar e udhëtuar shumë? Mos vallë këto janë argumente që tregojnë se Muhammedi “alejhis-selam” ka qenë një pejgamber i vërtetë?

Gjithmonë bëja kërkime dhe studime për të arritur të mesoja të vërtetën mbi pejgamberllëkun e Muhammedit “alejhis-selam”. Një herë nga meraku i’ a hapa këtë temë një prifti në Londër. Foli me shumë njëanshmëri dhe inat. Nuk arriti të më jepte një përgjigje bindëse. Edhe në Turqi megjithëse e pyeta disa herë Ahmed efendiun nuk arrita të marr ndonjë përgjigje të kënaqshme, por është e vërtetë se nga frika se mos e kuptonte që isha agent ose dyshonte prej meje nuk kisha arritur ta pyesja hapur Ahmed efendiun.

Unë e vlerësoj shumë Muhammedin “alejhis-selam”. Padyshim që ai është nga pejgamberët e Allahut që kemi lexuar nëpër libra, por unë si një i krishter akoma nuk i kam besuar pejgamberllëkut të tij. Pa dyshim ai është më i madhi nga të gjithë gjenitë.

Synitë thonë se: “Muslimanët pas vdekjes së Pejgamberit e panë të arsyeshme që Halife të bëheshin Ebu Bekri, Omeri,

Osmani dhe Aliu”.

Kundërshtime të tilla ka në të gjitha fetë e sidomos në atë të krishtere. Meqë tashmë edhe Omeri edhe Aliu kanë vdekur nuk ka më kuptim të vazhdohet me një zënkë të tillë, sipas meje muslimanët po të tregohen të mençur nuk mendojnë kohët shumë të largëta, por të sotmen^[1].

Një ditë po flisja në një mbledhje të ministrisë së Kolonive rreth Synive dhe Shiive, thashë: “Po të kuptonin Muslimanët nga jeta do ti përfundonin mosmarrëveshjet e tyre midis Shiive dhe Synive dhe do të bashkoheshin”. Dikush ma ndërpreu fjalën menjëherë duke thënë: “Detyra jotë është të mundohesh t’i nxisësh akoma më shumë këto mosmarrëveshje dhe jo të mendosh se si mund të bashkohen Muslimanët”.

Përpara se të nisesha për në udhëtim drejt Irakut, më ftoi pranë Sekretari dhe më tha: “Hempher! Dije se mosmarrëveshjet mes njerëzve egzistojnë që nga koha kur Allahu krijoi Habilin dhe Kabilin. Këto mosmarrëveshje do të vazhdojnë deri në kohën kur do të kthehet Mesia. Të tilla janë mosmarrëveshjet e ngjyrës, fiseve, tokave, popujve dhe fetare.

Këtë herë detyra jote është t’i mësosh mirë këto mosmarrëveshje dhe t’i sjellësh njohuri ministrisë. Po të arrish t’i shtosh mosmarrëveshjet mes muslimanëve i ke bërë shërbinin më të madh Anglisë.

Ne Anglezët për të jetuar në mirëqenje dhe të lumtur duhet të fusim ngatërresa dhe përçarje në të gjithë shtetet e botës e në

[1] Të flasësh për çështjen e Hilafetit dhe ta besosh atë është nga shtyllat e Shiilikut, sipas Synive nuk është e nevojshme të flasësh për një çështje të tillë. Anglezi i ri i ngatërron njohuritë e Anglisë me njohuritë e botës. Muslimanët ashtu si thotë edhe ai në dituritë e kësaj bote kanë gjetur gjithmonë të renë, të përparuarën, në shkencë, teknikë, llogari, arkitekturë kanë përdorur gjithmonë mendjen dhe eksperiencën dhe gjithmonë kanë përparuar. Ndërsa të krishterët e kanë quajtur mëkat të përdorësh mendjen në punët e shkencës., ndërsa rregullat e fesë i kanë ndryshuar sipas mendjes së tyre. Astronomi i famshëm Italian Galileu përse tha se Toka rrotullohet, gjë që e kishte mësuar nga muslimanët u shkishërua dhe sikur të mos mjaftonte kjo edhe e burgosën. Më pas shpëtoi nga duart e priftërinjve duke thënë se ishte penduar dhe se Toka nuk rrotullohet. Muslimanët përsa i përket çështjeve të fesë dhe të besimit asnjëherë nuk veprojnë sipas mendjes së tyre, por gjithmonë sipas Kur’anit kerim dhe haditheve sherif. Këto dituri që janë mbi mendjen e njeriut nuk i ndryshojnë ashtu siç bëjnë të krishterët.

kolonitë tona. Perandorinë Osmane mund ta shkatërrojmë vetëm me anë të përçarjeve të tilla. Po të mos veprohet kështu si mund të dalë fitimtar një shtet me popullsi të vogël ndaj një shteti me popullsi të madhe? Me të gjithë forcën tënde kërko dhe gjej pikat e dobëta dhe futu brenda nga këto pika të dobëta. Dije se Perandoria Osmane dhe Irani janë duke jetuar kohët e tyre të këqija, në këtë periudhë janë të dobët. Detyra jote është që të nxisësh popullin kundër prijësve! Historia e ka treguar se “Të gjitha ndryshimet kanë ardhur si rezultat i ngritjes në këmbë të popujve”. Mbasi muslimanët të përçahen, të dobësohet dashuria që kanë për njëri tjetrin dhe të humbasin forcën e tyre, atëherë mund t’i shfarosim ato me lehtësi.

DUAJA E TEUHIDIT

Ja Allah, ja Allah. La ilahe il-lall-llah Muhammedun Rresulullah. Ja Rrahim, ja Rrahim, ja afuvvuja Kerim, fa’fu anni verrhamni Ja errhamerr-rrahimin! Taveffeni muslimen ve elhikni bissalihin. Allahummagfirrli ve li-abai ve ummehati ve li abai ve ummehati zevxheti ve li exhdadi ve xheddati ve li ebnai ve benati ve li ihveti ve ehavati ve li amami ve ammati ve li ahvali ve halati, ve li ustazi Abdulhakimi Arvasi ve li kaffetil muminine vel muminat. “Rrahmetullahi teala alejhim exhmain.”

Pjesa e Parë

NDARJA E KATERT

Kur arrita në Basra u vendosa në një Xhami. Imami i xhamisë quhej Sheh Omer Tai, ky ishte Syni dhe me origjinë Arabe. U prezantova me të dhe filluam të bisedonim, por që në fillim të bisedës filloi të dyshonte tek unë dhe më mbyti me pyetje. Nga kjo bisedë e rrezikshme arrita të shpëtoj në këtë mënyrë: “Unë jam nga zona Idir e Turqisë, jam nxënësi i Ahmed efendiut në Stamboll. Atje punoja tek një marangoz i quajtur Halid” dhe u tregova atyre disa gjëra që i kisha mësuar në kohën kur ndodhesha në Turqi. Fola edhe disa fjali në gjuhën turke. Imami duke i bërë shenjë më sy njërit që ndodhej aty e pyeti në e flisja mirë Turqishten apo jo. Ai dha përgjigje pozitive. U gëzova shumë që arrita ta bind Imamin, por isha gënjyer, sepse pas disa ditësh e kuptova që imami dyshonte tek unë dhe mendonte se isha agjent Turk. Më vone e kuptova se kishte armiqësi dhe mosmarrëveshje me përfaqësuesin e ri të Sulltanit.

Pasi u bë e pashmangshme largimi nga xhamia e Sheh Omerit mora një dhomë me qera në një han për të huajt dhe misafirët dhe u sistemova aty. Pronari i hanit ishte një njeri i trashë me emrin Murshid. Çdo mëngjes më prishte rehatin, sapo këndohej ezani i namazit vinte i gjuante derës me force për të më zgjuar. Isha i detyruar që t'i bindesha atij. Pra edhe unë ngrihesha dhe falja namazin e sabahut. Pastaj më thoshte “Pas namazit të sabahut do të lexosh Kur’ani kerim”. Një herë i thashë “të lexosh Kur’ani kerim nuk është farz përse këmbëngul kaq shumë?” Ai m’u përgjigj: “Të flesh në këtë orë i sjell varfëri hanit dhe banorëve të tij”. Tani isha i detyruar që ta çoja në vend edhe këtë urdhër të tij. Po të mos veprojë kështu më kërcënonte se do të më përzinte nga hani. Prandaj menjëherë pas ezanit falja namazin dhe lexoja Kur’ani kerim për më tepër se një orë.

Një ditë Murshid efendi më erdhi afër dhe më tha: “Që nga koha kur e ke marrë ti më qera këtë dhomë kanë filluar të më ndodhin probleme. Unë e quaj se këto më ndodhin nga tersllëku jot. Ti je beqar. Beqaria është tersllëk. Pra ti ose do të martohesh ose do të largohesh nga hani.” I thashë: “Nuk kam aq shumë mall sa të mund të martohem” Nuk mund t’i nxirrja edhe këtij atë preteks që i kisha nxjerrë Ahmed efendiut për të mos u martuar, sepse Murshid

efendi ishte një njeri i tillë që për ta provuar a i thoja të vërtetën apo jo mund të më zhvishte dhe të më kontrollonte auresin.

Kur thashë këshu, Murshid efendi tha: "O njeri me besim të dobët! Nuk e ke lexuar ajetin e Allahut (**Po të jenë të skamur, Allahu me mirësinë e Tij i pasuron ato**)^[1] Ngela i çuditur anga ato që tha. Më në fund i thashë: "Po unë do të martohem. Po a je gati të më gjes paratë e nevojshme që më duhen për tu martuar? Ose a mund të më gjes një vajzë pa shpenzime?"

Murshid efendi pasi u mendua pak tha: "Unë nuk dua t'ia di! Deri në fillim të muajit Rexheb ose do të martohesh ose do të largohesh nga hani". Deri në fillim të muajit të Rexhebit kishin ngelur 25 ditë.

Me këtë rast po numëroj muajt e muslimanëve: Muharrem, Safer, Rebiul evvel, Rebiul ahir, Xhemazijel evvel, Xhemazijel ahir, Rexheb, Shaban, Ramazan, Sheval, Dhilkade, dhe Dhilhixhe. Muajt e tyre asnjëherë nuk janë më tepër se 30 ditë ose më pak se 29. Dhe llogariten sipas rrotullimit të Hënës.

Gjeta punë tek një marangoz dhe u largova nga hani i Murshid efendiut. Ramë dakort mbi një pagesë të vogël dhe ushqimin e fjetjen do të ma siguronte ai. Pa hyrë akoma muji i Rexhebit i transportova plaçkat e mia në dyqanin e marangozit. Marangozi quhej Abdurriza, ai ishte një burrë besnik nga Horasani. Me mua sillej si me djalë të tij. Fillova ta shfrytëzoj kohën që ndodhesha pranë tij duke mësuar Persisht nga ai. Çdo ditë në kohë të ikindisë Shiitët Iranianë mbledheshin tek ai dhe flisnin për tema të ndryshme duke filluar nga politika e deri tek ekonomia. Flisnin shumë keq kundër qeverisë së tyre dhe Halifes në Stamboll, sapo të afrohej ndonjë i huaj menjëherë ndërronin temë dhe flisnin për gjëra personale.

Tek unë kishin shumë besim. Më vonë e kuptova se ngaqë flisja Turqisht mendonin se isha Azerbajxhanas.

Në dyqanin tonë vinte nganjëherë një adoleshent. Kishte veshje studentit dhe fliste gjuhët Arabisht, Persisht e Turqisht. Emri i tij ishte "**Muhammed bin Abdulvehhab Nexhdi**". Ky adoleshent fliste me shumë mendjemadhësi dhe ishte shumë nevrik. Ky e shante shumë perandorinë Osmane, por megjithatë asnjëherë nuk fliste kundër qeverisë Iraniane, shkaku i miqësisë me Abdurizain, pronarin e dyqanit ishte armiqësia e të dyve ndaj Halifes në Stamboll, por si kishte mundësi që ky adoleshent Syni njihte gjuhën

[1] Sureja nur, ajeti 32

Persiane dhe kishte miqësi me Abdurrisain që ishte Shii? Në këtë qytet Synitë takoheshin me Shiitët dhe dukeshin si vëllezër, shumica e banorëve të këtij qyteti dinin edhe Arabisht edhe Persisht. Edhe ata që flisnin Turqisht ishin në numër të shumtë.

Nexhdi Muhammed në dukje ishte Synni, por megjithëse shumica e Synive flasin kundër Shiive, bile i quanin ato të pa fe, ky asnjëherë nuk fliste keq për to. Nexhdi Muhammed nuk shihte ndonjë arsye që ta bënte të ndiqte rrugën e ndonjë nga katër medhhebet e Synive dhe thoshte: “Në librin e Allahut nuk ka asnjë argument për këto medhhebe”. Bënte sikur nuk i kuptonte drejt ajetet në lidhje me këtë çështje dhe nuk i jepte rëndësi ajeteve.

Përsa i përket çështjes së katër medhhebeve: Pas vdekjes së Pejgamberit të tyre Muhammedit “alejhis-selam”, mes Synive dolën në pah këto katër dijetarë: Ebu Hanife, Ahmed bin Hanbel, Malik bin Enes dhe Muhammed bin Idris Esh-Shafi. Disa nga Halifet i detyruan Synitë që të ndjekin rrugët e njërit prej këtyre dijetarëve. Ato thonin se përveç këtyre katër dijetarëve asnjë njeri tjetër nuk mund të nxjerri ligje (të krijojë mendim, të bëjë ixhtihad) nga Kur’ani kerimi dhe nga Hadithet sherif. Ky veprim është bërë shkak që muslimanëve t’i mbyllen dyert e ditorisë dhe të kuptimit, shkak i prapambetjes së muslimanëve tregohet si ndalesa e nxerrjeve të ligjeve të tillë.

Shitët për të përhapur medhhebin e tyre kanë përfituar nga këto mendime të gabuara, shiitët nuk kanë qenë as sa një e dhjeta e Synive në numër. Tani janë shtuar dhe janë bërë të barabartë në numër. Është gjë normale që do të ndodhte kështu. Ixhtihadi (nxjerrja e ligjeve nga Kur’ani kerim dhe nga hadithet sherif) i ngjan një arme, e zgjeron Fikhun e Islamit, ligjet e tij dhe e ripërtërin kuptimin e Kur’ani kerimit dhe të hadithit sherif. Ndërsa ndalesa e Ixhtihadit i ngjan një arme të prishur. I len ligjet gjithmonë të kufizuara. Kjo është t’i mbyllësh derën mendimit dhe t’i mbyllësh veshët ndaj kërkesave të kohës. N.q.s arma jote është e prishur, ndërsa arma e armikut tënd është e përsorur je i dënuar që të mundesh përballë këtij armiku. Mendoj se në një kohë të afërt njerëzit e zgjuar të Ehli synetit do t’ia hapin derën ixhtihadit. N.q.s nuk e bëjnë një gjë të tillë pas disa shekujsh ato do të jenë në pakicë ndërsa Shiitët në shumicë.^[1]

[1] Dijetarët e mëdhenj të cilët arrijnë të kuptojnë ligjet që janë shprehur me kuptim të mbyllur e jo haptazi në Kur’ani kerim dhe në Hadithe sherif, quhen **Muxhteheidë**. Kushtet që duhet të plotësojë një dijetar në mënyrë të tillë që të quhet Muxhteheid i kemi përmendur gjatë në librat **(Seadeti ebedije)** dhe **(Faideli Bilgiler)**. 400 vjet pas Hixhretit (shpërnguljes)

[Besimi, itikadi dhe gjërat që besojnë katër medhhebet e Ehli synetit janë të njëjta. Nuk ka fare ndryshim mes tyre. Ndryshimi i tyre është vetëm tek ibadetet. Edhe kjo gjë është vetëm lehtësim për muslimanët. Ndërsa Shiitët në besim janë ndarë në 12'të rrugë, janë bërë armë e prishur. Rreth këtyre flitet gjatë në librin **“Milel dhe Nihal”**.]

Nexhdi Muhammedi që i pëlqente shumë vetvetja, kur vinte puna për t'i dhënë kuptim Kur'ani kerimit dhe Haditheve sherif vepronte sipas mendjes së tij. Nuk i llogariste fare pikëpamjet e jo vetëm të dijetarëve të asaj kohe dhe të dijetarëve të katër medhhebeve, por nuk i llogariste fare as pikëpamjet e sahabëve të mëdhenj siç ishin Ebu Bekri dhe Omeri. Kur mendonte se kishte të bënte me një ajet që binte ndesh me pikëpamjet e tyre thonte: Pejgamberi ka thënë **“Po ju lë juve Kur'anin dhe synetin”**, nuk ka thënë “Po ju lë juve Kur'anin, synetin, sahabet dhe dijetarët e medhhebeve”.^[1] Për këtë arsye farz është t'i bindesh Kur'anit dhe synetit sado që të jenë në kundërshtim me pikëpamjet e sahabëve dhe të dijetarëve.^[2]

Në një bisedë gjatë ushqimit në shtëpinë e Abdurrazait, mes Nexhdi Muhammedit dhe Kumllu Sheh Xhevadid ndodhi një debat i tillë:

Sheh Xhevadi- Megjithëse e pranon se Aliu është muxhtehid pse nuk ndjek edhe ti rrugën e tij siç bëjnë Shiitët?

Nexhdi Muhammed- Edhe Aliu është po ashtu si Omeri e si

nuk u edukua një dijetar që ti përmbushi dot këto kushte. Armiqtë e Islamit, zindikët (mosbesimtarët), duke thenë se bëjnë Ixhtihad mundohen ta shëmbin nga brënda Islamin. E vërteta është kjo se Muxhtehidët i kanë nxjerrë ligjet nga Kur'ani kerim dhe Hadithet sherif për të gjitha ngjarjet që do të ndodhin deri në ditën e kijametit.

[1] Nexhdi Muhammedi me këto fjalë mohon Hadithin i cili na urdhëron të ndjekim rrugën e Es'habëve kiram.

[2] Tani në të gjithë vendet muslimane njerëz tradhëtarë dhe injorantë hiqen si njerëz të fesë dhe sulmojnë dijetarët e Ehli synetit. Në këmbim të shumave të mëdha të parave që marin nga Arabia Sauditë lavdërojnë Vehabilikun. Të gjithë në çdo vend përdorin si armë fjalët e mësipërme të Nexhdi Muhammedit, por e vërteta është se asnjë fjalë e Es'habëve kiram, ose e imamëve të katër medhhebeve nuk bie në kundërshtim me ato që thuhet nëpër ajetet e Kur'anit kerim ose hadithet sherif. Këto nuk i kanë bërë asnjë shtesë ajeteve të Kur'anit kerim ose haditheve sherif, vetëm sa i kanë shpjeguar ato. Vehabitë ashtu si edhe Anglezët i mashtrojnë Muslimanët me gënjeshtira.

çdo sahabe tjetër. Fjala e tij nuk është argument, arrgumente janë vetëm Kur'ani kerim dhe Hadithet sherif. [Por e vërteta është se fjala e çdonjërit prej Es'habëve kiram është argument. Pejgamberi na e ka urdhëruar të ndjekim rrugën e clititdo prej tyre.^[1]

Sheh Xhevadi- Derisa Pejgamberi ka thënë **“Unë jam qyteti i diturisë, ndërsa Aliu është dera”** a nuk tregon kjo gjë se duhet të ketë ndonjë ndryshim mes Aliut dhe sahabeve të tjerë?

Nexhdi Muhammed- Po të ishte argument fjala e Aliut a nuk duhej që Pejgamberi të thoshte: “Ju kam lënë juve Kur'anin, Synetin dhe Aliun”?

Sheh Xhevadi- në një mënyrë e ka thënë një gjë të tillë. Në një Hadithi sherif ka thënë: **“Po ju lë Librin e Allahut dhe Ehli bejtin”**. Ndërsa Aliu është më i lartësuar i Ehli bejtit.

Nexhdi Muhammed e mohoi se Pejgamberi e kishte thënë një gjë të tillë.

Sheh Xhevati e bëri të heshtë Nexhdi Muhammedin duke i paraqitur argumente bindëse.

Por përsëri Nexhdi Muhammed kundërshtoi duke thënë “Ju pretendoni se Pejgamberi ka thënë **(Po ju lë Librin e Allahut dhe Ehli bejtin)**. Po syneti i Resulullahut ku mbeti?

Sheh Xhevadi- Synetet e Resulullahut janë shpjegimi i Kur'anit. Resulullahu ka thënë **“Po ju lë Librin e Allahut dhe Ehli bejtin”**. Me përmendjen e Librit të Allahut ka nënkuptuar edhe synetin që është shpjegimi i tij.

Nexhdi Muhammedi- Derisa fjalët e Ehli bejtit janë shpjegim i Kur'anit, atëherë çfarë nevojë ka për shpjegimin me anë të Hadithit?

Sheh Xhevadi- Pas vdekjes së Hazreti Pejgamberit, ymeti i Tij ndjeu nevojën e një tefsiri (komentimi) të Kur'anit, që t'i përgjigjej nevojave të kohës. Ja për këtë arsye hazreti Pejgamberi i ka urdhëruar ymetit të tij që të ndjekë rrugën e Kur'anit, që është origjinal dhe Ehli bejtit që arrin të bëjë tefsirin e Kur'anit në mënyrë që t'i përgjigjet nevojave të kohës.

Më pëlqeu shumë ky debat. Nexhdi Muhammedi përballë Sheh Xhevadit plak u bë si zogu që është në dorën e gjahtarit dhe nuk lëviz dot.

Atë që kërkoja e gjeta tek Nexhdi Muhammedi. Mungesa e

[1] Të gjithë ato muslimanë të cilët kanë arritur të shohin fytyrën e bekuar të Muhammedit “alejhis-selam” quhen **Sahabe**. Disa nga ato quhen **Sahabe** ose **Es'hab**.

respektit ndaj dijetarëvëve të kohës, mendimi i tij i pavarur përsa i përket komentimit të Kur'anit dhe syneve, ishin pikat e tij më të dobëta nga ku unë mund ta sulmoja dhe ta fusja pre në dorën time, sa larg ishin këto adoleshentë mendjemëdhenj nga Ahmedi që pata qëndruar e mësuar në Stamboll. Ai ashtu si të parët e dijetarëve i ngjante malit. Asgjë nuk e luante atë nga vendi, sa herë që donte të përmendte emrin e Ebu Hanifes ngrihej e merte abdest. Gjithashtu sa herë që do të kapte me dorë Librin me Hadithe të Buhariut ngrihej e merte abdest, synitë tregojnë një respekt dhe bindje të madhe ndaj këtij libri.

Ndërsa Nexhdi Muhammedi e nënvlehtësonte shumë Ebu Hanifen dhe thonte “Unë e di më mirë se Ebu Hanifeja”^[1] Gjithashtu pretendonte se gjysma e librit me hadithe të **Buhariut** nuk ishte i saktë.^[2]

[Gjatë përkthimit të kujtimeve të Hempherit m'u kujtua ngjarja e mëposhtme: Isha mësues në një shkollë të mesme. Gjatë mësimit një nxënës më pyeti “Muslimani që vdes gjatë luftës a bëhet shehit?” “Po” i thashë. “A na ka lajmëruar peygamberi për këtë gjë?” “Po” i thashë. “Edhe po te mbytet në det bëhet shehit?” “Po bëhet, dhe sepasi që fiton është më i madh” “Edhe po të bjerë nga avioni bëhet shehit?” “Po bëhet” i thashë. “A e ka lajmëruar peygamberi këtë gjë?” “Po, e ka lajmëruar” i thashë. Qeshi si një hero dhe tha: “Mësues! A kishte avion në atë kohë?” “Dëgjo këtu bir! Peygamberi jonë ka 99 emra. Çdo emër tregon një cilësi të Tij. Njëri nga emrat e tij është **(Xhemi ul kelam)**. I shpjegonte shumë gjëra me një fjalë të vetme. Nxënësi këtë përgjigje e priti me çudi dhe mirënjohje. Në Kur'an kerim dhe në hadithe sherif ka shumë fjalë dhe ligje, pra urdhëra dhe ndalesa që shprehin shumë kuptime në të njëjtën kohë. Ti gjeshe këto kuptime dhe të zgjedhësh atë që duhet quhet **ixhtihad**. Që të arrish të bësh ixhtihad duhet të jesh dijetar shumë i madh.

Për këtë arsye Synitë ia kanë ndaluar të paditurve të bëjnë ixhtihad. Kjo nuk do të thotë se kanë ndaluar ixhtihadin. Për shkak se 4 shekuj pas Hixhretit (shpërnguljes) nuk ka dalë në pah ndonjë muxhtehid i vërtetë [dijetar i madh, i kompletuar me dituritë rreth çdo fushe], nuk është bërë më ixhtihad, dera e ixhtihadit është mbyllur vetvetiu. Në një kohë të afërt me

[1] Në këtë kohë disa injorantë pa medhheb mendojnë një gjë të tillë. Tani në Turqi disa budallenj me tituj profesorë thonë një gjë të tillë. Këto tregohen qartë në Hadithe sherif; **(Seadeti Ebedije)** faqa 422.

[2] Kjo gjendje tregon se nuk ja ka fare haberin nga shkenca e Hadithit.

Kijametin do të zbresë Isai “alejhis-selam” nga qielli, do të vijë dhe Mehdiu dhe do të bëjnë ixhtihad.

Pejgamberi “Sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem” ka thënë: **(Pas meje muslimanët do të ndahen në 73 grupe. Vetëm njëri do të futet në Xhenet.)** Kur u pyet se kush ishte ai grup, u përgjigj: **(Ata që ndjekin rrugën time dhe të Es’habëve të mi.)** Në një hadith tjetër ka thënë: **(Es’habët e mi janë si yjet në qiell. Këdo që të ndiqni gjeni rrugën e drejtë!)**, pra gjen rrugën që të çon në Xhenet. Një Çifut nga Jemeni me emrin Abdullah bin Sebe me qëllim për ta shembur Islamin nga brenda futi tek Muslimanët armiqësinë. ndaj Es’habëve kiram. Të paditurit që u bënë armiq të Es’habëve u quajtën **Shii**. Ata që duke iu bindur Haditheve sherif i duan Es’habët dhe ndjekin rrugën e tyre quhen **Syni**.]

Unë krijova një shoqëri shumë të ngushtë me Nexhdi Muhammedin. Gjithmonë e lavdëroja atë. Një ditë i thashë atij: “Ti je më i madh se Omeri dhe se Aliu. Po të ishte në jëtë Pejgamberi do të të kishte caktuar ty Halife dhe jo ato. Unë shpresoj që Islami të përtërihet dhe të lartësohet në sajin tënd. Ti je dijetari i vetëm që mund ta përhapësh Islamin në mbarë botën.”

Bashkë me Abdulvehabin vendosëm që të bëjmë tefsirin (shpjegimin) e Kur’anit, komplet sipas mendimeve tona, në një mënyrë të kundërt nga tefsiret e sahabëve, imamëve të medhhebeve dhe dijetarëve të tefsirit. Lëxonim Kur’anin dhe flisnim rreth disa ajeteve të Tij. Arsyeja e kësaj ishte që ta fusja Muhammedin në grackë. Edhe ai dëshironte ta tregonte veten si revolucionar dhe i pranonte me kënaqësi mendimet dhe pikëpamjet e mia, në mënyrë që të fitonte më shumë besimin tim. Një herë i thashë: “Xhihadi nuk është farz”. Më tha: “Si nuk është farz, në një kohë kur Allahu thotë: **(Luftoni kundër kafirëve)**”^[1]?

Unë i thashë: Allahu gjithashtu ka thënë **(Bëj xhihad me kafirët dhe me munafikët)**^[2], atëherë përse Pejgamberi nuk ka bërë xhihad me munafikët? [Megjithatë në librin **(Mevahibu Ledunnijje)** tregohet se me kafirët ka bërë 27 luftëra, shpata e tij ekspozohet në një muze në Stamboll. Munafikët mbaheshin si Muslimanë. Gjatë ditës falnin namaz sëbashku me Resulullahun në Mesxhidi Nebevi. Resulullahu “Sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem” i dinte se kush ishin ato, por asnjëherë nuk i tha në sy ndonjërit prej tyre, ti je munafik. Po të luftonte kundër tyre dhe t’i vriste ato,

[1] Sureja Teube, ajeti 73

[2] Sureja Teube, ajeti 73

njerëzit do të thonin: “Muhammedi “alejhisselam” vrau ato që i besuan atij”. Për këtë arsye me munafikët bëri xhihad me **fjalë**, sepse xhihadi që është farz bëhet me trup, me mall dhe me fjalë. Ajeti kerim i mësipërm urdhëron të bëhet xhihad me kafirët dhe me munafikët. Nuk e cilëson se si duhet të bëhet ky xhihad. Pejgamberi “Sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem” me kafirët bëri xhihad duke luftuar ndërsa me munafikët bëri xhihad me vazë dhe me këshilla.]

Ai tha: “Pejgamberi ka bërë xhihad me fjalë me ato”.

Unë i thashë: “Xhihadi që është farz, a është ai që bëhet me fjalë”?

Ai: “Resulullahu kundër Kafirëve ka bërë luftëra”.

Unë: “Pejgamberi me kafirët ka luftuar për qëllimet e Tij, sepse kafirët donin t’a vrisnin atë.

Tundi kokën në shenjë pohimi.

Një herë i thashë: “Martesa (Nikahu) **Myt’a** është i lejuar.

Ai tha se nuk është i lejuar.

Unë i thashë: (Allahu ka thënë: “**Po përfituat prej tyre, jepuni Shpërblimin (mehr-in) që keni rënë dakord**”)^{[1][2]}

Ai:” Omeri i ka ndaluar të dy Myt’at që ishin në kohën e Pejgamberit dhe ka thënë se do ta ndëshkonte cilindo që e bënte këtë veprim”.

Unë: “Ti këndej thua që unë di më mirë se Omeri këndej i bindesh atij. Në një kohë kur Omeri ka thënë: (Pejgamberi e quante hallall ndërsa unë po e ndaloj)”^[3]. Ti përse len fjalët e

[1] **Sureja Nisa, ajeti 24**

[2] Martesa Myt’a është haram në të katër medhhebet. Martesa Myt’a është një lloj kontrate që bëhet pa praninë e dëshmitarëve, kjo lloj kontrate përfshin bashkëjetesën me një vajzë për një kohë të caktuar, në këmbim të një shume të caktuar parashë. Në librat “Mizanul Kubrra” dhe “Ibni Abidin” shkruhet se të gjithë dijetarët njëzëri e kanë pranuar se martesa Myt’a është haram. Ata që thonë se Imam Maliku ka thënë “Është e lejuar” mashtrojnë.

[3] Omeri “Radijallahu an-h” nuk ka thënë kështu. Agjenti Anglez duke qenë armik i hazreti Omerit si çdo i Krishterë tjetër e ka sulmuar atë edhe në këtë rast duke thënë fjalë që në të vërtetë ai nuk i ka thënë. Në “**Huxhexhi katijje**” thuhet: “Omeri “radijallahu an-h” ka thënë martesën Myt’a e ka ndaluar Resulullahu, unë nuk do të lejoj që të veprohet diçka që e ka ndaluar Resulullahu. Të gjithë Es’habë kiramët e mbështetën fjalën e Halifes. Midis tyre ndodhej edhe hazreti Aliu.

Kur'anit dhe të Pejgamberit dhe vepron sipas fjalëve të Omerit?

Ai nuk ktheu përgjigje. E kuptova që u bind.

Në atë moment e dija se Nexhdi Muhammedit ia kishte qefi për një femër, ai ishte beqar. I thashë atij: “Eja të marrim nga një vajzë me martesë Mut’a dhe dëfrejmë me to”. Pranoi duke tundur kokën. E quajta këtë si një rast të volitshëm që duhej shfrytëzuar dhe i premtova atij se do t’i gjeja një vajzë për t’u dëfryer. Qëllimi im ishte që të largoja nga ai frikën dhe turpin ndaj njerëzve, por ai më vuri kusht që kjo gjë të ngelej sekret midis nesh dhe vajzës të mos i tregonim as edhe emrin e tij. Vrapova menjëherë tek vajzat e krishtere që Ministria e kolonive kishte dërguar aty për të nxjerrë nga rruga të rinjtë muslimanë. I’a shpjegova çështjen njëtrës prej tyre. Kur pranoi të bashkëpunonte i vendosa asaj emrin Safije. Mora Nexhdi Muhammedin dhe e çova në shtëpinë e saj. Në shtëpi ndodhej vetëm Safija. Bëmë martesë një javore për Nexhdi Muhammedin. Ai i dha vajzës disa florinj si **Mehr**. Unë nga jashtë e Safija nga brënda filluam ta mashtrojmë Nexhdi Muhammedin.

Safija e futi mirë në dorë Nexhdi Muhammedin. Edhe ai me preteksin e lirisë së ixhtihadit dhe te mendimit po fillonte të ndjente shijen e kundërshtimit të urdhërave të Islamit.

Në ditën e tretë të martesës Myt’a bëmë një debat të gjatë ku unë këmbëngulja se pijet alkoolike nuk janë haram, sado shumë Hadithe sherif dhe ajete që përmendi për të treguar se është haram unë i’a kundërshtova të gjitha. Në fund fare i thashë: “Është e vërtetë se Halifet e Jezidëve, Emevive dhe Abbasëve i përdornin pijet. Të gjithë këto kanë qënë gabim dhe ti ke të drejtë? Nuk ka dyshim që ata e njihnin Kur’anin kerim dhe synetin më mirë se ty. Ata e kanë kuptuar nga Kur’ani kerim dhe syneti se pijet alkoolike nuk janë haram, por janë mekruh. Në librat e Çifutëve dhe të krishterëve thuhet se këto pije janë mubah. Të gjitha fetë janë urdhërat e Allahut. Bile sipas një thënie Omeri ka vazhduar t’i përdorë këto pije deri në zbritjen e ajetit **“Ju të gjithë keni hequr dorë, kështu!”**^[1] [E vërteta mbi këtë çështje është se hazreti Omeri i përdorte këto pije përpara se të bëheshin haram. Pasi u bënë haram nuk i ka përdorur më kurrë. Përdorimi i alkoolit nga disa halife të Emevive dhe të Abbasëve nuk tregon se alkooli është mekruh. Kjo tregon se këta halife kanë qënë gjynahqarë dhe

[1] Sureja Maide, ajeti 91

kanë kryer haram, sepse ajeti kerim që përmendi agjenti dhe disa ajete dhe Hadithe sherif të tjerë tregojnë qartë se pijet alkoolike janë haram. Në librin **(Rijadun Nasihin)** thuhet: “Në fillim përdorimi i pijeve ishte i lejuar. Hazreti Omeri, Sa’d ibni Vakkas dhe disa prej sahabeve i përdornin këto pije. Më pas zbriti ajeti i 219’të i sures Bekara që tregonte se gjynahu për përdorimin e këtyre pijeve ishte shumë i madh. Më pas zbriti ajeti i 42’të i sures Nisa që thotë **(Mos i’u afroni namazit kur jeni të dehur!)**. Më në fund zbriti ajeti i 93’të i sures Maide dhe këto pije u bënë haram. Në Hadithe sherif thuhet: **“Edhe pakica e asaj që të deh është haram”** dhe **“Pijet alkoolike janë gjynahu më i madh”** dhe **“Mos mbani shoqëri me ata që pijnë pije alkoolike! Mos i shkoni në xhenaze! Mos merni vajzë prej tyre dhe as mos jepni!”** dhe **“Të pish pije alkoolike, është njëlloj si të adhurosh putat”** dhe **“Allahu teala i mallkoftë ata që pijnë pije alkoolike, që shesin, që prodhojnë, që i japin të tjerëve”**]

Nexhdi Muhammedi tha: (Sipas disa thënieve Omeri i përdorte këto pije duke i përzier me ujë dhe thoshte se po mos të të dehte nuk ishte haram. Në Kur’an thuhet **“Shejtani nuk dëshiron tjetër përveçse nëpërmjet verës dhe bixhozit të hedhë armiqësi midis jush, t’iu pengojë nga të përmendurit e Allahut. Pra a po hiqni dorë?”**^[1] kur pijet nuk të dehin nuk të shtyjnë në gjynahet që përmenden në ajet. Pra për këtë arsye kur pija nuk të deh atëherë nuk është haram)^[2]

Ia tregova këtë debat mbi pijet alkoolike Safijes dhe e porosita atë që ta bënte atë të pinte një pije shumë të fortë. Më pas ajo më tha: “Veprova siç më porosite ti, e detyrova të pinte, filloi të luante dhe atë natë bëmë disa herë marëdhënie bashkë.” Në kohën kur u ndava me Ministrin e Kolonive, më pati thënë: “Ne Spanjën nga duart e kafirëve [e ka fjalën për Muslimanët] e morëm me ndihmën e pijes dhe të zinasë. Përsëri po me këto dy armë të marrim mbrapsht të gjitha tokat tona”. Vetëm tani arrij ta kuptoj se sa të drejtë kishte me këto fjalë.

Një ditë i hapa Nexhdi Muhammedit temën e agjërimit: I thashë: “Në Kur’an thuhet **“Agjëroni, është më me vlerë për ju”**^[3].

[1] Sureja Maide, ajeti 91

[2] Pejgamberi ka thënë: **“Të pish sado pak nga ajo pije që kur pi shumë të deh është haram”**.

[3] Sureja Bekara, ajeti 184

Nuk thuhet se është farz. Prandaj agjërimi në fenë Islame është synet, nuk është farz”. E kundërshtoi këtë sygjërim timin dhe tha: “Mos dëshiron gjë që të më nxjerësh nga feja ime”? Unë i thashë: “Feja është, pastërtija e zemrës, lumturia e shpirtit dhe të mos i bësh dëm të tjerëve. A nuk ka thënë Pejgamberi **(Feja është dashuri)**!

A nuk ka thënë Allahu në Kur’anin kerim: **“Dhe adhuroje Zotin tënd deri sa të vijë ty e vërteta (vdekja)”**^{[1][2]} Atëherë njeriu është pranë Allahut dhe ditës së Kijametit dhe deri sa ta ketë zemrën e pastër dhe punët e mira është njeriu më i lartësuar”. Pas këtyre fjalëve tundi kokën me kuptimin “Jo, nuk është e vërtetë”

Një herë i thashë atij “Namazi nuk është farz.”. “E si nuk është farz?” m’u përgjigj, si përgjigje i thashë: “Allahu në Kur’an thotë **“Fal namaz për të më kujtuar Mua”**^[3] pra kjo do të thotë se qëllimi i namazit është përmendja e Allahut. Pra, në vend të namazit mund ta përmendësh Allahun në mënyrë tjetër”.

Ai tha: “Po, është e vërtetë, disa njerëz në kohën e namazit në vend të namazit përmendnin Allahun (bënin dhikër)^[4]”. Unë u gëzova shumë nga këto fjalë të tij. Fillova ta çoj akoma më tej këtë mendim dhe kështu arrita të fus në dorë zemrën e tij. Më pas fillova të vërej që nuk i jepte rëndësi namazit. Nganjëherë e falte e nganjëherë jo, sidomos namazin e Sabanut e linte shumë pas dore, sepse bisedonim bashkë me të deri në mesnatë, kështu bëhesha pengesë që të flinte gjumë. Prandaj kur vinte koha e Sabahut ishte i pafuqishëm e nuk ngrihej dot për të falur namazin.

Avash, avash fillova t’i zhvesh Nexhdi Muhammedit rrobat e Besimit. Një ditë desha të debatoj me të edhe rreth Pejgamberit. Më tha: “N.q.s vazhdon të flasësh me mua rreth këtyre temave, miqësia jonë prishet dhe i ndërpres të gjitha mardhëniet me ty”.

[1] **Sureja Hixhr, ajeti 99**

[2] Në të gjithë librat e Islamit thuhet se këtu behët fjalë për vdekjen. Ky ajeti kerim ka kuptimin **(Bëj ibadet deri sa të vdesësh)**!

[3] **Sureja Teube, ajeti 14**

[4] Pejgamberi jonë i nderuar ka thënë: **“Namazi është shtylla e fesë. Ai që fal namaz e ka ndërtuar fenë e tij, ai që nuk e fal e ka shkatërruar fenë e tij”** dhe **“Falen i namazin ashtu si e fal unë!”**. Të mos e falësh namazin në këtë mënyrë është gjynah i madh, shenja që tregon se zemra është e pastër është të falësh namazin ashtu si duhet.

Pas këtyre fjalëve nga frika se mos i gjithë suksemi im i deri tanishëm shkonte dëm, hoqa dorë nga debatimi rreth Pejgamberit. E udhëzova atë që të ndiqte një rrugë tjetër përveç asaj Syni dhe Shiite.

Edhe ai i jepte rëndësi kësaj këshille. Tashmë ai ishte një njeri i lumtur. Në sajë të Safijes arrita ta fus atë mirë në dorë.

Një herë e pyeta “Pejgamberi i ka bërë Es’habët vëllezër mes tyre” a është e vërtetë? “Po” u përgjigj. I thashë: “Ligji i Islamit mbi këtë ka qenë kalimtar apo vazhdon akoma?”. “Është i vazhdueshëm, sepse hallalli i Pejgamberit tonë Muhammed është hallall deri në ditën e kijametit dhe harami haram deri në ditën e kijametit”. Pas këtyre fjalëve i thashë “Atëherë eja të bëhemi vëllezër të dy” dhe u bëmë vëllezër.

Që pas asaj dite nuk u ndava fare prej tij. Edhe kur dilte për udhë, përsëri ishim bashkë. I jepja shumë rëndësi atij. Dhe si pasojë pema që mbolla duke harxhuar ditët më me vlerë të rinisë sime filloi të jepte fruta.

Çdo muaj i nisja një raport ministrisë së Kolonive në Londër. Përgjigjet që vinin ishin shumë inkurajuese dhe shumë nxitëse. Nexhdi Muhammedi tashmë ecte në rrugën që i kisha hapur unë.

Detyra ime ishte që t’i injektoja atij ndjenjat e pavarësisë, lirisë dhe dyshimit. I thoja gjithmonë se ai kishte një të ardhme të shndritshme dhe e lavdëroja shumë atë.

Një ditë trillova një ëndërr të tillë: (Mbrëmë natën pashë në ëndërr Pejgamberin tonë. I thashë atij të gjitha cilësitë e Pejgamberit që kisha dëgjuar prej hoxhallarëve. Ishte ulur në një faltore. Rreth tij ndodheshin dijetarë që nuk i njihja fare. U fute ti brënda. Fytyra jote shndriste si nur. Kur arritët pranë Pejgamberit, Pejgamberi u ngrit nga vendi i tij dhe të puthi në të dy sytë. Të tha: “Ti mban emrin tim, je trashgimëtar i diturisë time, je zëvendësi im në të gjitha punët e dynjasë dhe të ahiretit”. Ti i the: “O Resulullah! Unë kam frikë t’ia shpjegoj dituritë e mia njerëzve”. Pejgamberi si përgjigje të tha: “N.q.s ti je më i madhi mos ki fare frikë.”)

Muhammed bin Abdulvehhabi pasi dëgjoi këtë ëndërr filloi të fluturojë nga gëzimi. Më pyeti disa herë në thoja të vërtetën apo jo. Edhe unë në çdo herë i thashë që ishte e vërtetë dhe i betohesha për këtë gjë.

Ai u bind se thoja të vërtetën. Mendoj se atë ditë vendosi që t’i përhapte ato mendime që i kisha injektuar unë dhe të krijonte

- [1] Libri **(El fexhrr us sadik)** që e ka shkruar Xhemi Sidki Zehavi nga Bagdati, [vdekur në vitin 1936 (Hixhri 1354)] gjatë kohës që ishte Muderris (profesor medreseje) i lëndës (Akaidi i Islamit) në (Darul funun) në Stamboll, është botuar në Egjipt në vitin 1905 (Hixhri 1323). Më pas ky libër është ribotuar në Stamboll nga shtëpia botuese Hakikat. Në këtë libër thuhet: (Mendimet e gabuara të vehabizmit, të pregatitur nga ana e Anglezëve, ka filluar t'i përhapë Muhammed bin Abdulvehab në vitin 1737 (Hixhri 1150) në Nexhd. Ky ka lindur më 1699 (Hixhri 1111) dhe ka vdekur më 1792 (Hixhri 1207). U përhap nga prijësi i Derrije's Muhammed bin Suud, duke vrarë shumë Muslimanë. Fjalët e Vehabive që thonë për Muslimanët se janë të devijuar, janë të dëmshëm si edhe torturat që i kanë bërë ata muslimanëve janë trajtuar gjatë në librin **(Kijameti dhe Ahireti)**. Vehabitë i kanë quajtur të gjithë muslimanët e tjerë që nuk janë prej tyre, mushrikë. Kanë thënë se të gjithë duhet të bëjnë haxh përsëri se edhe këto janë kafirë si gjyshërit e tyre 600 vjet me radhë. Ata i kanë vrarë të gjithë ata që nuk e pranuan fenë e Vehabizmit dhe grabitën mallrat e tyre si plaçkë lufte. Kanë thënë fjalë të shëmtuara rreth Muhammedit alejhis-salam. Kanë djegur të gjithë librat e Fikhut, Tefsirit dhe Hadithit. E kanë komentuar gabim Kur'anin kerim, sipas mendimeve të tyre. Për të mashtruar muslimanët kanë thënë se janë nga medhhebi Hanbeli. Në një kokë kur shumica e dijetarëve Hanbelinj kanë shkruar libra që vërtetojnë se këto nuk janë Hanbelinj dhe i kanë mendimet e gabuara. Këto për shkak se i kanë quajtur haramet hallall dhe nuk i kanë pranuar disa prej pejgamberëve dhe evlijave, janë kafirë. Pikat kryesore të fesë Vehabi janë dhjetë: 1- Allahu është një krijesë materiale. Ka duar, fytyrë dhe drejtim. [ky besim i tyre i ngjan besimit të krishterëve në (At, Bir dhe fryma e shenjtë)] 2- E komentojnë Kur'anin kerim sipas mendimeve të tyre. 3- Mohojnë gjërat që kanë transmetuar Es'habët kiram. 4- Mohojnë ato gjëra që thonë dijetarët. 5- thonë se kush ndjek rrugën e njeriut prej katër medhhebeve bëhet kafir. 6- Kush nuk është Vehabi është kafir. 7- Kush bën dua duke përdorur si ndërmjetës Pejgamberët ose Evlijatë bëhet kafir. 8- të vizitosh varret e Pejgamberëve dhe Evlijave është haram. 9- kush betohet mbi diçka tjetër përveç Allahut bëhet mushrik (person që ka bërë shirk). 10- kush vepron diçka me një qëllim përveç fitimit të kënaqësisë së Allahut dhe ata që therin kurban pranë varreve të Evlijave janë mushrikë. Në këtë libër do të vërtetohet me argumente të qarta se këto dhjetë besime themelore të vehabive janë të gabuara. Po të shihet me kujdes këto dhjetë pika janë njohuritë fetare që Hempheri i ka injektuar Nexhdi Muhammedit..

Anglezët i kanë botuar kujtimet e Hempherit me qëllim për t'i bërë propogandë krishtërimit. Kanë shkruar dituritë e Islamit me gabime dhe gënjeshtra me qëllim për të mashtruar të rinjtë Muslimanë. Edhe ne duke i korigjuar këto shpifje po e botojmë këtë libër me qëllim për të mbrojtur rininë tonë nga hilet dhe nga grackat e Anglezëve.

Pjesa e Parë

NDARIA E PESTE

Në këto ditë që ishim shumë të përzemërt me Nexhdi Muhammedin më erdhi urdhër nga Londra për të vajtur në **Kerebela** dhe **Nexhef**, që ishin qytetet më të dashura të Shiitëve dhe në të njejtën kohë qendra kulturore dhe shpirtërore për to. Ngela i detyruar për t'i dhënë fund takimeve të mia me Nexhdi Muhammedin dhe për tu ndarë nga Basra, por u largova i gëzuar nga Basra, se kisha besim se ky njeri injorant dhe tashmë me moral të shthurur, që kisha përgatitur, do të krijonte një rrugë tjetër që do të bëhej shkak për shëmbjen nga brënda të Islamit dhe isha i lumtur se besimet e gabuara të kësaj rruge i kisha krijuar unë.

Aliu, Halifeja i Katërt sipas Synive dhe i pari sipas Shiitëve gjendet i varrosur në Nexhef. Qyteti i **Kufes** që ka qenë qendra e Hilafetit (kryeqyteti) të Aliut ndodhet një orë rrugë në këmbë larg Nexhefit. Pas vrasjes së Aliut, djemtë e tij Hasani dhe Hyseni e varrosën atë në një vend larg Kufes, në vendin që tani quhet Nexhef. Më pas Nexhefi filloi të zhvillohej, ndërsa Kufe'ja të shëmbej. Dijetarët e Shiitëve u mblodhën në Nexhef dhe ndërtuan aty shtëpi, tregje dhe medrese.

Halifeja në Stamboll i linte të lirë këto.Sepse:

1- Shteti Shiit i Iranit i mbështeste Shiitët e Nexhefit. Po të ndërhynte Halifeja në punët e tyre, mosmarrëveshjet midis dy shteteve tendoseshin dhe mund të arrinte puna deri tek lufta.

2-Në rrethinat e Nexhefit jetonin shumë ashirete (fise) të armatosur, të cilët mbështesnin Shiitët. Armët dhe organizimi i tyre nuk ishin me shumë rëndësi dhe Halifeja mund të futej në luftë me këto ashirete.

3-Shiitët e Nexhefit ishin qendra e Shiitëve të Indisë, Afrikës dhe të gjithë botës. Po t'i prekte Halifeja këto, Shiitët e të gjithë botës ngriheshin në këmbë

Nipi i Pejgamberit, pra djali i Fatimes bijës së tij Hysen bin Ali është bërë shehid në Kerebela. Populli i Irakut e thërritën Hysenin nga Medineja, për ta zgjedhur Halife të tyre. Kur mbërriti në Kerebela ai dhe familja e tij, populli i Irakut doli nga fjala. Me urdhërin e Halifes së Emevive Jezid bin Muavije, u nisën për ta kapur atë. Hyseni dhe familja e tij luftuan me heroizëm ndaj

ushtrisë së Irakut deri sa u vranë. Ushtria e Irakut doli fitimtare. Që pas asaj dite Shiitët e quajtën Kerebelanë si një qendër shpirtërore dhe vijnë nga çdo vend e mbledhen aty, në fenë tonë të krishtere nuk gjendet një shembull i tillë.

Kerebelaja është një qytet i Shiitëve dhe në të gjenden medrese të tyre. Kerebelaja dhe Nexhefi mbështesin njëri-tjetrin. Kur më erdhi urdhëri për të shkuar në këto dy qytete, shkova nga Basra në Bagdat dhe që aty në qytetin Hulle, i cili ndodhet në afërsi të lumit Euftrat.

Lumi Tigër dhe Euftrat nisin në Turqi dhe duke përshkuar Irakun derdhen në ngushticën e Basrës. Iraku prodhimet bujqësore i ka në sajë të këtyre dy lumenjve.

Kur u ktheva në Londër i sygjeroja ministrisë së Kolonive që të pregatisnin një plan për ndryshimin e shtratit të këtyre lumenjve, në mënyrë që kur të vinte koha ta detyronim Irakun të pranonte kërkesat tona, sepse po të pritej uji Iraku do të ngelej i detyruar të plotësonte kërkesat tona.

Nga qyteti i Hules në Nexhef shkova i maskuar si një tregëtar nga Azerbajxhani. Fillova shoqëri dhe miqësi me njerëzit e fesë së Shiitëve dhe fillova t'i mashtroj ato. U futa në klasat e mësimi të tyre. Vura re se nuk mësonin dituritë e shkencës ashtu siç bënin Synitë dhe nuk e kishin moralin dhe edukatën e mirë të tyre. Për shembull:

1-Kanë shumë armiqësi ndaj perandorisë Osmane, sepse këto ishin Shiitë, ndërsa Turqit Syni. Këto i quanin kafirë Synitë.

2-Dijetarët Shiitë njëloj si priftërinjtë tanë në periudhën tonë të errët, e kishin dhënë veten e tyre krejt pas diturive fetare dhe mereshin fare pak me shkencat e kësaj bote.

3-Nuk ia kishin fare haberin nga të vërtetat, madhështia dhe zhvillimi i shkencës dhe teknikës në fenë Islame.

Me veten time thashë, sa njerëz të shkretë janë Shiitët. Në një kohë kur e gjithë bota është zgjuar, këto flejnë. Do të vijë një ditë që do të vijë një vërshim dhe do t'i zhduki këto. Disa herë i nxita ato që të ngrinin krye ndaj Halifes, por fatkeqësisht asnjë nuk ma vuri veshin. Disa nga ata më qeshnin, sikur u thoja atyre shëmbni krejt botën, sepse ata e shihnin Halifen si një kështjellë që ishte e pamundur të zaptohej, sipas tyre vetëm ardhja e Mehdiut mund t'i shpëtonte ato nga Hilafeti.

Sipas tyre Mehdiu vjen nga pasardhësit e pejgamberit dhe është imami i tyre i 12'të që u zhduk nga sytë në vitin 255 Hixhri, sipas tyre ai është akoma në jetë dhe do të dalë një ditë në pah për

të mbluluar me drejtësi këtë botë të mbushur me tirani dhe padrejtësi.

Çuditem shumë! Si ka mundësi që Shiitët i besojnë këtyre gjërave të kota. Kjo i ngjan besimit të kotë të krishterëve “Isai do të vije dhe do ta mblulojë botën me drejtësi”

Një ditë i thashë njerit prej tyre: “A është farz për ju ta ndaloni tiraninë, ashtu siç ka bërë Pejgamberi i Islamit?” Mu përgjigj: “Allahu e ndihmonte atë. Për këtë arsye arriti të dalë fitimtar mbi tiraninë” I thashë: “Në Kur’an thuhet **“O njerëz po të ndihmoni fenë e Allahut. Ai ju ndihmon juve”**^[1] Po të kapni shpatën kundër mbretërve tuaj, Allahu ka për tju ndihmuar edhe juve.” Përgjigja e tij ishte kjo: “Ti je një tregëtar, ndërsa këto janë çështje fetare, ti nuk arrin t’i kuptosh dot këto”.

Tyrbeja e Aliut, Emir-ul muminin’it, ishte shumë e zbukuruar. Kishte një kopësht të bukur, një kube të madhe të veshur me flori dhe dy minare të mëdha.

Çdo ditë kjo tyrbe vizitohet nga një numër i madh Shiitësh. Falin namaz me xhemat këtu. Çdo vizitor që vjen këtu në fillim shkon tek pragu, e puth atë dhe më pas i jep selam varrit. Në fillim kërkonin leje dhe pastaj futeshin brënda. Tyrbeja kishte një kopësht të madh, dhe këtu ndodheshin shumë dhoma për njerëzit e fesë dhe vizitorët.

Në Kerebela kishte dy tyrbe që ngjasonin me atë të Aliut. Njëra është e Hysenit dhe tjetra e **Abbasit**, i cili ra shëhid sëbashku me të në Kerebela, shiitët të njejtën gjë që bënin në Nexhef e bënin edhe në Kerebela. Klima e Kerebelasë ishte më e mirë se ajo e Nexhefit. Përreth kishte kopshte të bukur dhe ujëra të rrjedhshëm.

Gjatë qëndrimit tim në Irak u përballa me një panoramë që ta gëzonte zemrën. Disa ngjarje aty jepnin lajmin se perandorisë Osmane po i afrohej fundi, sepse udhëheqësi i atjeshëm, i emëruar nga qeveria e Stambollit, ishte një njeri i paditur dhe mizor. Vepronte si t’i dëshironte qefi i tij. Populli nuk ishte i kënaqur prej tij, synitë ishin të pakënaqur nga ky u kërcënonte lirinë dhe nuk tregonte për to rëndësinë që meritonin, ndërsa Shiitët ishin të pakënaqur, sepse nuk dëshironin të drejtoheshin nga një prijës Turk duke qenë se kishte sejidë dhe sherifë nga pasardhësit e Pejgamberit të cilët ishin të denjë për prijës.

[1] **Sureja Muhammed, ajeti 7.** Do të thotë, të ndihmosh fenë e Allahut, t’i bindesh Islamit dhe të punosh për ta përhapur atë. T’i kundërvihesh qeverisë e shkatërron fenë.

Gjendja ku ndodheshin Shiitët ishte për të qarë hallin. Jetonin nëpër gërmadha të zhytura në pisllek. Rrugët ishin të pa sigurta. Grabitësit gjithmonë vëzhgonin karvanet. Po të mos kishin ushtarë me vete i sulmonin menjëherë. Për këtë arsye n.q.s qeveria nuk dërgonte ushtarë me to karvanet nuk niseshin për rrugë.

Mosmarrëveshjet midis ashireteve Shiite ishin të shumta. Çdo ditë vrisnin dhe plaçkisnin njëri tjetrin. Injoranca ishte përhapur në një masë të frikshme. Kjo gjendje e Shiitëve mua më kujtonte kohët kur kisha shtypte Evropën. Në Nexhef dhe Kerebela, përveç njerëzve të fesë dhe një pakice njerëzish të lidhur pas tyre, nga një mijë Shiitë nuk gjeje një që dinte të shkruante e të lexonte.

Ekonomia ishte shkatërruar fare, njerëzit jetonin në varfëri të plotë. Edhe shteti kishte arritur në një gjendje që nuk arrinte të përballonte nevojat e veta, shiitët e hanin në besë shtetin.

Shteti dhe populli e shihnin me dyshim njëri-tjetrin për këtë arsye nuk e ndihmonin njëri-tjetrin. Njerëzit e fesë të Shiitëve e kishin dhenë vetën pas sharjeve të Synive dhe kishin hequr dorë nga shkencat e kësaj bote.

Në Kerebela dhe Nexhef qëndrova katër muaj. Në Nexhef kalova një sëmundje shumë të rëndë, sëmundja arriti deri në atë pikë sa i humba shpresat nga vetja. Qëndrova i sëmurë për tre javë, shkova tek një doktor i cili më dha disa ilaçe. Me përdorimin e ilaçeve shendeti filloi të më rregullohej. Gajtë sëmundjes qëndroja në një dhomë nën tokë. ? zoti i shtëpisë ku qëndroja për shkak të sëmundjes sime në këmbim të një shume të vogël parash më jepte ilaçe, ushqim, më bënte shërbim dhe priste sevap të madh nga kjo, sepse sipas fjalëve unë isha mysafiri i Aliu, prijësit të muslimanëve. Në ditët e para të sëmundjes doktori më këshilloi të pi vetëm lëng lupe. Më vonë më lejoi të përdor edhe nga mishi. Në javën e tretë hëngra supë me oriz. Pasi u shërova shkova në Bagdad, shkrova një raport të gjatë prej 100 fletësh rreth atyre që vëreva në Nexhef, Hulle, Bagdat dhe gjatë rrugës. Raportin ia dorëzova përfaqësuesit të ministrisë së Kolonive në Bagdat. Po prisja urdhëra nga ministria, në do të vazhdoja të qëndroja akoma në Irak, apo do të kthehesha në Londër.

Dëshiroja të kthehesha në Londër, sepse kisha kaluar një kohë të gjatë në mërgim. Më kishte marrë shumë malli për atdheun dhe për familjen, sidomos kisha shumë dëshirë të shihja djalin tim Rasbutinin i cili kishte ardhur në botë pas nisjes sime. Për këtë arsye në raportin tim bashkangjita dhe një kërkesë ku i kërkoja ministrisë të më jepnin leje të kthehesha në Londër, qoftë edhe për një kohë të shkurtër. Dëshiroja t'i tregoja me gojë të gjitha

mbresat e mia të qëndrimit tre vjeçar në Irak dhe të pushoja pak.

Që të mos binim në sy, përfaqësuesi i ministrisë në Irak më porositi që të mos shkoja shpesh tek ai dhe të merrja një dhomë me qera në një nga hanet në afërsi të lumit Tigër, dhe më tha se do të më lajmëronte kur të vinte posta nga Londra. Gjatë kohës që ndodhesha në Bagdat vura re largësinë e madhe shpirtërore midis Bagdatit dhe Stambollit, qendrës së Hilafetit.

Kur shkova nga Basra në Kerebela dhe Nexhef, shqetësohesha shumë se Nexhdi Muhammedi do të devijonte nga rruga ku e kisha futur, sepse ai kishte një karakter shumë të paqëndrueshëm dhe ishte tepër nevrik. Kisha frikë se gjithë mundi që derdha për ta futur atë në atë rrugë do të më shkonte dëm.

Kur u ndava me të, ai po mendonte të shkonte në Stamboll. U mundova shumë për të hequr dorë nga ky mendim dhe i thashë: “Shqetësohem shumë se do të flasësh ndonjë fjalë që t’i bëjë ata të mendojnë se je i pafe dhe do të të vrasin”

Qëllimi im ishte krejt tjetër. Kisha frikë se takoj me ndonjë dijetar që do t’i ndreqte të gjitha mendimet e gabuara të tij dhe do ta kthente në besimin e Ehli synefit dhe kështu të gjitha mendimet e mia do të shkonin dëm, sepse në Stamboll ishte dituria dhe morali e edukata e mirë Islame.

Kur e kuptova se Nexhdi Muhammedi nuk kishte dëshirë të qëndronte në Basra, i sugjerova atij të shkonte në Isfahan dhe Shiraza, sepse këto dy qytete ishin shumë të bukura dhe popujt e tyre ishin Shiitë. Mundësia që feja Shiite të ndikonte mbi Nexhdi Muhammedin ishte zero, sepse dituria, morali dhe edukata tek këto ishte e mangët. Në këtë mënyrë u sigurova se nuk do të luante nga rruga ku e kisha futur.

Kur u ndamë e pyeta: “A i beson Takijes (të sillesh dyfytyrësh për të shpëtuar nga situata)?” Ai u përgjigj: “Po i besoj, sepse njëri nga sahabet kur mushrikët e torturuan dhe i vranë prindërit, bëri **takijje** dhe bëri shirk. Pejgamberi nuk i tha asgjë atij për këtë veprim” I thashë: “kur të jesh mes Shiitëve bëj takijje dhe mos trego se je Syni, në mënyrë që mos të të ndodhë ndonjë e keqe. Përfito nga vendet dhe nga dijetarët e tyre! Mësoji zakonet dhe medhhebin e tyre, sepse ata janë njerëz të paditur dhe inatçinj.”

Kur u ndava i dhash atij një sasi parash si zekat. Zekati është një taksë Islame që mblidhet për t’u shpërndarë nevojtarëve. Gjithashtu bleva edhe një kafshë që ta kishte për t’i hipur dhe ja bëra dhuratë. Në këtë mënyrë u ndamë.

Pasi u ndamë, na u ndërprente lidhjet. Kjo gjë më shqetësonte

shumë. Kur u ndamë e bëmë me fjalë që të dy të ktheheshim përsëri në Basra, e bëmë me fjalë që kush të kthehej i pari po të mos e gjente shokun të shkruante një letër dhe t'ia jepte Abdurrazait.

KRIMET E ANGLEZEVE

- 1– Në kalendarin e murit të gazetës Turkiye, në fletën e datës 2 Korrik 1995 thuhet: U zbulua një organizatë Angleze që grabiste fëmijë në shtetet e varfëra për ti përdorur për transplantim organesh, sipas një lajmi të ardhur nga Brazili thuhet se në qytetin Cambridge organizata botërore e organeve po bën hetime mbi fëmijët e rrëmbyer. Është vërtetuar se disa spitale Angleze kanë qenë të prirur për këto organe dhe i blinin me çmim shumë të shtrenjtë.
- 2– Në fletën e kalendarit të gazetës Turkiye të datës 4 korrik 1995 thuhet: Më tepër se 60 të rinj muslimanë që kanë shkuar në Angli për të bërë doktoratë në degën e kimisë u sistemuan në qytetin New Castle ku jetojnë të varfërit dhe të huajt, studenti Mustafa Arslanoğlu duke u kthyer natën në shtëpi u rrah me gurë dhe me shkopinj nga 2 të rinj që dolën nga një kishë aty pranë, deri sa humbi ndjenjat. I derdhën gaz përsipër për ta djegur, por për fat nuk u morën zjarr çakmakët. Një vajzë që po e shihte ngjarjen nga ballkoni i shtëpisë së saj lajmëroi policinë. Të rinjtë armiq të Islamit u larguan dhe u fshehën në kishë.
- 3– Në të njejtën gazetë thuhet: Në Bosnjë vdesin përditë qindra muslimanë nga plagët dhe nga uria. Prindërit derdhen në rrugë për të mos dëgjuar ulërimat e fëmijve të tyre, që ulërasin nga uria. Ushqimet që vijnë si ndihmë nga vendet muslimane i marin Serbët. Ushtarët e kombeve të bashkuara nën komandën Angleze bëjnë spiunazh për Serbët. Në kohën kur nga trupat e muslimanëve rrjedh gjak, ushtarët dhe turistët e krishterë, këto armiq të Islamit, ngrajnë dolli. Krimet në Bosnje janë planifikuar nga Anglezët. Kjo filloi në vitin 1988 në Kosovë. Millosheviçi u zgjodh si mashë. Anglezët u thonë Serbëve: “Mos kini frikë! Na keni ne nga pas”

Pjesa e Parë

NDARJA E GJASHTË

Qëndrova në Basra disa kohë. Më pas më erdhi urdhëri për t'u kthyer në Londër. U ktheva. Në Londër u takova me sekretarin dhe me disa pjesëtar të tjerë të ministrisë. U tregova atyre gjithçka kisha bërë gjatë qëndrimit tim të gjatë atje si edhe për vëzhgimet që kisha bërë. U gëzuan shumë nga lajmet që u dhashë mbi Irakun dhe më shprehën kënaqësinë e tyre. Kishin lexuar edhe raportin që u kisha dërguar më parë. Edhe Safija kishte dërguar një raport të njejtë me atë timin. Përsëri e kuptova se gjithmonë kisha qenë i ndjekur nga njerëzit e ministrisë. Edhe ata kishin dërguar raporte të njejtë me raportet e mia dhe me ato që u tregova sekretarit gojarisht.

Sekretari më caktoi një takim me Ministrin. Kur shkova në zyrën e Ministrit më priti krejt ndryshe nga hera tjetër kur isha kthyer nga Stambolli. E kuptova se kisha pushtuar një vend të veçantë në zemrën e tij.

Ministri u kënaq shumë që e kisha bërë për vete Nexhdi Muhammedin. Më tha: “Ai është arma që kërkonte ministria jonë. Jepi atij fjalën për çdo gjë. Edhe sikur ta harxhosh të gjithë kohën për të ia vlen.”

Unë i thashë: “Jam shumë i shqetësuar për Nexhdi Muhammedin, sepse ka mundësi që t'i jetë kthyer mendja.” Ai më tha: “Të jesh i qetë për këtë. Pasi jeni ndarë nuk i janë ndryshuar mendimet, njerëzit e ministrisë sonë janë takuar më të në Isfahan dhe na kanë sjellë lajme se nuk ka lëvizur fare nga rruga.” Me vete po mendoja: Si ka mundësi që Nexhdi Muhamedi i ndan sekretet e tij me të tjerët? Nuk pata guxim që ta pyesja Ministrin për këtë gjë, por kur u takova me Nexhdi Muhammedin e kuptova se në Isfahan ishte takuar me të një burrë me emrin Abdulkerim, i cili e kishte mashtruar Nexhdi Muhammedin duke i thënë: “Unë jam vëllai i Sheh Muhammedit [e kishte fjalën për mua]. Ai më ka treguar mua gjithçka rreth teje”. Në këtë mënyrë kishte arritur të mësonte sekretet e tij. Nexhdi Muhammedi më tregoi: “Safija erdhi bashkë me mua në Isfahan dhe jetuam edhe 2 muaj të tjerë bashkë me martesë Myt'a. Abdulkerimi erdhi me mua në Shiraz dhe aty më gjeti një grua tjetër më të bukur se Safija, e cila quhej Asije. Edhe me atë grua bëra martesë Myt'a dhe jetova çastet më

të lumtura të jetës sime.”

Më vonë e mora vesh se Abdulkadiri ishte një agjent i krishterë i ministrisë i cili jetonte në Xhelfa, vend në rrethinat e Isfahanit. Ndërsa Asija ishte nga Çifutet e Shirazit dhe ishte një agjente tjetër e ministrisë. Të katërt e përgatitëm Nexhdi Muhammedin në mënyrë që në të ardhmen ta kryente sa më mirë shërbimin që pritej prej tij.

Kur ia tregova ngjarjet Ministrin në prani të sekretarit dhe të dy personave të tjerë që nuk i njihja, Ministri më tha: ”Ti e meriton medaljen më të madhe të ministrisë, sepse ti je i pari ndër agjentët më të rëndësishëm të ministrisë, sekretari do të të tregojë ty disa sekrete shtetërore që do të të ndihmojnë në kryerjen e detyrës”

Më pas më dhanë dhjetë ditë leje për tu takuar me familjen. U nisa menjëherë drejt shtëpisë. Kalova çastet më të bukura me djalin tim që më ngjante shumë. Djali kishte mësuar të fliste disa fjalë dhe kishte një ecje aq të bukur sa që kur ecte ai më dukej sikur po ecte një pjesë nga trupi im. Ky pushim dhjetë ditor kaloi në një mënyrë shumë të bukur e të gëzueshme. Më dukej sikur fluturoja prej gëzimit. Ndjeja një kënaqësi të madhe që isha kthyer përsëri në atdhe dhe pranë familjes. Gjatë këtyre dhjetë ditëve vizitova hallën time plakë e cila më donte shumë. Kisha bërë shumë mirë që e kisha vizituar hallën, sepse pasi u nisa për rrugë për herë të tretë, ajo ishte ndarë nga kjo botë. U mërzita shumë për vdekjen e saj.

Këto dhjetë ditë kaluan shpejt si një orë. Megjithëse ditët e lumtura si këto kalojnë shpejt si një orë, ditët me dhimbje të duket sikur zgjasin me shekuj. M’u kujtuan ditët e sëmundjes në Nexhef. Ato ditë më ishin dukur si vite të tëra.

Kur shkova përsëri në ministri për të marrë urdhëra të reja gjeta përpara sekretarin me fytyrë të qeshur dhe trupin e tij të gjatë. Ma shtrengoi dorën aq ngrohtësisht sa ishte e lehtë të dalloje me anë të kësaj dashurinë që kishte për mua.

Më tha: “Me urdhër të ministrit dhe të komisionit të posaçëm të ministrisë do të të tregoj dy sekrete shtetërore me rëndësi. Në të ardhmen këto sekrete do të të hyjnë shumë në punë. Këto sekrete përveç disa personave shumë të besueshëm nuk i di asnjëri.”

Më kapi për dore dhe më çoi në një dhomë të ministrisë. Në këtë dhomë u përballa me një pamje shumë të çuditshme. Rreth një tavoline të rrumbullakët uleshin 10 burra. I pari prej tyre ishte veshur si Sulltani i Stambollit. Dinte Turqisht dhe Anglisht. I dyti ishte veshur si Shejhulislami i Stambollit. I treti ishte veshur si

Shahu i Iranit. I katërti ishte veshur si veziri në sarajet e Iranit. I pesti ishte veshur si dijetari më i madh i Nexhefit, që ndiqnin Shiitët. Këto tre të fundid dinin Persisht dhe Anglisht. Pas secilit pret tyre ndodhej nga një shkruer, të cilët shkruanin gjithçka që flisnin këto. Në të njejtën kohë këto shkruer u jepnin atyre njohuri që agentët i mblidhnin nga personat e vërtetë në Stamboll, Iran dhe Nexhef.

Sekretari më tha: “Këto 5 persona përfaqësojnë 5 personat e vërtetë atje. Për të kuptuar se si mendojnë ato i kemi përgatitur këto si të vërtetët. Ne u tregojmë këtyre njohuritë që na vijnë nga Stambolli, Tehrani dhe Nexhefi. Këto e quajnë veten si të vërtetët atje. Ne u bëjmë pyetje këtyre dhe këto na përgjigjen, sipas përcaktimeve që kemi bërë përgjigjet e këtyre janë 70 përqind të njejta me ato që japin të vërtetët.

Po deshe mund të bësh ndonjë pyetje për ta konstatuar vetë këtë gjë, sepse më parë je takuar me dijetarin e Nexhefit”. Unë pranova, sepse më parë isha takuar me dijetarin më të madh të Shiitëve, në Nexhef dhe i kisha bërë atij disa pyetje. Prandaj u afrova pranë atij që i ngjante dhe e pyeta: “A është e lejuar që ti hapim luftë qeverisë për shkak se janë Syni dhe janë tiranë?” Pasi u mendua pak u përgjigj: “Jo nuk është e lejuar që t’i hapim luftë qeverisë për shkak se janë Syni, sepse të gjithë muslimanët janë vëllezër, por n.q.s ata u bëjnë padrejtësi popullit atëherë mund ti hapim luftë. Kur ta bëjmë këtë gjë duhet ta bëjmë në një mënyrë të përshtatshme me urdhërat dhe ndalesat e Allahut. Kur të heqin dorë nga padrejtësitë edhe ne i largojmë duart prej tyre.

E pyeta. “Sipas mendimit tuaj a janë të pisët Çifutët dhe të krishterët?” U përgjigj: “Është e vërtetë ata janë të pisët. Duhet qëndruar larg prej tyre.” E pyeta përse, si përgjigje më tha: “Kjo është një kundërsulm ndaj ofendimeve. Ata na quajnë ne të pafe dhe e akuzojnë Muhammedin alejhis-selam si gënjeshtar. Edhe ne i sulmojmë ata në këtë mënyrë.” E pyeta përsëri: “A nuk është pastërtia nga besimi? Atëherë përse rrugët dhe rrugët rreth (**Sahni sherifit**) [Pjesa që rrethon tyrben e hazreti Aliut] nuk janë të pastra? U përgjigj: “Po, me të vërtetë pastërtia është nga besimi, por çfarë t’i bësh, kur Shiitët nuk i japin rëndësi pastërtisë kështu ndodh.”

Përgjigjet e këtij njeriu në ministri ishin plotësisht të njejta me ato të dijetarit të Shiitëve në Nexhef. Përgjigjet e tij në një mënyrë aq të përshtatshme me ato të dijetarit në Nexhef më çuditën shumë. Dhe mbi të gjitha ky njeri dinte të fliste Persisht.

Sekretari: “Sikur të ishe takuar edhe me të vërtetët e 4

personave të tjerë tani mund të flisje edhe me to edhe ta shihje se sa shumë ngjajnë me të vërtetët.” Unë i thashë: “Unë e di se si mendon Shejhulislami, sepse Mësuesi im në Stamboll Ahmed efendiu më ka folur shumë për Shjehulislamin.” Sekretari: “Atëherë urdhëro, mund të flasësh edhe me kopjen e tij.”

U afrova pranë atij që i ngjante Shejhulislamit dhe i thashë: “A është farz t’i bindesh Halifes?” U përgjigj. “Po është vaxhib. Ashtu siç është farz t’i bindesh Allahut dhe pejgamberit, t’i bindesh Halifes është vaxhib”. “Cili është argumenti për këtë?” e pyeta. Më tha: “A nuk e ke dëgjuar këtë ajet të Allahut? **“O ju që besuat Bindjuni Allahut, Pejgamberit të Tij dhe prijësve tuaj”**”^[1] E pyeta përsëri “A na urdhëron Allahu ne që t’i bindemi Halife Jezidit i cili i dha urdhër ushtarëve të tij të plaçkisnin Medinen dhe që vrau nipin e Pejgamberit Hysenin, dhe Halife Velidit që përdorte pije alkoolike?” Përgjigja e tij ishte kjo: “Bir, Jezidi ishte Eir-ul muminin nga ana e Allahut. Nuk ka dhënë urdhër për vrasjen e Hysenit. Mos i beso gënjeshtreve të Shiitëve! Lexoi me kujdes librat! Bëri gabim. Më pas bëri teube, sa për dhënjën leje për plaçkitjen e Medinei muneverres ka patur të drejtë. Populli i Medines ishte shthurur dhe nuk bindej. Përsa i përket Velidit, është e vërtetë që ka qenë gjynahqar. Nuk është vaxhib që të veprosh si halifeja, por t’i bindesh atij në urdhërat që janë në përshtatje me Islamin”. Këto gjëra ia pata pyetur edhe mësuesit tim Ahmed efendiu dhe vetëm me një ndryshim të vogël pata marrë të njejtat përgjigje.

Më pas e pyeta sekretarin: “Cila është arsyeja e përgatitjes së këtyre njëlloj si të vërtetët?” M’u përgjigj: “Ne me anë të këtyre arrijmë të kuptojmë aftësitë menduese të Sulltanit dhe të dijetarëve qoftë Shiitë, qoftë Syni.mundohemi që me anë të këtyre të marrim masat e duhura për luftën tonë fetare dhe politike. Për shembull, n.q.s e di se nga cili drejtim do të vijë ushtria e armikut merr masat dhe e vendos ushtrinë tënde në pozicion të përshtatshëm, kështu e ke të lehtë ta shpartallosh armikun, por n.q.s nuk e di se nga do të sulmojë armiku i shpërndan ushtarët e tu gjithandej dhe në këtë rast është armiku që të shpartallon ty. Pra, po në këtë mënyrë, po t’i dish argumentet që sjellin muslimanët për të vërtetuar se feja e tyre është feja e vërtetë është e lehtë të përgatisësh argumente për të kundërshtuar argumentet e këtyre dhe në këtë mënyrë t’i lëkundësh besimet e tyre.”

Më pas më dha një libër me 1000 fletë i cili bënte fjalë rreth

[1] Sureja Nisa, ajeti 59

çështjeve ushtarake, finaciare dhe fetare që ishin vënë re gjatë fjalosjeve të këtyre njerëzve dhe nga studimi i planeve të tyre. Më porositi që t'ia dorëzoja përsëri pasi ta kisha lexuar. E mora librin dhe e shpura në shtëpi. Pas studimit të kujdesshëm që i bëra e mësova mirë nga fillimi deri në fund për tre jave.

Libri ishte i një lloji që të çudiste shumë. Përgjigjet dhe studimet e rëndësishme që bënin pjesë aty ishin si të vërteta, sipas meje mendimet e 5 kopjeve ishin më shumë se 70 përqind të ngjashme me mendimet e personave të vërtetë. Edhe më parë sekretari më pati thënë që përgjigjet e tyre janë 70 përqind të njëjta me ato të të vërtetëve.

Pasi e lexova këtë libër m'u shtua akoma më tepër besimi tek shteti im dhe e kuptova se ishin bërë planet për shkatërrimin e perandorisë Osmane brënda një kohe më të shkurtër se një shekull, sekretari më tha: “Në dhoma të tjera kemi tavolina të ngjashme me atë që pe, të mbushura me kopjet e liderëve të shteteve që kemi nën sundim ose kemi plane ti sundojmë së shpejti”

E pyeta sekretarin: “Ku i gjeni persona kaq të zotë dhe rigorozë si këto?” Ai m'u përgjigj: “Agjentët tanë në të gjithë botën na sjellin vazhdimish njohuri. Këto kopje që pe janë specialistë në punën e tyre. Padyshim që edhe ti po të paisesh me të gjitha njohuritë personale të një personi fillon të mendosh dhe të veprësh si ai, sepse tashmë je vetëm një kopje e tij”.

Sekretari e vazhdoi fjalën e tij duke thënë: “Ky ishte sekreti i parë që ministria më urdhëroi të të tregoj, sekretin e dytë do të ta tregoj pas një muaji, kur të më kesh kthyer librin me 1000 faqe.”

Unë e lexova librin pjesë pjesë me një kujdes të madh deri në fund. Në sajë të këtij libri m'u shtuan njohuritë rreth Muhamedanëve. Mësova mirë se si mendojnë ata, pikat e tyre të dobëta dhe pikat e tyre të forta, por sidomos se si mund t'i kthenim këto pika të forta në pika të dobëta.

Pikat e dobëta të muslimanëve që përmenden në këtë libër janë:

1-Mosmarrëveshjet midis Shiitëve dhe Synive, mosmarrëveshjet midis Sulltanit dhe popullit^[1] mosmarrëveshjet midis Turqisë dhe Iranit, mosmarrëveshjet mes ashireteve dhe

[1] Këto fjalë janë shumë të gabuara. Edhe vetë e ka përmendur më sipër se bindja ndaj Sulltanit është vaxhib.

mosmarrëveshjet midis dijetarëve dhe shtetit.^[1]

2-Me një përjashtim të vogël, muslimanët janë të paditur.^[2]

3-Mungesa e fuqisë shpirtërore e diturisë dhe pavetëdijshmëria.^[3]

4-Braktisja e kësaj bote dhe marrja gjithë kohën e ahiretin.^[4]

5-Udhëheqësit janë Diktatorë dhe shtypës.^[5]

6-Rrugët janë të pasigurta, ngarkesat dhe udhëtimet po ashtu.^[6]

7-Nuk merren masa kundra sëmundjeve të tilla si kolera që çdo

[1] Edhe kjo është shpifje. Rëndësia e madhe që i jep perandoria Osmane dijetarëve shkruhet gjatë në testamentin e Osman Gazit (themeluesi i perandorisë Osmane). Të gjithë Sulltanët u kanë dhënë dijetarëve postet më të larta. Kur dashakeqët e Mevlana Halid Bagdatit e spiunuan atë tek Sulltani Mahmudi i dytë dhe kërkuan ekzekutimin e tij, është e famshe përgjia e tij “Dijetarët nuk i sjellin dëme shtetit” dhe e refuzoi kërkesën e tyre, sulltanët e perandorisë Osmane u jepnin dijetarëve shtëpi, ushqime dhe pagesë të lartë.

[2] Veprat e mijëra dijetarëve Osmallinj rreth fesë, moralit, edukatës, besimit, dhe shkencave të ndryshme i njehe një botë e tërë. Edhe fshatarët që supozoheshin si të paditur i dinin mjaft mirë fenë e tyre, ibadetet dhe zanatet e ndryshme. Në çdo fshat kishte xhami, shkollë dhe medrese. Këtu njerëzit mësonin të shkruanin, të lexonin si dhe dituri fetare e shkencore. Gratë fshatare dinin të lexonin Kur’ani kerimin. Dijetarët e përgatitur nëpër fshatra dhe evlijatë ishin në numër të madh.

[3] Fuqia shpirtërore e Muslimanëve Osmanllinj ishte shumë e madhe. Populli vraponte drejt luftës për të arritur gradën e shehidit. Pas çdo namazi dhe pas namazit të Xhumase dijetarët e fesë bënin dua për Halifen dhe shtetin dhe i gjithë populli thonte amin pas tyre. Fshatarët e krishterë nuk dinë shkrim e këndim, janë analfabetë, nuk kanë fare haber nga feja ose nga dituritë e kësaj bote, fe quajnë gënjeshtat e priftërinjve dhe legendat. Janë si kope kafshesh të pavetëdijshëm.

[4] Islami nuk e ka ndarë fenë nga punët e kësaj bote, siç ka bërë krishtërimi. Edhe marja me punët e kësaj bote është ibadet. Pejgamberi jonë ka thënë: **(Punoni për këtë botë sikur nuk do të vdisnit kurrë dhe punoni për ahiretin sikur do të vdisnit nesër!)**. Në një kohë që në ungjill është e ndaluar të merresh me punët e kësaj bote.

[5] Udhëheqësit bënin presjon për të imponuar urdhërat të fesë. Nuk bënin krime si mbretërit e Evropës.

[6] Rrugët ishin aq të sigurta sa një musliman mund të ngrihej nga Bosnja e të shkonte në Mekë pa para, gjatë rrugës hante, pinte nëpër fshatra, merte dhe dhurata.

vit çon në vdekje dhjetëra mijëra njerëz, nuk i japin rëndësi shëndetësisë.^[1]

8-Qytetet janë të shkatërruar dhe nuk ka ujësjellësa.^[2]

9-Qeveria është e pafuqishme ndaj kryengritësve dhe shkelësve të ligjit. I praktikojnë shumë pak ligjet e Kur'ani kerimit me të cilin lavdërohen aq shumë.^[3]

10-Ekonomia është e shkatërruar, mbizotëron varfëria dhe janë të prapambetur.

11-Nuk kanë një ushtri të rregullt, janë të paarmatosur dhe armët që kanë i kanë klasike dhe të prishura.^[4]

12-Mosrespektimi i të drejtave të grave.^[5]

13-Mungesa e pastërtisë së ambientit.^[6]

Libri pas përmendjes së “pikave të dobëta” të muslimanëve që përmenda më lart, sygjeronte se muslimanët duheshin lënë të paditur për epërsitë shpirtërore dhe materiale të fesë së tyre Islamit.

Gjithashtu libri jepte edhe këto njohuri rreth Islamit:

1-Islami emëron bashkimin dhe ndalon përçarjet. Në Kur'an

[1] Në çdo vend kishte spitale. Bile edhe Napoleonin Osmallinjë e kanë kuruar. Të gjithë muslimanët i përshtaten Hadithit sherif (**Kush ka beism, është i pastër**).

[2] Këtyre shpifjeve nuk ia vlen fare tu kthesh përgjigje, shahu i Dehliut Firuzi, i cili ka vdekur më 1388 (Hixhri 790) ka bërë një kanal të gjërë dhe 240 Km të gjatë për të vaditur kopshtet dhe arat. Ky kanal dhe vendet pas pushtimit të Anglezëve u kthye në shkretëtirë. Edhe mbetjet e arkitekturës Osmane në ditët e sotme i mrekullojnë sytë e turistëve.

[3] I mendojnë muslimanët si gjeneralët Francezë të cilët mernin medalje duke derdhur pislleqet e mbretërve të tyre në lumin Sen.

[4] A nuk dinë këto për ushtritë e përkryera të Orhan gazit që hipi në fron në vitin 1326 (Hixhri 726) dhe të Jëlldërëm Bejazidit, e cila në vitin 1399 (Hixhri 799) mposhti ushtrinë e Kryqëzatave në Nigabollu?

[5] Kur Anglezët nuk ia kishin haberin fare nga tregëtia, zanati, armët dhe të drejtat e grave, tek Osmanllinjët këto ishin në mënyrën më të përsosur. A mund ta mohojnë edhe që mbretërit e Suedisë dhe të Francës kanë kërkuar ndihmë prej Osmanllinjve?

[6] Rugët ishin shumë të pastra. Bile kishte punonjës të posaçëm detyra e të cilëve ishte të pastronin pështymat.

thuhet: **“Kapuni të gjithë pas litarit (fesë dhe Kur’anit) të Allahut”**^[1]

2-Islami emëron të bëhesh i vetëdijshtëm dhe të krijosh njohuri. Në Kur’an thuhet: **“Shëtitni në tokë”**^[2]

3-Islami emëron të mësosh dituri. Në një hadith thuhet: **(Të mësosh dituri është farz për çdo musliman dhe muslimane).**

4-Islami emëron që të punosh për këtë botë. Në Kur’ani kerim thuhet: **“Disa nga ata thonë, o Allah na jep të mirë edhe në këtë botë edhe në Ahiret”**^[3]

5-Islami emëron konsultimin me të tjerët. Në Kur’an thuhet: **“Ato këshillohen mes tyre”**^[4]

6-Islami emëron të ndërtohen rrugë. Në Kur’an thuhet: **“Shëtitni në tokë”**^[5]

7-Islami i urdhëron muslimanët të tregojnë kujdes për shëndetin e tyre. Në një Hadith thuhet: **(Dituria është katër pjesë: 1) Dituria e fikhut, për të mbrojtur fenë, 2) Dituritë e mjekësisë, për të mbrojtur shëndetin, 3) Dituritë sarf dhe Nahv, për të mbrojtur gjuhën, 4) Dituritë e Astronomisë, për të llogaritur kohën.)**

8-Islami emëron të ndërtohet. Në Kur’an thuhet: **“Allahu çdo gjë që ka në tokë e ka krijuar për ju”**^[6]

9-Islami urdhëron rregullin. Në Kur’an thuhet: **“Çdo gjë është vendosur me rregull”**^[7]

10-Islami urdhëron që të jesh i fuqishëm ekonomikisht. Në një Hadithi sherif thuhet: **(Punoni për këtë botë sikur nuk do të vdisnit kurrë dhe punoni për ahiretin sikur do të vdisnit nesër!)**

11-Islami urdhëron të krijosh një ushtri të paisur me armë shumë të fuqishme. Në Kur’an thuhet: **“Përgatitni forcë (ushtri) kundër tyre, me sa të keni mundësi”**^[8]

12-Islami urdhëron të respektohen të drejtat e grave dhe të

[1] Sureja Ali Imran, ajeti 103

[2] Sureja Ali Imran, ajeti 137

[3] Sureja Bekare, ajeti 201

[4] Sureja Shura, ajeti 38

[5] Sureja Mulk, ajeti 15

[6] Sureja Bekara, ajeti 29

[7] Sureja Hixhr, ajeti 19

[8] Sureja Enfal, ajeti 60

vlerësohen ato. Në Kur'an Thuhet: **“Ashtu siç kanë burrat të drejta mbi gratë edhe gratë kanë të drejta mbi burrat”**^[1]

13-Islami urdhëron pastërtinë. Në një Hadithi sherif thuhet: **(Pastërtia vjen nga besimi).**

Më poshtë janë shënuar zakonet e muslimanëve, të cilat libri urdhëron të prishen dhe të zhduken.

1-Islami i ka ndaluar ndjenjat e racizmit, ndaj gjyres, gjuhës, popullit, dhe zakoneve.

2-Kamata, zinaja, pijet alkoolike dhe mishi i derrit janë të ndaluara.

3-Muslimanët janë shumë të lidhur pas dijetarëve.

4-Muslimanët Syni e pranojnë Halifen si zëvendësin e Pejgamberit. Besojnë se është farz të tregojnë ndaj tij respektin që tregojnë ndaj Allahut dhe Pejgamberit.

5-Xhiahadi është farz.

6-Sipas Shiitëve të gjithë jomuslimanët dhe Synitë janë pisllek.

7-Muslimanët besojnë se Islami është feja e vetme e vërtetë.

8-Shumica e Muslimanëve mendojnë se është farz të nxirren të gjithë të krishterët dhe Çifutët jashtë gadishullit Arabik.

9-I kryejnë në një mënyrë të përsosur ibadetet (Namazin, agjërimin, haxhin...).

10-Shiitët mendojnë se ndërtimi i kishave në shtetet muslimane është haram.

11-Muslimanët janë shumë të lidhur me besimin Islam.

12-Shiitët e quajnë farz që një të pestën e pasurisë t'ua japin dijetarëve.

13-Muslimanët i edukojnë fëmijët në një mënyrë të tillë që është e pamundur të mos ndjekin rrugën e të parëve tyre.

14-Gratë muslimane mbulohen aq bukur saqë është e panudur të shpifësh për to.

15-Muslimanët 5 herë në ditë falin namaz me xhemat, i cili i bashkon ato.

16-Sipas tyre varret e Pejgamberit, Aliut dhe të dijetarëve të mëdhenj janë të shenjtë, për këtë arsye mblidhen tek këto varre.

17-Ata që vijnë nga familja e Pejgamberit (Sejjidët dhe Sherifët) bëjnë që të kujtohet Pejgamberi dhe të mbetet i gjallë tek Muslimanët.

[1] Sureja Bekara, ajeti 228

18-Kur mblidhen Muslimanët sëbashku, predikuesit flasin dhe u forcojnë atyre besimet e i nxisin për të bërë ibadete.

19-Emri bil marruf (Të urdhërosh të mirën) nehji anil munker (të ndalosh të keqen) është farz.

20-Për shtimin e muslimanëve është synet të martohesh dhe të marrësh më tepër se një grua.

21-Për një musliman të fusi një njeri në Islam është më mirë se sa të ketë gjithë botën nën sundim.

22-Midis muslimanëve është shumë i përhapur Hadithi sherif: **(Kush hap një rrugë të mirë fiton sevapin e asaj dhe sevapin që fitojnë të gjithë njerëzit që shkojnë në atë rrugë).**

23-Muslimanët tregojnë një respekt të madh ndaj Kur'anit kerim dhe Haditheve. Bësojnë së të veprojnë sipas tyre është rruga e vetme për t'u futur në xhenet.

Libri sygjeron shkatërrimin e pikave të forta të muslimanëve dhe përhapjen e pikave të dobëta dhe rendit mënyrat se si mund të arrihet kjo gjë.

Për të përhapur pikat e dobëta sygjeron këto gjëra:

1-Përçarja e muslimanëve duke futur armiqësinë mes tyre, duke përhapur mendimet e këqija mes njerëzve dhe duke botuar libra që nxisin përçarje.

2-Të ndalohet hapja e shkollave dhe botimi i librave, të digjen dhe të asgjeshen të gjithë ato libra të fesë që është e mundur. Të shpifim për dijetarët e fesë në mënyrë që t'i bëjmë prindërit të heqin dorë nga çuarja e fëmijëve nëpër shkolla fetare e në këtë mënyrë t'i lejmë këta fëmijë të paditur.. [Ky veprim po i bën një dëm shumë të madh Islamit]

3-4- Të lavdërojmë shumë xhenetin dhe t'u themi muslimanëve që nuk janë të detyruar të punojnë për këtë botë. Të zgjerojmë grupet e tasavufit (meditim shpirtëror). Ti nxisim njerëzit të lexojnë librat **(Ihjaul ulumiddin)** të Gazaliut, librin **(Mesnevi)** dhe veprat e Muhjiddn Arabi't, libra këto të cilët sygjerojnë **(Zuhd)** braktisjen e punëve dhe kënaqësive të kësaj bote, në mënyrë që të jetojnë të pavetëdijshëm.^[1]

5-Duhet t'i nxisim dijetarët që të bëjnë padrejtësi dhe diktaturë. Duhet t'u themi atyre: "Ju jeni hija e Allahut në Tokë.

[1] **(Zuhd)** që përmendet në këto libra nuk do të thotë të braktisësh punët dhe kënaqësitë e kësaj bote. Kjo do të thotë të mos jepesh shumë pas kësaj bote. Pra të punosh, të fitosh dhe të haxhosh në përputhje me ligjet e Islamit është sevap njëlloj si të bësh ibadete.

Edhe Ebu Bekri, Omeri, Osmani, Aliu dhe halifet e Abbasëve dhe Emevive, kanë ardhur në pushtet duke përdorur forcën dhe po me forcë kanë qëndruar të vetëm në krye. P.sh Ebu Bekri e ka marrë pushtetin duke djegur shtëpitë e të pabindurve, si shtëpinë e Fatimes.^[1] Omeri është bërë Halife me këshillën e Ebu Bekrit. Ndërsa Aliu ka ardhur në pushtet me anë të kryengritësve. Muavija^[2] ka ardhur në pushtet duke përdorur shpatën. Tek Emevitë pushteti është pasuar me trashëgimi. Po e njëjta gjë ka ndodhur tek Abbasët. Duhet t'u mbushim mendjen njerëzve se këto janë argumentet se pushteti në Islam është diktaturë.

6- Të heqim nga ligjet nenin për ekzekutimin e vrasësve. [E vetmja rrugëzgjdhje ndaj vrasjeve dhe kusarisë është vetëm ekzekutimi. Po nuk ekzistoi ligji i ekzekutimit nuk mund të ndalohen dot vrasjet dhe anarkia.] Duhet që të pengojmë shtetin që të mos i dënojë kusarët dhe grabitësit e rrugëve, duhet të

[1] Nëpër Hadithe është treguar se Ebu Bekri, Omeri, Osmani dhe Aliu “Radijallahu anhum” do të bëheshin Halife, por koha se kur do të bëheshin nuk ka qënë e caktuar për asnjërin. Resulullahu “Sal-lallahu alejhi ve sel-lem” u’a ka lënë në dorë Es’habëve këtë zgjedhje. Titulli Halife, nuk ishte një mall që duhej t’i lihej trashëgim të afërmeve. Ato e panë të arsyeshme që Halife të zgjidhnin Ebu Bekrin, i cili është bërë musliman më parë, ka futur edhe të tjerët në besim, ka bërë hixhret (është shpërngulur) sëbashku me Pejgamberin, dhe Pejgamberi e ka bërë atë imam e është falur pas tij. Disa njerëz vajtën tek shtëpia e hazreti Aliut. Ebu Sufjani, i cili ishte njëri prej tyre tha: “Zgjate dorën! Të të njoh ty si prijës. Po të dëshirosh e mbush vendin me ushtarë”. Hazreti Aliu nuk e pranoi këtë gjë dhe tha: “Mos dëshironi vallë të përçani Muslimanët? Mos dalja ime nga shtëpia nuk është për shak se desha të bëhem Halife, por sepse jam prekur shumë nga ndarja e Resulullahut. Jam bërë si i çmendur.” Shkoi në faltore dhe në prani të të gjithëve e njohu Ebu Bekrin si prijës. Ebu Bekri tha: “Nuk dëshiroja të bëhesha Halife, por u detyrova që të pranoj që të mos dalin ngatërresa” Aliu tha: “Ti e meriton më shumë që të bëhesh Halife”. Fjalët që Aliu tha atë ditë për të lavdëruar Ebu Bekrin janë të shkruara në pikën e 23’të të pjesës së dytë të librit **“Seadeti Ebedije”**. Hazreti Omeri e përcolli hazreti Aliun deri në shtëpi. Hazreti Aliu gjithmonë thoshte: “Pas Resulullahut njerëzit më të lartë të këtij ymeti janë Ebu Bekri dhe Omeri”. Ata që kanë rënë pre të gënjeshtreve dhe të shpifjeve të Shiitëve janë bërë shkak që Muslimanët të bien në gjendjen ku ndodhen sot. Anglezët vazhdojnë ta nxisin akoma edhe sot këtë shpifje.

[2] Hazreti Muavije është bërë Halife i ligjshëm me pranimin e hazreti Hasanit. Për më tepër lexoni librin **“Hak Sözü’n Vesikalari”**.

armatosim kusarët dhe grabitësit dhe t'i nxisim ato në veprat e tyre në mënyrë që rrugët të mbeten gjithmonë të pasigurta.

7- Mund të bëjmë të mundur që ato të jetojnë mes sëmundjeve, duke përdorur këtë rrugë: Duhet t'u themi atyre: “Çdo gjë ndodh me caktimin e Allahut. Kurimi nuk luan asnjë rol në shërimin e sëmundjeve. Allahu në Kur'an ka thënë: **(Allahu më jep për të ngrënë e për të pirë. Kur jam i sëmurë Ai më jep shërim. Ai është i cili do të më marrë shpirtin dhe do të më ringjallë përsëri)**”^[1] Pra përveçse me dëshirën e Allahut askush nuk mund të gjejë shërim dhe nuk mund t'i shpëtojë vdekjes.^[2]

8- Mund të bëjmë të mundur përhapjen e padrejtësive duke thënë: Islami është fe e ibadetit (adhurimit). Kjo fe nuk ka asnjë lidhje me punët e shtetit. Për këtë arsye Muhammedi dhe Halifet nuk kanë patur as ministra e as ligje.^[3]

9- Rrënimi ekonomik është një pasojë e pashmangshme e planeve që përmendëm deri tani. Këto dëme ekonomike mund t'i shumëfishojmë duke prishur prodhimet bujqësore, duke mbytur anijet tregëtare, duke djegur tregjet, duke shembur pritat e ujit me qëllim që të përmbysten tokat bujqësore dhe vendet industriale dhe duke helmuar ujin e pijshëm.^[4]

10- Duhet që t'i fusim qeveritarët në mosmarrveshje [me anë të grave dhe sportit] dhe t'i bëjmë ato të mësohen me qejfe të tilla si

[1] **Sureja Shuara, ajeti: 79-80-81**

[2] Anglezët me qëllim për të mashtruar muslimanët u japin kuptim të gabuar ajeti kerimeve dhe hadithi sherifeve. Të kurohesh është synet. Allahu teala shërimin e ka krijuar tek ilaçet. Pejgamberi e ka urdhëruar përdorimin e ilaçeve. Allahu është Ai që ka krijuar çdo gjë e që na jep shërimin, por çdo gjë e ka krijuar me anë të shkaqeve dhe na urdhëron që të kapemi pas këtyre shkaqeve. Duhet të mundohemi t'i gjejmë këto shkaqe e t'i përdorim ato. **(Ai më jep shërim)** nuk do të thotë se jep shkaqet e shërimit. Ne jemi urdhëruar të punojmë për të gjetur shkaqet. Pejgamberi jonë ka thënë: **“Edhe burrat edhe gratë e kanë farz të punojnë e të mësojnë dituri”**, një herë tjetër ka thënë: **“Allahu teala i do ato të cilët punojnë dhe fitojnë”**.

[3] Ibadeti nuk është vetëm namazi, agjërimi dhe haxhi. Të bësh punët e kësaj bote sepse ka urdhëruar Allahu dhe të punosh sipas ligjeve të Islamit është përherë ibadet. Të punosh për të bërë punë me vlerë është shumë sevap.

[4] Shikoni pak se çfarë planesh kanë përgatitur për muslimanët, Anglezët të cilët e mbajnë veten për të civilizuar dhe i përmendin aq shumë të drejtat e njeriut.

alkooli, bixhozi, ryshveti dhe përdorimi i mallit të shtetit për nevojat personale, vese që do t'i çojnë ato në përçarje. Gjithashtu duhet t'i shpërblejmë mirë ato zyrtarë që punojnë në shërbimin tonë.

Më pas në libër këshilloheshin këto gjëra: Duhet të mbrojmë fshëhtazi dhe haptazi të gjithë agjentët anglezë që janë ngarkuar me detyrën e zbatimit të këtyre planeve dhe duhet të bëjmë çfarëdolloj shpenzimi për të shpëtuar ato që kanë rënë në dorë të muslimanëve.

11- Duhet të përhapim të gjitha llojet e kamatës, sepse kamata jo vetëm që e shkatërron ekonominë e vendit, por në të njëjtën kohë i mëson muslimanët që të kundërshtojnë urdhërat e Kur'anit. Sepse një njeri po arriti të shkelë një rregull, më pas e ka të lehtë që të shkelë të gjithë rregullat dhe ligjet e tjerë. Përhapni mes njerëzve idenë se kamatë quhet vetëm ajo kur vlera shtohet shumfish, sepse në Kur'an thuhet: **“Mos e hani kamatën duke e shumëfishuar”**.^[1] Pra në këtë mënyrë mund t'i bindni ato se jo çdo formë e kamatës është haram.^[2]

12- Duhet që të shpifim gjëra të këqija për dijetarët në mënyrë që t'a largojmë popullin prej tyre. Për t'ia arritur këtij qëllimi, një pjesë të agjentëve tanë do t'i maskojmë si dijetarë. Më pas do t'i urdhërojmë këto agjentë që të bëjnë punë të shëmtuara. Ngaqë këto agjentë do të duken si dijetarë të vërtetë atëherë populli do të dyshojë tek të gjithë dijetarët. Është shumë e rëndësishme që këto agjentë t'i fusim në Stamboll, El-Ez'here, Nexhef dhe Kerebela. Do të hapim shkolla dhe kolegje tonat në mënyrë që t'i largojmë muslimanët nga dijetarët e tyre. Fëmijët Grekë dhe Armenë që do të studiojnë në këto shkolla do t'i edukojmë që të urrejnë Islamin dhe muslimanët. Fëmijët muslimanë do t'i bindim se të parët e tyre kanë qenë të paditur. Do t'u mbushim mendjen fëmijëve se

[1] **Sureja Ali Imran, ajeti 130**

[2] Kur jepet borxh nuk caktohet dita e pagesës. N.q.s caktohet quhet faide. N.q.s bëhet marrëveshje që borxhmarrësi të paguajë më tepër se sa shuma që merr borxh është faide. Në këtë lloj faideje po të bëhet marrëveshje për të paguar sikur edhe vetëm një dirhem (masë e vogël) më tepër është gjynah i madh. Ndërsa në shitjet me kredi duhet të caktohet dita e pagesës. Kur vjen dita e pagesës dhe blerësi nuk e bën dot pagesën, n.q.s në këtë rast shtohet afati i pagesës, por shtohet edhe shuma që duhet të paguajë, atëherë kjo quhet **(Muda'af faiz)**. Në ajetin kerim që përmendet më sipër bëhet fjalë për këtë lloj Faideje që ngodh në tregëti.

Halifet, dijetarët dhe prijësit e tyre bëjnë shumë gabime, e kalojnë kohën duke plotësuar kënaqësitë e tyre, Halifet kalojnë kohën me gra të bukura dhe e shpërdorojnë pasurinë e popullit, në këtë mënyrë populli do ta humbi respektin ndaj tyre.

13- Do të mundohemi për të përhapur mendimin se Islami i poshtëron gratë, duke përhapur ajetin: **“Burrat janë përgjegjës mbi gratë”**^[1] dhe hadithin **“Të gjitha gratë janë larg fesë”**.^[2]

[1] **Sureja Nisa, ajeti: 34**

[2] Në hadithin sherif thuhet: **“Gruaja që jeton Islamit është nga mirësitë e xhenetit. Gruaja që i bindet ndjenjave të veta është larg fesë”**. Babai është i detyruar të kujdeset për të bijën e tij të varfër, qoftë vajzë apo vejushë. N.q.s Babai nuk kujdeset për të, atëherë burgoset. N.q.s nuk e ka babain, ose Babai është i varfër, atëherë një nga të afërmit e pasur që e kanë të ndaluar martesën me të, duhet të kujdeset për të. N.q.s nuk ka as të afërm të pasur atëherë shteti i jep rrogë. Pra ferma muslimane nuk ka nevojë që të punojë për të fituar. Feja Islame të gjitha nevojat e gruas i ka ngarkuar mbi supet e burrit. Në bazë të kësaj barre të rëndë që kanë burrat duhet që e gjithë e drejta e trashëgimisë t’u takojë atyre, por këtu Allahu teala ka treguar mëshirë për gratë dhe ka urdhëruar që të marrin nga trashëgimia sa gjysma e vëllezërve. Burri nuk mund ta detyrojë gruan të punojë brenda ose jashtë shtëpisë. N.q.s gruaja ka dëshirë të punojë dhe burri i jep lehtë është e lejuar të punojë e mbuluar dhe në vende pa burra. Në këtë rast gjithçka që fiton është pasuria e saj personale. Askush nuk mund t’ia marrë gruas pa dëshirë atë që fiton nga puna e saj, trashëgiminë dhe mehrin (pagesë të caktohet gjatë lidhjes së martesës, të cilën burri duhet t’ia paguajë gruas). Gruaja nuk mund të detyrohet që të punojë për të siguruar nevojat e veta, të fëmijëve ose të shtëpisë. Të gjitha këto është i detyruar që ti sigurojë mashkulli. Në vendet Komuniste edhe gratë sëbashku me burrat detyrohen të punojnë në punë të rënda njëllor si kafshët. Në shtetet e krishtere që quhen vendet e lirisë dhe në disa shtete Arabe që mbahen për shtete muslimane duke thënë “Jeta është e përbashkët” i vejnë edhe gratë të punojnë në fabrika, nëpër ara dhe në tregëti njëllor si meshkujt. Gjykatat e ketyre vendeve janë të mbushura me çështje ndarjesh të çiftëve që janë penduar përse janë martuar, kjo vihet re nga shkrimet e shpeshta nëpër gazeta. Fjalët që kanë dalë nga goja e shenjtë e Resulullahut “Sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem” janë tre llojesh: lloji i parë: edhe fjalët edhe kuptimet janë nga Allahu teala. Këto fjalë në veçanti quhen **ajete kerim** dhe të gjitha së bashku **Kur’ani kerim**. Fjalët: **“Çdo gjë e mirë që ju vjen juve, ju vjen nga Allahu me dëshirën e Tij. Çdo gjë të keqe e dëshironi vetë ju. Çdo gjë e krijon dhe e dërgon Allahu”**, janë ajeti i 78’të i sures **Nisa**. Lloji i dytë: fjalët janë fjalët e Allahut, ndërsa kuptimi është nga Pejgamberi. Këto quhen **Hadithe kutsi**. Lloji i tretë: edhe fjalët edhe

Pisllëku është përfundimi natyral i mungesës së ujit. Duhet të pengojmë shtimin e ujit.

Në librin që ka përgatitur ministria e Kolonive në Londër flitet për gjërat që duhet të bëhen për të zhdukur Islamin. Ky libër po shpërndahet në mënyrë të fshehtë, me anë të agjentëve.

Për të dobësuar pikat e forta të Muslimanëve sygjerohej këto gjëra:

1-Duhet të nxisim ndjenjat e tilla si racizmi dhe atdhetaria, dhe ta tërheqim vëmendjen e tyre tek heroizmat që kanë bërë përpara Islamit. Egjiptianëve duhet t'u lavdërojmë Faraonët, Iranianëve Mexhunitë, Irakenëve Babiloninë dhe Osmanllinjve kohët e Atilës dhe Xhengizit [kohët e dhunës]. [Në libër kishte një listë të gjatë në lidhje me këtë]

2-Këto katër gjëra duhet të përhapen në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe fshehtas: Pijet, kumari, zinaja dhe mishi i derrit [dhe përçarja e popullit në klube sportive]. Për t'ia arritur këtij qëllimi duhet t'i shfrytëzojmë në maksimum të krishterët, Cifutët, mexhunitë dhe të gjithë jomuslimanët që jetojnë në shtetet muslimane, dhe atyre që na ndihmojnë në këtë plan t'u japim pagesë shumë të lartë nga buxheti i ministrisë së Kolonive. Për t'ia arritur më lehtë qëllimeve tona do të përhapim grupimet politike dhe klubet sportive. Partitë politike dhe klubet sportive do ti bëjmë armiq të njëri-tjetrit. Njerëzit do të merren me njëri-tjetrin e kështu nuk do të gjejnë kohë për të lexuar libra e për të mësuar fenë e tyre. Njerëzve që kemi futur në grackë do t'i bëjmë që të botojnë gazeta. Gazetat dhe revistat do t'ua ushqejmë me shuma të mëdha parash dhe përfitime të ndryshme. Më anë të këtyre do të lavdërojmë si shpëtimtarë dhe heronj njerëzit që kemi blerë dhe punojnë për ne. Do të shajmë ato drejtues të cilët janë të lidhur pas

kuptimet janë nga Pejgamberi. Këto quhen **Hadithe sherif**. Fjalët **“Gruaja që jeton Islamin është nga mirësitë e xhenetit. Gruaja që i bindet ndjenjave të veta është larg fesë”**, janë Hadithi sherif. I nderuari Muhjiddin Arabi e ka shpjeguar këtë Hadith në vëllimin e parë të librit të tij me titull **“Musamerat”**. Agjenti Anglez përmend vetëm fundin e Hadithit, duke e fshehur fillimin e tij. N.q.s gratë në mbarë botën do ti dinin rehatinë, qetësinë, lirinë, të drejtën e ndarjes dhe vlerën e madhe që feja Islame u jep atyre, megjëherë do të bëheshin Muslimane dhe do të punonin për të përhapur Islamin në mbarë botën, por fatkeqësisht nuk arrijnë që t'i kuptojnë këto të vërteta. Allahu teala i'a bëftë të mundur të gjithëve që të mësojnë në mënyrë të drejtë rrugën e ndritur të Islamit!

fesë Islame dhe ligjeve të saj. Do të shkatërrojmë familjet, të cilat janë foleja e edukimit fetar. Me anë të sportit dhe të mundjes do t'i bëjmë njerëzit të zbulojnë aurretet e tyre (pjesët e trupit që është farz të mbulohen) dhe duke botuar fotografi vajzash dhe djemsh me vendet e turpshe të zbuluara do ta shtyjme rininë në kurvëri dhe në çrregullime seksuale. Po të arrijmë të prishim edukatën Islame atëherë e kemi të lehtë ta asgjesojmë Islamin. Do të ndërtojmë shumë xhami, por në këto xhami nuk do të vendosim të flasin hoxhallarët e vërtetë, por misionerët dhe njerëzit pa medhheb. Nën emrin muzikë Islame do të fusim nëpër xhami veglat muzikore, këngët [radiot]. Do t'i përdorim xhamitë si gracka. Agjentët tanë do të përcaktojnë të gjithë ato nënpunës të cilët shkojnë në xhami dhe i mbajnë gratë e tyre të veshura sipas Islamit. Këto nënpunës do të largohen nga detyrat. Të rinjtë që jetojnë sipas ligjeve të Islamit nuk do të futen dot në universitet, ata që kanë arritur të futen do të pengohen që të mos e marrin dot dipllomën, sekretari më porositi që këto njohuri të mbeten sekrete, gjithashtu më porositi në veçanti që as Nexhdi Muhammedit të mos i flas asgjë në lidhje me këto. Edhe unë ia dorëzoja këto kujtime gjykatës dhe lashë testament që të mos hapeshin përpara 50 vjetëve. [Një gjë duhet të kihet parasysh: xhami nuk quhet ajo ndërtesë që ka kube dhe minare. Xhami quhet ai vend ku falet 5 herë në ditë namaz me xhemat. Është e lejuar që t'i mbahet vazë xhematit përpara ose pas namazit. Vazë do të thotë: fjalët që flet një musliman i besimit Ehli synet, duke lexuar nga ndonjë libër i dijetarëve të Ehli synetit, ose të flasë ato gjëra që ka mësuar përmendësh nga këto libra. Fjalët e njerëzve pa medhheb, agjentëve dhe të misionerëve nuk quhen vazë, por fjalime ose konferenca. Të mbash fjalime ose konferenca në xhami, ose ti dëgjosh këto, sipas Islamit është e ndaluar. Çdo fjalë e dijetarëve të Ehli synetit, janë shpjegimi i Kur'ani kerimit dhe Haditheve sherif.]

3-Duhet t'i bindni njerëzit se xhihadi është një farz i përkohshëm dhe koha e tij tashmë ka kaluar.

4-Do të hiqni nga zemrat e Shiitëve mendimin se kafirët janë pisllek. Do tu thoni njerëzve se në Kur'an thuhet: **“Ushqimet e lejuara për ehli kitabët janë të lejuara edhe për ju. Ushqimet e lejuara për ju janë të lejuara edhe për ehli kitabët.”**^[1] gjithashtu do të thoni se Pejgamberi ka pasur një grua Çifute me emrin Safije dhe një grua të krishtere me emrin Marije, dhe se gratë e

[1] Sureja Maide, ajeti 5

Pejgamberit nuk ka mundësi të kenë qenë pisllek.^[1]

5-Do t'i hiqni Muslimanëve mendimin se Islami është fe e vetme, duke u thënë atyre se Pejgamberi me Islam ka nënkuptuar fe të vetme, dhe se kjo fe mund të jetë edhe feja Çifute ose e Krishtere, si argument për këtë gjë do të keni: Në Kur'an pjesëtarët e çdo feje quhen Muslimanë. P.sh Pejgamberi Jusuf ka thënë **“Ma merr shpirtin si Musliman”**^[2], Pejgamberët Ibrahim dhe

[1] Hazreti Safija që anglezët e quajnë Çifute, ishte bërë Muslimane. Ndërsa Marija që ishte Egjiptiane, nuk ka qenë nga gratë e nderuara të Pejgamberit. Ishte robëreshë. Edhe kjo u bë Muslimane. Xhenazenë e saj e ka falur hazreti Omeri “radijallahu anh”, në kohën kur ishte Halife, sipas Islamit është e lejuar që një grua e krishtere të bëhet robëreshë. Gjithashtu mund të bëhet edhe grua. Vetë kafirët nuk janë pisllek ashtu siç besojnë Shiitët. Pisllek është besimi i tyre i gabuar.

[2] Të besosh ato gjëra që Allahu ka zbritur me anë të cilitdo Pejgamber quhet **Iman**. Dituritë që duhet të besohen janë dy llojesh: Lloji i parë janë ato dituri që duhet vetëm të besohen. Lloji i dytë janë ato dituri që edhe duhet të besohen edhe duhet të veprohen. Fetë e vërteta që ka shpallur çdo Pejgamber janë të njëjta. Të gjithë Çifutët, të krishterët, shkencëtarët në të gjithë botën, drejtuesit e shteteve, komandantët, e njerëz të tillë si këto që të gjithë armiqtë e Islamit i shohin si përparimtarë dhe mundohen që tu ngajnë, që të gjithë i besojnë ahiretit, pra besojnë në ringjalljen pas vdekjes, xhenetin e xhehenemin. A nuk duhet që edhe këto njerëz të tillë që nuk i'a kanë haberin nga feja të besojnë ashtu sikurse besojnë njerëzit të cilët këto i quajnë përparimtarë dhe mundohen që tu ngajnë? Fetë e të gjithë pejgamberëve, pra gjërat e urdhëruara dhe të ndaluara nuk janë të njëjta. Të besosh Islamin dhe të ndjekësh këtë rrugë quhet **Islam**. Meqë fetë kanë qenë të ndryshme, Islami në kohën e çdo pejgamberi nuk ka qenë i njëjtë. Me ardhjen e një Pejgamberi ka ardhur një **Islam** i ri dhe ka përfunduar zbatimi i fesë tjetër. Islami që ka sjellë Pejgamberi i fundit Muhammed “alejhis-selam” do të vazhdojë deri në ditën e Kijametit. Allahu teala në ajetet e 19'të dhe 85'të të sures Ali Imran i ka urdhëruar Çifutët dhe të krishterët që t'i lejnë fetë e tyre të vjetra. Ka treguar se ata të cilët nuk i besojnë Muhammedit “alejhis-selam” nuk do të futen në xhenet dhe do të digjen pafundësisht në xhehenem. Pejgamberët Ibrahim, Ismail, Jusuf dhe Jakub kanë kërkuar Islamin që ka qenë në fuqi në kohët e tyre. Të praktikosh këto fe dhe të shkosh në kishë, nuk bëjnë pjesë në fenë e vërtetë që është në fuqi sot. Në lidhje me këtë mund të gjeni shpjegim të hollësishëm në fund të librit **(El-envar)** të autorit Zerkani. Profesori i medresë Xhamiul ez'her, Muhammed Zerkani Maliki ka vdekur më 1710 (Hixhri 1122).

Ismail kanë thënë: **“O Zot na bëj ne Muslimanë dhe bëji pasardhësit tanë një popull Musliman”**^[1] Pejgamberi Jakup u ka thënë djemve të tij **“Vdisni vetëm si Muslimanë”**.^[2]

6-Duhet të themi shpesh e shpesh se ndërtimi i kishave nuk është haram, Pejgamberi dhe Halifet nuk i kanë shëmbur ato, në të kundërt, kanë treguar respekt ndaj tyre, në Kur'an thuhet: **“Nëse Allahu nuk do t'i zhdukte disa njerëz me disa të tjerë, do të shkatërroheshin manastiret, kishat, havrat dhe xhamitë ku përmendet Allahu”**,^[3] pra feja Islame tregon respekt ndaj faltoreve, nuk i shëmb ato dhe e ndalon shëmbjen e tyre.

7-Do t'i fusni muslimanët në dyshime rreth Haditheve (**Nxirrini Çifutët nga gadishulli Arabik**) dhe (**Në gadishullin Arabik nuk mund të ekzistojnë dy fe**). Duhet tu thoni atyre: “Po të ishin të saktë këto dy Hadithe, Pejgamberi nuk do të ishte martuar me një grua Çifute dhe një grua të krishterë dhe nuk do të kishte bërë marrëveshje me të krishterët e Nexhranit.”^[4]

8-Do të mundoheni t'i pengoni muslimanët në kryerjen e ibadeteve dhe duke thënë: (Allahu nuk ka nevojë për ibadetet e njerëzve). Do t'i fusni ato në dyshime përsa i përket vlerave të ibadeteve.^[5] Do t'i pengoni ato që të kryejnë ibadete që i mbledhin ato sëbashu, siç janë Haxhi dhe namazi me xhemat. Gjithashtu do të mundoheni t'i pengoni ato në ndërtimin e xhamive, tyrbeve, medreseve dhe në riparimin e Qabes.

9-Do t'i fusni ato në dyshime në lidhje me dhënjen dijetarëve një të pestën e mallit të fitur në luftë [Humus], dhe t'u shpjegoni atyre se ky mall nuk ka asnjë lidhje me mallin që përdoret në tregëti. Duhet të thoni: “Humusi u jepet Pejgamberëve dhe Halifeve, jo dijetarëve, sepse dijetarët këtë pasuri e përdorin për të blerë shtëpi, vila, kafshë dhe toka. Për këtë arsye nuk është e drejtë që Humus t'u jepet dijetarëve!”

10-Do të fusni Bid'ate (shtesa në fe) në besimet e Muslimanëve dhe do ta akuzoni Islamin si fe e prapambetjes dhe e terrorit. Do

[1] Sureja Bekara, ajeti 128

[2] Sureja Bekara, ajeti 132

[3] Sureja Haxh, ajeti 40

[4] Shihni referencën numër [2] në faqen 59

[5] Ibadetet bëhen sepse janë të urdhëruara nga Allahu. Po është e vërtetë se Allahu nuk ka nevojë për ibadetet e njerëzve, por njerëzit kanë nevojë për këto ibadete. Vetë shkojnë me turma nëpër kisha, ndërsa Muslimanët i pengojnë që të shkojnë nëpër xhami.

të thoni se shtetet muslimane kanë mbetur prapa dhe janë lëkundur shumë, në këtë mënyrë do të dobësoni lidhjen e fortë që ato kanë me Islamin. [Në një kohë që e vërteta është se Muslimanët kanë krijuar shtetet më të qytetëruara në botë, por e kanë humbur këtë ngaqë i kanë dobësuar lidhjet me fenë.]

11-Kjo pikë është shumë e rëndësishme! Do t'i largoni fëmijët nga prindërit e tyre dhe do të bëni të mundur që të mos e marrin edukimin fetar. Këto fëmijë do t'i edukojmë ne, sepse fëmijët në momentin që do të shkëputen nga edukimi i prindërve do të jenë të dënuar që të shkëputen edhe nga feja edhe nga dijetarët.

12-Do të ngacmoni gratë dhe do të bëheni shkak që të heqin shamitë, si shkak për këtë do të thoni se shamia nuk është një urdhër i Islamit, por një zakon i mbetur nga Abbas'ët. Pasi ti keni zbuluar gratë, do t'i nxisni të rinjtë në drejtim të tyre dhe do të mundoheni që të shkaktoni ngatërresa midis tyre! Ky veprim ka një ndikim tepër të madh në zhdukjen e Islamit. Në fillim këtë gjë do ta bëni me gratë jo muslimane. Më pas gratë muslimane do të prishen vetë dhe do të veprojnë njëloj si këto.^[1]

[1] Përpara se të zbrisnin ajetet në lidhje me Hixhabin (mbulimin e grave me shami), gratë nuk mbuloreshin, për ato gjëra që nuk i dinin vinin tek Resulullahu pyesin e mësonin. Kur Resulullahu shkonte tek shtëpia e ndonjërit edhe gratë vinin, uleshin e dëgjoni dhe përfitonin nga fjalët e tij, sipas tefsirit të **Buhariut** dhe **Bejdavit**, tre vjet pas shpërnguljes (Hixhretit) zbriti ajeti i sures **Ahzab** dhe 5 vjet pas shpërnguljes zbriti ajeti i sures **Nur**, të cilat janë në lidhje me mbulimin e grave. Me anë të këtyre ajeteve u ndalua që gratë të ulen, të qëndrojnë dhe të flasin me burrat. Pas kësaj Resulullahu urdhëroi që gratë për ato gjëra që nuk i dinin të pyesnin gratë e tij. Kafirët i mashtrojnë muslimanët duke mos e thënë që këto ajete kanë zbritur më vonë dhe se mbulimi i grave është urdhëruar më vonë.

Gruaja e nderuar e Resulullahut, Ummu Seleme “radiallahu anha” ka thënë: Ishim pranë Resulullahut “Sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem” sëbashku me gruan e tij të nderuar Mejmunen “radiallahu anha”. Ibni Ummi Mektum kërkoi leje dhe u fut brënda. Resulullahu “Sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem” kur e pa këtë gjë na tha ne: **“Futuni prapa perdes!”**. Unë i thashë: “A nuk është i verbër ai! Nuk na sheh dot!”. Resulullahu tha: **“Edhe ju të verbëra jeni? Nuk e shihni dot atë?”** Pra tha, ai është i verbër por ju nuk jeni. Këtë Hadith e kanë transmetuar Imam Ahmed, Tirmidhiu dhe Ebu Daudi “rrahime-humullahu teala”, sipas këtij Hadithi sherif ashtu si është haram për meshkujt që të shohin gratë e huaja, po ashtu është haram edhe për gratë që të shohin burrat e huaj. Imamët e medhhebeve “rrahime-humullahu teala” duke

13-Do të pengoni faljen e namazit me xhemat. Do të këmbëngulni se imamët e xhamive janë gjynahqarë, në çdo rast do të tregoni gabimet e tyre në mënyrë që të futni urrejtjen mes tyre dhe xhematit.

marrë parasysh edhe hadithet e tjera në lidhje me këtë çështje kanë thënë se gratë e kanë haram që të shohin pjesët e aurretit të burrave të huaj. T'i bindesh kësaj është e lehtë. Urdhërat dhe ndalesat që janë e lehtë të kryhen, si ky, quhen **Ruhsat**. Gratë e kanë mekruh që të shohin fytyrat dhe flokët e burrave. Të ruhesh nga kjo është e vështirë. Të kryesh gjërat që janë të vështira quhet **Azimët**. Aureti i meshkujve quhet pjesa e trupit nga kërthiza e deri tek gjunjët. Është vënë re se ezvaxhi tahirat “Radijallahu anhunne” dhe Es’habët kiram “Radijallahu anhun” kanë vepruar me Azimet dhe i janë shmangur Ruhsatit. Të pafetë që hiqen si muslimanë e që dëshirojnë të shkatërrojnë fenë Islame e duke folur për periudhën para zbritjes së ajeteve të Hixhabit thonë: “Në kohën e Pejgamberit gratë nuk mbuloheshin. Në atë kohë gratë nuk mbulohen si gratë tani që duken si gogol. Hazreti Aishja shëtiste me kokën e pa mbuluar. Këtë lloj mbulimi e kanë nxjerrë më vonë hipokritët dhe njerëzit e fikhut”. Që këto fjalë janë gënjeshtra dhe shpifje tregohen qartë në Hadithe sherif. Katër medhhebet e vërteta që shpjegojnë urdhërat dhe ndalesat e Allahut, i kanë përcaktuar në mënyrë të ndryshme pjesët e trupit që është haram tu ekspozohen të tjerëve (aurretin). Çdo Musliman e ka farz që të mbulojë pjesët e trupit që quhen aurret në medhhebin ku bën pjesë. Të shikosh pjesën e aurretit të personave të tjerë është haram. Në një Hadhithi sherif në librin **“E’shiatul-leme’at”** thuhet: **“Meshkujt të mos i shohin aurretet e meshkujve dhe gratë të mos i shohin aurretet e grave”**, sipas medhhebit Hanefi aureti i meshkujve për meshkujt dhe i grave për gratë është nga kërthiza e deri tek gjunjët. Aureti i gruas për burrat e huaj është komplet trupi përveç duarve dhe fytyrës. Edhe flokët e grave janë aurret. Të shohësh pjesët e aurretit qoftë edhe pa epsh është haram.

“Po të shihni një grua, largojini sytë prej saj! Ta shohësh papritur nuk është haram, por ta shohësh përsëri është haram.”

“O Ali! Mos i zbulo kofshët! Mos i shiko kofshët e asnjërit, qoftë i gjallë apo i vdekur!”

“Allahu e mallkoftë atë që zbulon pjesët e aurretit dhe atë që sheh aurretet e të tjerëve!”

“Kush i ngjan një populli është prej tij”. Ky Hadithi sherif tregon që kush i ngjan armiqve të Islamit, në edukatë, vepra ose veshje, është prej tyre. Ata që shkojnë pas zakoneve të kafirëve, ata që i ngjisin haramëve emrin “arte të bukura”, ata që u thonë atyre që bëjnë haram “ateist”, duhet të marrin shembull nga ky Hadith.

Në librin **“Kimja’yi seadet”** thuhet: “Për gratë dhe vajzat ashtu si

14-Me pretendimin se tyrbet nuk kanë ekzistuar në kohën e Pejgamberit dhe janë bid'at në fe do të thoni se këto tyrbë duhet të shemben. Gjithashtu do t'i fusni njerëzit në dyshim edhe për varret e Pejgamberit, Halifeve dhe njerëzve të dashur të Allahut dhe do ti pengoni ato që t'i vizitojnë këto varre. Do të thoni se: (Pejgamberi së bashku me nënën e tij, Ebu Bekrin dhe Osmanin prehen në varrezën "Baki". Vendi i varrit të Osmanit nuk dihet.

është haram të dalin jashtë me kokë, flokë, krahë ose kofshë të zhveshura, ashtu është haram edhe po të dalin me rroba të holla, të ngushta, të stolisura dhe të parfumosura. Gjithashtu edhe prindërit, vëllai ose burri që i japin leje të shëtisi në mënyrë të tillë janë ortakë në gjynahet e tyre". Pra do të digjen sëbashku në xhehenem. Po të bëjnë teube, falen. Allahu teala i do ato që bëjnë teube.

Ai njeri që i thotë vetes musliman përpara se të bëjë një punë duhet që ta dijë a është e lejuar sipas Islamit apo jo. N.q.s nuk ka dituri për atë çfarë dëshiron të bëjë duhet ta mësojë duke pyetur një dijetar të Ehli synetit ose ta mësojë duke lexuar libin e ndonjërit nga këto dijetarë. N.q.s puna që bën nuk është e përshtatshme sipas Islamit atëherë nuk shpëton dot nga gjynahet dhe nga kufri. Duhet që çdo ditë të bëjë teube të sinqertë. Gjynahu dhe kufri për të cilin bëhet teube falet patjetër. Po nuk bëri teube do të dënohet për veprimin e tij si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër. Llojet e këtyre dënimeve përmenden në vende të ndryshme të këtij libri.

Pjesët e trupit që burrat dhe gratë duhet të mbulojnë gjatë namazit dhe kudo quhen **auret**. Të zhveshësh pjesën e auresit dhe të shohësh auresin e të tjerëve është haram. Ata që thonë se në Islam nuk ekziston auresi bëhen Kafirë. Ata që e quajnë hallall demonstrimin e pjesëve të trupi që quhen auret sipas 4 medhhebeve, ata që nuk i japin rëndësi kësaj gjëje, pra që nuk i tremben dënimit, bëhen kafirë. Për gratë kështu është edhe zbulimi i pjesëve të auresit, këndimi i këngëve në prani të burrave dhe këndimi i mevludit, sipas medh'hebit Hanbeli tek burrat pjesa nga gjuri e deri në rrëzë të kofshën nuk është auret.

Çdo njeri që thotë "Unë jam Musliman" duhet të mësojë dhe tu japi rëndësi të gjitha farzeve dhe haramëve për të cilat të katër medhhebet kanë rënë dakort njëzëri. Të mos i dijë këto nuk është shfajësim. Është njëllloj si ti dijë dhe të mos i veprojë. Pjesët e trupit të grave përveç duarve dhe fytyrës janë auret sipas të katër medhhebeve. Ata që nuk i japin rëndësi dhe i zbulojnë pjesët e trupit që janë auret vetëm sipas medhhebit të tyre, pra sipas tre medhhebeve të tjerë nuk janë auret, nuk bëhen kafirë, por sipas medhhebit të tyre kanë bërë gjynah shumë të madh. Kështu është zbulimi i kofshëve tek meshkujt. Ai që nuk e di e ka farz që ta mësojë, sapo ta mësojë duhet të bëjë teubë dhe të mbulohet.

Koka e Hysenit është varrosur në **Hane**. Vendi se ku është varrosur trupi nuk dihet. Varret në **Kazimijje** janë varret e dy Halifeve. Nuk janë varret e Kazimit dhe Xhevatit nga Ehli bejti. Varri në Tusa nuk është varri i Rizait nga Ehli bejti por varri i Harunit. Varret në Samarra janë varret e Abasëve. Nuk janë varret e Hadiut, Askeriut dhe Mehdiut nga Ehli bejti”. Gjithashtu do të thoni: “Ashtu siç është farz të shemben të gjitha tyrbet dhe kubetë në të gjitha shtetet muslimane, ashtu është farz edhe prishja e varrezës “Baki”!”

15-Do ti fusni muslimanët në dyshimë mbi çështjen që Sejdidët janë pasardhesit e Pejgamberit. Do të vishni njerëz që nuk janë Sejdidë, me çallma jeshile dhe të zeza, në mënyrë që Sejdidët të ngatërrohen me njerëzit e tjerë [Në perandorinë Osmane vetëm Sejdidët kanë pasur të drejtë që të vishnin çallmë jeshile ose të zezë, në mënyrë që të dalloheshin nga të tjerët e të respektoheshin]. Në këtë mënyrë do të bëni të mundur që njerëzit të hutohen dhe të fillojnë të mendojnë keq për Sejdidët. Do t’u hiqni çallmat Sejdidëve dhe dijetarëve, në mënyrë që rraca e Sejdidëve të zhduket dhe dijetarët të mos respektohen.

16-Shiitëve duhet tu thoni se është farz të shëmben vendet e shenjta të tyre, sepse janë bid’at dhe të gabuara, sepse nuk kanë ekzistuar në kohën e Pejgamberit dhe Halifeve. Do t’i pengoni njerëzit që të futen në këto vende të shenjta. Do të bëni ç’është e mundur për të pakësuar vaizët (predikuesit) dhe t’i detyroni predikuesit dhe pronarët e vendeve të shenjta që të paguajnë taksa.

17-Në libër veç të tjerash thuhet: Duke i futur njerëzve ndjenjën e dashurisë për liri do t’u thoni atyre: “Çdo njeri mund të bëjë atë që dëshiron. Nuk është farz që të mësohen urdhërat, ndalesat dhe ligjet e Islamit”. [E vërteta është se të mësosh Islamin dhe tua shpjegosh atë të tjerëve është farz. Është detyra kryesore e çdo Muslimani] gjithashtu do t’u injektoni atyre edhe këtë mendim: “Të krishterët kanë fenë e tyre dhe Çifutët kanë fenë e tyre. Asnjeri nuk futet dot në zemrën e të tjerëve. Urdhërat dhe ndalesat e Islamit janë për Halifen”.

18-Për të penguar shtimin e numrit të Muslimanëve do të mundoheni që të pakësojnë lindjet dhe do t’i pengoni të martohen më shumë se një herë. Do të vendosni disa kushte për martesën. P.sh do të thoni: “Nuk mund të martohen: një Arab me një Iraniane, një Iranian me një Arabe ose një Turk me një Arabe”.

19-Do të ndaloni menjëherë përhapjen e Islamit dhe aktivitetin

e mësimit të Islamit jo muslimanëve. Do të përhapni mendimin se Islami është fe vetëm e Arabëve, si arsye për këtë do të thoni se në Kur'an thuhet: **“Këto janë fjalë për ty dhe për popullin tënd”**

20-Do të zvogëloni aktivitetet e organizatave bamirëse dhe do t'i fusni këto organizata nën administrimin e shtetit. Do t'i vështirësoni aq shumë punët sa që njerëzit të mos kenë mundësi të ndërtojnë xhami, medrese dhe vepra të tjera bamirësie si këto.

21-Do t'i fusni Muslimanët në dyshme mbi Kur'anin. Do të përgatisni Kur'anë të fallsifikuar, me shtesa dhe mangësi në to dhe do të thoni: “Kur'ani është prishur. Kur'anët nuk janë të njejtë me njëri-tjetrin. Ajeti që gjendet në një Kur'an nuk gjendet në një tjetër”. Do të nxirrni nga Kur'ani të gjithë ato ajete që poshtërojnë Çifutët, të krishterët dhe të gjithë jo muslimanët, ajetet e xhihadit dhe ajetet që tregojnë urdhërat dhe ndalesat e Islamit.^[1] Do ta përktheni Kur'anin në gjuhë të ndryshme si: Turqisht, Persisht, Indisht etj dhe do të pengoni që Kur'ani të lexohet në Arabisht në shtetet jo Arabe. Gjithashtu do të pengoni këndimin e ezanit, faljen e namazit dhe bërjen e duave në gjuhën Arabe, në vendet jo Arabe.

Në të njejtën mënyrë do t'i fusni njerëzit në dyshime në lidhje me Hadithet. Përkthimi, kritikati dhe fallsifikimi që do t'i bëhet Kur'anit, duhet që patjetër t'i bëhet dhe Haditheve.

Libri **“Si mund ta shëmbni Islamin”** që lexova, me të vërtetë që ishte shumë i përsosur. Për mua ishte një udhëzues i pashembullt për detyrat që do të kryeja në të ardhmen. Kur shkova tek

[1] Anglezët nuk kanë arritur që të kenë sukses në këtë plan, sepse Allahu tealë e mbron Kur'anin që të mos ndryshohet. Allahu nuk pati dhënë fjalën se do ta mbronte Ungjillin. Për këtë arsye janë shkruajtur Ungjillë të rremë. Bile edhe këto Ungjillë të rremë u ndryshuan me kalimin e kohës. Ndryshimin e parë në Ungjill e ka bërë një Çifut me emrin Pavlos. Në çdo shekull janë bërë ndryshime të tjera. Ndryshimet më të rëndësishme i kanë bërë 319 priftërinjtë që perandori Bizantin Kostandini mblodhi në Iznik në vitin 325. Në vitin 1524 Prifti Gjerman Martin Luther krijoi **Protestanizmin**. Të krishterët që ndjekin Papën e Romës quhen **Katolikë**. Vrasjet mes Katolikëve dhe Protestantëve, masakrat e San Bartolomeut, Skocisë dhe terrori në gjykatat e engizicionit shkruhen edhe në historitë e krishtërimit. Në vitin 1054 Prifti i Stambollit Mihael Kiolarius u nda nga Papa dhe formoi kishën **Ortodokse**. Jakubi i cili ka vdekur më 571 ka krijuar **Suranizmin**, Maroni që ka vdekur më 405 ka krijuar **Maronizmin**, në Siri dhe Karl Russel në vitin 1872 ka krijuar **Dëshmitarët e Jehovahit**.

sekretari për t'i dorëzuar librin dhe për t'i shprehur mirënjohjen time, ai më tha: “Dije se në këtë detyrë nuk je i vetëm. Kemi edhe shumë njerëz të tjerë që kryejnë detyrë të njejtë me tënden. Deri tani ministria jonë ka ngarkuar me këtë detyrë më tepër se 5000 njerëz. Ministria po mendon që ta rrisë këtë numër deri në 100 mijë. Kur ta arrijmë këtë numër atëherë do t'i kemi futur të gjithë muslimanët dhe shtetet muslimane nën pushtetin tonë”.

Më pas sekretari tha këto: “Po të jap lajmin e mirë se Ministria jonë për t'ia arritur qëllimit ka nevojë vetëm për një shekull kohë. Megjithëse ne nuk do të arrijmë dot t'i shohim ato ditë, fëmijët tanë do t'i shohin, sa i mirë është mendimi (Hëngra ato që mbollën të tjerët, tani po mbjell unë që të hanë të tjetët). Kur Anglezët ta arrijnë këtë do ta kënaqin të gjithë botën e krishterë dhe do ti shpëtojnë ato nga fatkeqësia 12'të shekullore.”

Më pas vazhdoi: “Luftërat e ndryshme, si ato të kryqëzatave, të cilat kanë vazhduar prej shekujsh, nuk na kanë sjellë asnjë përfitim. As Mongolët me ushtrinë e tyre të fuqishme të Xhengizit nuk mund të thuhet se kanë arritur të bëjnë diçka për të shfarosur Islamin, sepse puna që kanë bërë ato ishte e menjëhershme dhe e pa planifikuar. Ato bënin luftëra vetëm për të treguar armiqtësinë e tyre dhe u lodhën shumë shpejt nga kjo gjë, por pushtetarët e nderuar të qeverisë sonë, për ta shembur Islamin nga brënda kanë përgatitur një plan tepër të hollësishëm të shoqëruar me një durim të madh. Edhe forcën ushtarake duhet që ta përdorim, por kjo vjen vetëm si lëvizja e fundit mbasi ta kemi sflitur e dërrmuar Islamin deri në atë pikë sa nuk është e mundur që ta mbledhë veten e të luftojë kundra nesh”.

Sekretari i përfundoi kështu fjalët e tij. “Paraardhësit tanë në Stamboll paskan qenë shumë të mençur, sepse kanë zbatuar një plan të njejtë me tonin. Çfarë kanë bërë: Janë përzier mes Muslimanëve dhe kanë hapur medrese për fëmijët e tyre. Kanë ndërtuar kisha. Kanë arritur me sukses të fusin mes tyre, pijet, bixhozin, gjynahet dhe përçarjet [e kanë ndarë popullin në tifoze të skuadrave të ndryshme të futbollit]. Kanë punuar gjatë gjithë kohës për ta zhytur rininë Islame në dyshime mbi fenë e tyre, kanë futur ngatërresa dhe përçarje mes tyre dhe qeverisë, janë munduar të prishin edukatën e moralin e njerëzve duke i mbushur shtëpitë e komandantëve, drejtorëve dhe punonjësve të shtetit, me gra të krishtere. Edhe ne duke vepruar në të njejtën mënyrë si ato do të dobësojmë fuqitë e tyre, do të lëkundim lidhjet e tyre me fenë dhe do të shthurim moralin e tyre. Do të zhdukim lidhjet e fuqishme që kanë me njëri-tjetrin. Pasi ta kemi bërë këtë gjë do të fillojmë një

- [1] Anglezët planin e tyre për të zhdukur Islamin, të përbërë nga 21 pika, e kanë zbatuar në dy shtetet e mëdha Islame, në Indi dhe Perandorinë Osmane. Në Indi kanë krijuar medhhebe të gabuara Islame si: **Vehabi, Kadjani, Tebligi xhemaat** dhe **Xhemaati Islamiye**. Me pas ushtria Angleze e pushtoi me lehtësi Indinë dhe kështu zhdukoi një shtet Islam. Dijetarët e Islamit i mbyllën nëpër burgje dhe i braktisën aty deri në vdekje. Edhe Sulltanin e burgosën dhe djemtë e tij i therën e i copëtuan. Thesaret e tyre të çmuara që i ruanin prej shekujsh i plaçkitën, i ngarkuan nëpër anije dhe i çuan në Londër. Vodhën edhe gurët e çmuar të **Taç Mahalit** të ndërtuar nga gruaja e Sulltanit, në vitin 1631, dhe vendin e këtyre gurëve e mbushën me baltë. Kjo baltë i tregon mbarë botës dhunën Angleze. Këto pasuri që kanë vjedhur i kanë përdorur përsëri për të luftuar Islamin. Ashtu si thotë një poet: “N.q.s tiranët kanë tiraninë, të shtypurit kanë Allahun”. Drejtësia e Allahut ra mbi to dhe gjetën dënimin. Dhjetëra mijëra Anglezë, armiq të fesë, si pasanikë, njerëz të kishave, njerëz të pushtetit e ministër, sëbashku me fëmijët e tyre, nga frika e pushtimit Gjerman hipën nëpër Anije për të shkuar në Amerikë, por gjatë arratisjes u fundosën sëbashku me anijet si shkak i minave me magnet të lëshuara në det nga anija luftarake Gjermane, “Graf von spee”. Pas luftës me vendimin e marrë nga Organizata botërore e të drejtave të njeriut në New York, u detyruan që ti lëshonin të gjitha kolonitë. Kështu i humbën shumicën e burimeve të fitimit që siguronin nga shtypja e kolonive. Mbetën të shkretët në ishullin Britanik. Ushqimet dhe sendet shumë të rëndësishme jepeshin vetëm me dokument. Kam dëgjuar vetë nga kryekomandanti i ushtrisë Salih Omurtak pasha të thotë: “Në Londër megjithëse isha mik zyrtar jam ngritur gjithmonë i pangopur nga tryeza. Në Itali arrita të ngopesha duke ngrënë shumë makaronë”. Kur i tha këto fjalë isha ulur në tavolinë, pikërisht përballë pashait. Këto fjalë më tingëll, së akoma në veshë.
- Sahnullahi Dehlevi “rrahmetullahi alejh” kur ka komentuar ajetin e 80’të të sures **Maide** ka thënë: “Muhjissune Husejn Begavi, ka thënë se jo të gjithë të krishterët janë mushrikë, sepse shirk do të thotë të quash zot diçka tjetër përveç Allahut, e ta respektosh atë, pra ti bësh ibadet. Mushrikët ashtu si Çifutët janë armiq të betuar të Muslimanëve. Këto i vrasin Muslimanët, shkatërrojnë shtetet dhe faltoret e tyre dhe djegin Kur’anët” Imam Rrabbani “rrahmetullahi alejh” në letrën e tretë të vëllimit të tretë të librit të tij Mektubat ka thënë: “Të gjithë ata që i bëjnë idabet diçkaje tjetër përveç Allahut quhen mushrikë. Ata që nuk ndjekin fenë e një pejgamberi janë mushrikë”. Tani të gjithë të krishterët për shkak se nuk i besojnë Muhammedit “alejhis-selam” janë kafirë, shumica e tyre janë mushrikë sepse thonë që Isai “alejhis-selam” është zot, ose është njëri nga tre zotat. Ata që thonë se Isai “alejhis-selam” është rob dhe pejgamber i Allahut quhen **Ehli Kitab**. Të gjithë këto janë armiq të Islamit dhe Muslimanëve. Luftën e tyre e drejtojnë Anglezët.
- Kemi marrë vesh se të krishterët në vitin 1992 kanë formuluar 11 pyetje dhe i kanë çuar këto në vendet Islame. Dijetarët Islamë të Bangladeshit u janë përgjigjur këtyre pyetjeve dhe i kanë turpëruar priftërinjtë, shtëpia jonë botuese **Hakikat Ktabevi** i ka botuar këto përgjigje në librin “**El-Ekazib-ul-xhedide-tul-Hristijaniye**” dhe ia bën të ditura të gjithë botës.

Pjesa e Parë

NDARJA E SHTATE

Pasi shijova shijen e sekretit të parë, mezi po prisja që të mësoja sekretin e dytë. Më në fund sekretari më zbuloi edhe sekretin e dytë që më pati dhënë fjalën, sekreti i dytë ishte një plan i përbërë nga 50'të faqe dhe ishte përgatitur posaçërisht vetëm për Anglezët me poste të larta që punonin për ministrinë. Ky plan ishte përgatitur nga ministria me qëllimin për ta shfarosur Islamin dhe për ta fshirë atë nga kujtesa, brënda një shekulli. Ky plan ishte përmbledhur në 14 pika. Ky plan mbahej shumë i fshehtë nga frika se mos binte në duart e Muslimanëve. Pikat e planit ishin si më poshtë:

1-Duhet të bëjmë marrveshje bashkëpunimi me Carin e Rusisë, për pushtimin e Buharës, Taxhikistanit, Armenisë, Horasanit dhe vendeve përreth. Gjithashtu me Rusët duhet të bëjmë marrëveshje bashkëpunimi për pushtimin e tokave Turke në kufi të Rusisë.

2-Duhet të bashkëpunojmë ngushtë me Francën dhe Rusinë për ta luftuar Islamin nga brënda dhe nga jashtë.

3-Duhet të fusim mosmarrveshje dhe përçarje midis qeverisë Turke dhe Iraniane dhe duhet që të fuqizojmë ndjenjat e atdhetarisë dhe racizmit tek këto popuj. Duhet të mbajmë gjallë dhe të forcojmë të gjithë sektet e Islamit, ato që ekzistojnë dhe ato që janë harruar dhe t'i hedhim këto kundër njëri-tjetrit.

4-Disa qytete nga shtetet Muslimane duhet t'i lejmë në duart e jo muslimanëve. Medinen duhet t'ia japim Çifutëve, Kajron të krishterëve, Kermanshahun Nusajrive që adhurojnë Aliun, Musullin Jezidëve, gjirin e Iranit Hinduve, Karsin Armenëve dhe alevive dhe Maskatin të huajve. Më pas duhet t'i furnizojmë këto vende me para, armë dhe njohuri të nevojshme, në mënyrë që secili nga këto vende të bëhet nga një gjemb në trupin e Islamit. Duhet të vazhdojmë zgjerimin e kufinjve të këtyre vendeve derisa Islami të jetë shfarosur krejtësisht.

5-Duhet të bëjmë planet që t'i kthejmë shtetet Muslimane, të Iranit dhe perandorinë Osmane, në shtete të vogëla që nuk bashkëpunojnë më njëri-tjetrin në asnjë çështje. Indinë ta lejmë në gjendjen që është tani. Ka një shprehje “Copëto dhe mund të sundosh” dhe “Copëto dhe mund të zhdukësh”.

6-Duhet të bëjmë një plan për të ringjallur të gjithë sektet e humbura të Islamit dhe t'i bëjmë këto e sektet e tjera që do të krijojmë, të përshtatshëm me zakonet dhe dëshirat e popujve ku do t'i përhapim. Në shtetet ku ekziston sekt i Shiitëve do të krijojmë 4 sekte të reja: 1- Feja që hyjnizon hazreti Hysenin. 2- Feja që Hyjnizon Xhaferri Sidikun. 3- Feja që hyjnizon Mehdiun. 4- Feja që hyjnizon Ali Rizain. E para është e përshtatshme për Kerebelanë, e dyta për Isfahanin, e treta për Samarrën dhe e katërta për Horasanin. Në të njëjtën kohë edhe katër medhhebet e Synive duhet t'i kthejme në katër fe të ndryshme të pavarura. Pasi ta kemi bërë këtë, do të krijojmë një sekt tjetër të Islamit në Nexhd dhe do të krijojmë përlëshje të gjakshme mes sekteve. Do të zhdukim librat e katër medhhebeve, në mënyrë që pjesëtarët e çdo sektit të quajnë muslimanë vetëm pjesëtarët e sektit të tyre dhe muslimanët e tjerë t'i shohin si kafirë që duhen vrarë.

7-Do të mbjellim tek muslimanët fidanët e përçarjes dhe mosmarrëveshjeve, me anë të përhapjes së zinasë, homoseksualizmit, alkoolit dhe bixhozit. Për këtë qëllim do të përdorim jomuslimanët që jetojnë në shtetet Islame. Me to duhet të formojmë një ushtri të përkryer që do të na ndihnojë të realizojmë planet tona.

8-Duhet t'i japim rëndësi të veçantë përgatitjes së liderëve të këqinj dhe komandantëve mizor, t'i vendosim këto në krye të qeverive dhe t'i shtrëngojmë që të nxjerrin ligje që nuk përputhen me Islamin. Duhet ti përdorim këto dhe duhet që t'i përgatisim në një mënyrë të tillë që të bëjnë gjithçka që i thotë ministria jonë të bëjnë, e të mos bëjnë ato gjëra që ministria jonë i thotë të mos bëjnë. Me anë të tyre mund t'i detyrojmë muslimanët me anë të ligjeve që të bëjnë ato që duam ne. Duhet ti sjellim këto vende në një gjendje të tillë që t'i bindesh Islamit të quhet faj dhe të bësh ibadet të quhet prapambetje. Me sa kemi mundësi drejtuesit e shteteve Muslimane duhet t'i zgjedhim nga ato njerëz me origjinë jo muslimane. Për t'ia arritur këtij qëllimi duhet që të maskojmë agjentët tanë si muslimanë dhe njerëz të fesë e t'i ngrejmë këto në postet e larta të shtetit, në mënyrë që të veprojnë sipas planeve tona.^[1]

[1] Anglezët arritën që të kenë sukses në planet e tyre. Arritën të sjellin në krye Mustafa Reshid pashën, Ali pashën, Fuad pashën dhe Talat pashën, të cilët kanë qenë me prejardhje masone, Çifute dhe Armene. Gjithashtu kanë futur si dijetarë të fesë masone si Abdullah Xhevdet, Musa Kazim, Zija Gökalp dhe Abduh.

9-Do të pengojmë me sa kemi mundësi mësimin e gjuhës Arabe. Në vend të gjuhës Arabe do të përhapim gjuhët, Persiane, Kurde, Postu etj...Në shtetet Arabe do të përhapim gjuhët e huaja dhe do të fillojmë të botojmë dialektet e ndryshme, në mënyrë që Arabishtja e pastër, gjuha e Kur'anit dhe e synetit të harrohet!

10-Duhet të vendosim njerëzit tanë afër qeveritarëve, t'i bëjmë ato këshilltarë të tyre, në mënyrë që t'i nxisim të punojnë sipas planeve tona. Rruga më e lehtë për këtë gjë është tregëtia e sklleverve. Agjentët dhe agentet që do të dërgojmë si skllever, më parë do t'i përgatisim shumë mirë. Pastaj do t'ua shesim këto qeveritarëve ose njerëzve të tyre të afërt, si fëmijëve, grave dhe personave për të cilët kanë ndikim tek to. Këto skllever që do të shesim do t'u afrohen qeveritarëve në mënyrë graduale. Në këtë mënyrë do t'i rrethojmë qeveritarët shtu siç rrethon byzylyku dorën.

11-Duhet të zgjerojmë numrin dhe veprimtarinë e misionerëve dhe ti fusim ato në profesione të tilla si, doktorë, inxhinierë, ekonomistë etj. Nën emrat: kisha, shkolla, spitale, biblioteka dhe qëndra bamirëse, duhet të hapim qëndra propaganduese. Duhet të hapim shtëpi botuese e t'i përhapim këto në të katëra anët e shteteve Islame. Duhet të shpërndajmë falas me mijëra libra që flasin për krishtërimin. Krahastorisë Islame duhet të botojmë edhe historinë e krishterë edhe ligjet e shtetit. Nëpër kisha dhe manastire duhet të vendosim agjentët tanë, të maskuar si priftërinj dhe murgesha. Do t'i përdorim këto si vegla dhe do t'i porositim që të jenë udhërrëfyesit e lëvizjes së krishtere. Duhet të bëjnë të mundur që të mësojnë të gjitha mendimet dhe lëvizjet e Muslimanëve dhe të na i përcjellin neve. Do ta prishim dhe do ta ndryshojmë historinë Islame. Pasi t'i kemi mësuar mirë fenë dhe hallet e Muslimanëve do t'i zhdukim të gjithë librat e tyre. Duhet të formojmë një ushtri të tërë krishterësh, të cilët të maskuar si profesorë, shkencëtarë e studiues, do të zhdukin të gjitha dituritë e Islamit.

12-Duhet t'u prishim mendjen të gjithë rinisë Muslimane, djem dhe vajza dhe t'i zhysim ato në dyshime rreth Islamit. Duhet ta shthurim moralin e tyre, me anë të librave, botimeve të ndryshme [klubet sportive, filmat e kinemasë, televizioni] dhe personave të specializuar në këtë fushë. Duhet të hapim organizata të fshehta ku të përgatisim rininë e krishtere e Çifute dhe të gjithë jo muslimanët, në mënyrë që të mashtrojnë të rinjtë Muslimanë!

13-Duhet të nxisim luftërat e ftohta dhe kryengritjet dhe duhet të bëjmë të mundur që muslimanët të jenë në luftë të vazhdueshme me jo muslimanët, mënyrë që t'u dobësohet forca e të mos mundin të përparojnë dot. Duhet t'i asgjesojmë forcën e mendimeve dhe burimet financiare. Duhet t'i zhdukim njerëzit e rinj dhe dinamikë. Vendin e paqes dhe të qetësisë duhet ta zëjnë revolucionet.

14-Duhet të shkatërrojmë ekonominë, të prishim burimet e fitimit dhe tokat bujqësore, të prishen ujëmbledhësit e të thahen lumenjtë, gjithashtu duhet t'i bëjmë njerëzit që të urrejnë faljen e namazit e të përhapim dembelizmin. Për dembelët do të hapim vende argëtimi. Do të përhapim në masë drogën dhe alkoolin.

[Pikat që përmendëm më sipër ishin shpjeguar në një mënyrë shumë të qartë me harta dhe skica. Me anë të këtij plani të përbërë nga 14 pika arritën që të shkatërrojnë përandorinë e madhe dhe të fuqishme Osmane, shtetet e reja që formuan i lanë në duar të masonëve Skocezë. Këto vazhdojnë ta luftojnë Islam, duke e kthyer këtë plan me 14 pika në kushtetuta të këtyre shteteve.]

E falenderova sekretarin që më dha një kopje të këtyre dokumentave të mrekullueshëm.

Pasi qëndrova edhe një muaj tjetër në Londër, mora urdhën nga ministria që të nisesha përsëri për në Irak për tu takuar me Nexhdi Muhammedin. Kur u nisa për udhë, sekretari më tha: (Se mos bën gabim dhe e lë pas dore Nexhdi Muhammedin! Sipas atyre që kuptohen nga raportet që na kanë dërguar agjentët në lidhje me të, Nexhdi Muhammedi është një budalla shumë i përshtatshëm për të realizuar planet tona.

Fol hapur me Nexhdi Muhammedin! Agjentët tanë në Isfahan kanë folur qartë me të dhe ai i ka pranuar kërkesat tona me një kusht. Kushti i tij është ky: “Kërkon që t'i dërgojmë mall dhe armë në sasi të mjaftueshme që kur të shpallë haptazi mendimet dhe pikëpamjet e tij të mbrohet nga sulmi i sigurtë i njerëzve që mbështesin dijetarët. Gjithashtu kërkon që të formojë edhe një pashallëk të tijin, qoftë edhe të vogël.” Ministria jonë ia ka plotësuar këto kushte.)

Me gëzimin që më dha ky lajm gati sa nuk po fluturoja. Kur dëgjova këto fjalë pyeta sekretarin se si duhet të veproja me të. Përgjigja e sekretarit ishte: (Ministria ka përgatitur një plan të cilin Nexhdi Muhammedi duhet ta ndjekë. Plani është ky:

1-Do të thotë se të gjithë Muslimanët janë kafirë dhe se vrasja,

plaçkitja, dhunimi i nderit të tyre dhe shitja e tyre si skllavër është hallall.

2-Po qe e mundur do të thotë që Qabeja duhet shembur sepse është Idhull (Putra).^[1] Do t'i nxisë fiset që të sulmojnë dhe plaçkisin karvanet e atyre që shkojnë në Haxh, në mënyrë që ta bëjë të pamundur ibadetin e Haxhit.

3-Do të mundohet t'i detyrojë Muslimanët që të mos i binden Halifes. Do ta nxisë popullin në kryengritje kundër Halifes dhe do të krijojë ushtri posaçërisht për këtë qëllim. Në çdo rast do të thotë se duhet të luftojnë kundër parisë dhe pasanikëve të Hixhazit dhe të pakësojnë numrin e tyre.

4-Do të deklarojë se të gjitha tyrbet, kubet dhe vendet e shenjta që ndodhen në Mekke, Medine dhe në të gjitha vendet Islame janë idhuj dhe shirk dhe për këtë arsye duhet që të shemben. Me të gjitha mundësitë do të mundohet që të flasë sa më shumë gjëra të këqija rreth Pejgamberit Muhammed, Halifeve dhe njerëzve të mëdhenj të medhhebeve.

5-Do të përhapë sa të munda, kryengritjet, dhunën dhe anarkinë në vendet Muslimane.

6-Do të mundohet të botojë një Kur'an me shtesa dhe mangësira, ashtu siç ka bërë me Hadithet.^[2]

Sekretari pasi më tregoi planin e përbërë nga 6 pika më tha: “Mos të të trembë ky plan i madh, sepse detyra jonë është që të mbjellim farën për shfarosjen e Islamit. Do të vijë breza të tjerë që do ta përfundojnë këtë gjë. Qeveria angleze e ka bërë zakon që të bëjë durim dhe të përparojë hap pas hapi. A nuk ishte një njeri i vetëm edhe Pejgamberi Muhammed që krijoi Islamin e madh dhe marramendës? Edhe Nexhdi Muhammedi na ka dhënë fjalën se do të bëjë një revolucion ashtu si Pejgamberi.”

Pas disa ditëve mora leje nga Ministri dhe sekretari e u ndava

[1] Idhuj (Putra) quhen ato gjëra ose statuja të cilave u bëhet sexhde, ibadet dhe pritët çdo gjë vetëm prej tyre. Muslimanët nuk bëjnë sexhde për Qaben. Drejtohen nga Qabeja dhe i bëjnë sexhde Allahut. Në çdo namaz pasi kthehen nga Qabeja këndojnë suren **Fatiha**. Në këtë sure thuhet: “**Vetëm Ty të adhurojmë, dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë.**”

[2] Të thuash se ka shtesa ose mangësi në Hadithet sherif të përmendura në librat e njohur dhe të besueshëm të haditheve, është një shpifje shumë e madhe. Një njeri i cili mëson se si i kanë mbledhur Hadithet sherif, me mijëra dijetarë nuk thonë kurrë shpifje të tilla dhe nuk i besojnë kurrë këtyre.

me njerëzit e familjes. U nisa për rrugë në drejtim të Basrës. Kur po dilja nga shtëpia djali im i vogël më tha. “Baba kthehu shpejt!” Mu mbushën sytë me lot. Nuk arrita ta fsheh pikëllimin tim nga gruaja. Pas një rruge të lodhshme më në fund arrita në Basra në mbrëmje, shkova në shtëpinë e Abdurrizait dhe e zgjova nga gjumi. Kur më pa u gëzua shumë. Më mbajti në shtëpinë e tij atë natë. Në mëngjes më tha: “Erdhi tek unë Nexhdi Muhammedi, më la një letër për ty dhe u largua”. E hapa letrën. Aty shkruante se kishte shkuar në Nexhd, në vendlindjen e tij dhe më kishte lënë adresën e shtëpisë. U nisa menjëherë për atje. Pas një udhëtimi me shumë peripeci arrita aty. E gjeta Nexhdi Muhammedin në shtëpi. E pashë që ishte dobësuar shumë, por nuk i thashë asgjë atij. Më pas mora vesh se ishte martuar.

Ramë dakort që mua të më prezantonte si skllavin e tij që më kishte dërguar diku dhe tani isha kthyer. Kështu veproji, i tha të gjithëve se isha skllavi i tij.

Qëndrova dy vjet pranë Nexhdi Muhammedit. Përgatitëm një plan për shpalljen e pikëpamjeve të tij. Më në fund në vitin 1730 (Hixhri 1143) e forcova vendosmërinë e tij. Ai pasi mbloodhi ndihmës rreth vetes i shpjegoi njerëzve të tij të afërt me disa fjali të shkurtra pikëpamjet e tij. Më pas filloi ta zgjerojë dita ditës thirrjen e tij. Vendosa roje kudo rreth tij për ta mbrojtur atë nga armiqtë. U dhashë atyre mall dhe para aq sa deshën. Kur afroheshin për të sulmuar armiqtë e Nexhdi Muhammedit i shtoja forcat e rojeve dhe u jepja atyre mbështetje shpirtërore, sa më shumë që përhapej thirrja e tij aq më shumë i shtoheshin kundërshtarët. Kur e sulmonin shumë donte të hiqte dorë nga thirrja e tij, por nuk e lija asnjëherë vetëm dhe ia forcoja vendosmërinë. I thoja atij: “Pejgamberi ka patur më shumë mundime se sa ty, siç e di kjo është një rrugë lavdie, si çdo revolucionar duhet që t’i përballosh disa vështirësi!”

Në çdo kohë mund të sulmoheshim nga armiqtë tanë. Vendosa kundër kundërshtarëve tanë spiunë të cilët i bleva me para, sa herë që kundërshtarët donin t’i bënin ndonjë dëm atij, menjëherë spiunët më lajmëronin dhe unë bëja të mundur që atë të mos e prekte asnjë dëm. Një herë mora lajmin se armiqtë donin ta vrisnin atë. Menjëherë mora masat për t’i penguar ato që t’ia arrinin qëllimit. Kur njerëzit morën vesh se këto donin të vrisnin Muhammedin, filluan t’i urrejnë ato. Kështu ranë në gropën që hapën vetë.

Nexhdi Muhammedi më dha fjalën se do t’i realizonte të gjitha pikat që përcaktonte plani, por njëkohësisht më tha: “Tani

mund të bëj vetëm një pjesë të planit”. Kishte shumë të drejtë në këto fjalë. Nuk ishte aspak e mundur që t’i bënte të gjitha në atë kohë.

Shëmbjen e Qabes e shihte si diçka shumë të vështirë. Hoqi dorë edhe nga shpallja se Qabeja është idhull. Gjithashtu refuzoi edhe përgatitjen e një Kur’ani të ndryshuar. Për këtë i trembej shumë Sherifëve të Mekkes dhe qeverisë së Stambollit. Më tha: “N.q.s i bëjmë këto të dyja do të sulmohemi nga një ushtri shumë e fuqishme”. E pranova shkakun e tij për këtë refuzim. Kishte të drejtë në ato që thoshte. Kushtet nuk ishin të përshtatshme për një gjë të tillë.

Pas disa vitesh Ministria jonë arriti që të bashkonte me ne edhe komandantin e Derrijes, Muhammed bin Suud’in. Mua këtë ma treguan me anë të një korrieri në mënyrë që të bëja të mundur lidhjen, miqësimin dhe bashkëpunimin midis dy Muhammedëve. Për të fituar zemrat e muslimanëve më anë të fesë përdorëm Nexhdi Muhammedin dhe për ta garantuar këtë me anë politike përdorëm Muhammed bin Suudi’n. Historia e ka vërtetuar se shtetet që janë mbështetur tek feja kanë jetuar gjatë, më të populluar dhe më të lulëzuar se shtetet e tjerë.

Në këtë mënyrë vazhduam të fuqizohemi vazhdimisht. Qytetin e **Derrijes** e bëmë qendrën tonë. Krijuam fenë e re me emrin **VEHABI**. Ministria e mbështeste në mënyrë të fshehtë shtetin Vehabi dhe dërgonte ndihma, shteti i ri bleu si skllevër 11 oficerë Anglezë të cilët i kishin mësuar në mënyrë të përsosur Arabishten dhe teknikat e luftës në shkretëtirë. Planet i përgatisnim bashkë me këto oficerë. Të dy Muhammedët vazhdonin të ecnin në rrugën që i diktonim ne. Kur nuk mernim urdhëra të veçanta nga ministria i mernim vetë ne vendimet.

Të gjithë u martuam me vajza nga ashiretet. Më pëlqeu shumë bindja që tregojnë vajzat Muslimane ndaj burrave të tyre. Tani po na shkojnë mbarë punët.

Këshillë: Ata që e lexojnë me kujdes këtë libër, do ta kuptojnë se armiqët më të mëdhenj të Islamit janë Anglezët, do ta kuptojnë mirë se janë Anglezët ata që e kanë krijuar dhe e ushqejnë fenë Vehabi, e cila sulmon Muslimanët në të gjithë botën. Edhe anglezët që kanë dituri moral dhe dhembshuri e urrejnë këtë armiqësi të poshtër të Anglezëve.

Përditë dëgjojmë se njerëzit pa medhheeb që gjenden në çdo shtet, mundohen që të përhapin fenë Vehabi. Ka edhe nga ata që

thonë se Kujtimet e Hemherit (Titulli origjinal i librit) është një libër i fantazuar dhe është përgatitur nga të tjerë, por nuk arrijnë të nxjerrin asnjë argument për ato që thonë. Dijetari i madh i Islamit Habib Alevi bin Ahmed Haddad i ka lexuar librat e Vehabi've dhe ka kuptuar të vërtetën e maskuar, në librin e tij **(Misbah ul enam)** ai u është përgjigjur me argumente bindëse poshtërsirave të përgatitura nga Muhammed bin Abdulvehhabi dhe Hempheri. Libri i botuar në vitin 1801 (Hixhri 1216) është ribotuar në vitin 1995 nga shtëpia botuese Hakikat Kitabevi dhe shpërndahet në të gjithë botën Islame, sado që të përpiqen Anglezët nuk do të arrijnë dot kurrë të zhdukin Ehli synetin që është Islami i vërtetë, por do të zhduken vetë, sepse Allahu teala në ajetin e 81'të të sures Isra na ka dhënë lajmin e mirë se, do të dalin njerëz nga rrugë të gabuara, por këto do të munden nga ato që janë në rrugë të drejtë.

Pjesa e Dytë

ARMIQESIA E ANGLEZEVE NDAJ ISLAMIT

Ata që e kanë lexuar pjesën e parë të librit, ku tregohen kujtimet e agentit Anglez, marrin njohuri mbi çfarë mendojnë Anglezët për Muslimanët. Më poshtë do t'iu tregojmë shkurtimisht se si zbatohen urdhërat që ministria e Kolonive u ka dhënë agentëve dhe gjithashtu do të japim njohuri mbi aktivitetet misionare.

Anglezët janë mendjemëdhenj dhe u pëlqen vetja e tyre, sa me mburrje e shohin veten dhe popullin e vet aq me përbuzje i shohin të gjithë popujt e tjerë.

Sipas anglezëve, njerëzit ndahen në tre grupe: Në grupin e parë bëjnë pjesë Anglezët. Ata thonë dhe pretendojnë se janë krijesat më të përsosura që ka krijuar Allahu. Në grupin e dytë bëjnë pjesë njerëzit e bardhë, Evropianët dhe Amerikanët. E pranojnë se edhe këto mund ta meritojnë të respektohen. Në grupin e tretë bëjnë pjesë të gjithë ato njerëz që nuk bëjnë pjesë në dy grupet e para. Këto shihen si një krijesë midis njeriut dhe kafshës. Këto ashtu si nuk e meritojnë të respektohen, nuk meritojnë as të drejtat e lirisë, pavarësisë dhe të krijimit të shtetit. Këto janë krijuar veçanërisht për tu shfrytëzuar nga Anglezët.

Anglezët nuk jetojnë sëbashku me banorët e kolonive, të cilët i shohin me kaq përçmim. Në çdo koloni ka klube, kazino, lokale, hamame (banjo Turke), bile edhe dyqane, posaçërisht vetëm për Anglezët. Vendasit e kanë të ndaluar të futen në këto vende.

Shkrimtari i njohur Francez Marcelle Perneau, në librin e tij **“Shënimet e udhëtimit në Indi”**, që e ka shkruar pas udhëtimit të tij në Indi në fillimet e shekullit të 20'të thotë: (I pata dhënë fjalën të takoheshim në një lokal Anglez në Indi, një dijetari tepër të njohur Indian i cili kishte marrë edhe titullin profesor nga disa universitete të ndryshëm. Dijetari Indian kishte ardhur, por anglezët duke mos e përfillur fare as famën e tij nuk e kishin lejuar të futet brënda. Kur e mora vesh këtë gjë pas përkpjekjeve të shumta arrita të bisedoja me dijetarin Indian në lokal.)

Gjatë gjithë kohës Anglezët janë sjellë me njerëzit e popujve të tjerë me një sjellje që nuk e meritojnë as kafshët.

Një ditë në vitin 1919 në qytetin Amristar të Indisë që

njëkohësisht ka qenë edhe kolonia më e madhe Angleze, Hindutë, të cilët ishin mbledhur me rastin e një ceremonie fetare nuk i kishin treguar respekt një misjonereje Angleze e cila po kalonte në rrugë me biçikletë. Misjonerja ankohet për këtë gjë tek gjenerali Anglez Dyere. Gjenerali i dha menjëherë urdhër ushtarëve të tij që të qëllonin mbi popullin që ishte mbledhur në faltore me rastin e ceremonisë fetare, si pasojë e kësaj brënda 10'të' minutave u vranë 700 Indianë dhe më tepër se 1000 të tjerë u plagosën. Gjenerali duke mos u mjaftuar me kaq i detyroi të gjithë banorët të ecin këmbëdorazi njëllor si kafshët. Për këtë ngjarje bëhet ankesë në Londër. Qeveria urdhëron që të bëhen hetime.

Kur inspektori i cili shkoi në Indi për të bërë hetime e pyeti gjeneralin se cili ishte shkaku i hapjes së zjarrit ndaj popullit të pambrojtur, gjenerali u përgjigj: "Komandanti i këtij vendi jam unë. Unë e caktoj çdo veprim që bën ushtria. Kështu e pashë të arsyeshme dhe kështu veprovë". Pasi mori këtë përgjigje inspektori e pyeti: "Po shkaku që i detyrove njerëzit të zvarriten këmbëdorazi cili është?" Gjenerali u përgjigj: "Hindutë qëndrojnë kështu përpara disa Idhujve të tyre. Desha tu shpjegoj këtyre se një grua Angleze është po aq e shenjtë sa Idhujt e tyre. Nuk i detyrova ato të qëndrojnë ashtu për t'i poshtëruar ato, por për t'i treguar atyre se kështu duhet të sillen". Kur inspektori i tha se populli ishte i detyruar të dilte jashtë për të bërë Pazar, gjenerali ia ktheu: "Po të ishin njerëz këto nuk bridhnin nëpër rrugë këmbëdorazi, sepse shtëpitë e tyre janë të ngjitura më njëra tjetrën dhe çatitë e shtëpive i kanë të sheshta. Po të donin mund të ecnin si njerëz sipër çative". Kur u botuan në shtypin Anglez fjalët e gjeneralit, gjenerali u shpall hero. [Dyer, Reginald Edward Harry ka lindur në vitin 1864 dhe ka vdekur në vitin 1927 në Angli. Ka kaluar në historinë e botës si gjenerali i famshëm Anglez i cili në vitin 1919 mbyti qytetin e Amristarit me gjakun e njerëzve të pafajshëm. Pas protestave të mëdha që u bënë kundër tij u lirua nga detyra dhe doli në pension, por dhoma e Lordëve Anglezë i priti me lavdërime të mëdha veprimet e tij dhe vendosi që ta ndihmojë gjeneralin. Këtu duket qartë se me çfarë syri i shohin Lordët dhe Kontët Anglezë popujt e tjerë.]

Mënyra e qeverisjes së anglezëve në kolonitë ku jetojnë njerëz të bardhë dhe me origjinë Evropiane, ndryshon krejtësisht nga mënyra e qeverisjes në kolonitë ku nuk jetojnë njerëz të bardhë. Të parët janë të privilegjuar dhe kanë njëfarë autonomie. Ndërsa të dytët rënkojnë nga vuajtjet. Të parët të cilëve u jepet emri Dominjan në punët e brëndshme janë autonomë, ndërsa në punët

e jashtme varen nga Anglia, si shembull i këtyre kolonive mund të jepet Kanadaja, Australia, Zelanda e Re etj...

Qeverisja e kolonive është ndarë në dy ministri. Këto janë ministria e Kolonive dhe ministria e Indisë. Në krye të ministrisë së kolonive gjendet personi me titull **“Secretaary of state for the Colonial department”** (Sekretari i shtetit për departamentin e Kolonive, ose ministër). Ky ministër ka dy këshilltarë dhe katër ndihmës. Njëri nga këshilltarët zgjidhet nga shtesa e ulët e Anglezëve, këshilltari tjetër dhe ndihmësit janë të përhershëm. Këto nuk ndryshojnë as me ndryshimin e qeverisë. Njëri nga ndihmësit kujdeset për Kanadanë, Australinë dhe disa ishuj, një tjetër kujdeset për Afrikën qendrore, i treti kujdeset për Afrikën lindore dhe perëndimore, ndërsa i katërti kujdeset për Indinë.

Perandoria Angleze, armike e Islamit, vendi i dhunës, tiranisë, hileve dhe tradhëtisë i ka vënë vetes emrin “Shteti mbi të cilin nuk perëndon dielli”, shtetet: Kanada, Afrika e Jugut, Zelanda e Re, Fizhi, Ishujt Pacifikë, Papua, Tonga, Australia, Beluxhistani Anglez, Birmania, Aden, Somalia, Brunei, Boreno, Sarawak, India, Pakistani, Bangladeshi, Malajzia, Indonezia, Hong-Kongu, një pjesë e Kinës, Qipro, Malta [1882], Egjipti, Sudani, Nigeri, Nigeria, Kenja, Uganda, Zimbabve, Zambia, Malawi, Bahama, Greneda, Guinea, Botswana, Gambia, Gana, Sierra Leone, Tanzani dhe Singapori, janë shtetet që kanë jetuar nën hegemoninë Angleze. Këto shtete si shkak i Anglezëve, kanë humbur fetë, gjuhët, zakonet e tyre dhe gjithashtu të gjitha pasuritë mbi dhe nëntokësore, të cilat janë shfrytëzuar nga Anglezët.

Në shekullin e 19'të në sajë të pushtimeve Anglia arriti të kishte nën zotërimin e saj një të katërtën e tokave të të gjithë botës dhe më tepër se një të katërtën e popullsisë.

Kolonia më e rëndësishme e Anglisë ishte India. Ajo që i ka dhënë Anglisë sundimin e botës ka qenë pikërisht India me një popullsi prej 300 milion banorësh [në ditët tona kjo popullsi e ka kaluar kufirin e 700 milionëve] dhe padyshim pasuritë e pafundme të këtij shteti. Vetëm gjatë luftës së parë botërore Anglia nga India ka marrë 1.5 milion ushtarë dhe një miliard Rupit në kesh, shumicën e këtyre e kanë përdorur për të shkatërruar perandorinë Osmane. Në kohën e paqes ata që kanë krijuar arkitekturën e bukur Angleze dhe që kanë furnizuar vazhdimisht ekonominë e tyre, kanë qenë Indianët. Ka dy arsye që India ka patur një rëndësi shumë më të madhe se kolonitë e tjera Angleze. E para ishte se në Indi ishin zotëruar muslimanët dhe ishte përhapur Islami të cilin Anglia e shihte si pengesën kryesore për të sunduar botën. Ndërsa

aryeja e dytë ishin pasuritë e pafundme të Indisë. Për të mbajtur Indinë nën sundimin e tyre Anglezët kanë sulmuar dhe përçarë të gjithë ato shtete muslimane që kishin lidhje me Indinë, janë bërë sundues të këtyre shteteve, i kanë armiqësuar ato me vëllezërit e tyre dhe padyshim gjatë gjithë kohës kanë shfrytëzuar pasuritë e tyre. Anglezët të cilët kanë vëzhguar me kujdes politikën e Osmanllinjve dhe me lojëra të ndryshme politike i vunë ato në luftë me Rusët, e copëtuan këtë perandori dhe pushtuan shtetet e krijuara nga ky copëtim, në mënyrë që ta dobësonin këtë shtet deri në atë pikë sa të mos kishte mundësi t'i vinte dot në ndihmë Indisë.

Evropianët e parë të cilët kanë shkelur Indinë janë Portugezët. Këto zbritën në qytetin e Kalkutës në brigjet Malabi dhe filluan të merreshin me tregëti. Më pas futën në dorë të gjithë tregëtinë e Indisë. Më vonë Hollandezët e morën tregëtinë e Indisë nga duart e Portugezëve. Më pas Francezët e morën këtë tregëti nga duart e Hollandezëve, por përballë tyre gjetën Anglezët.

Sic thuhet në librin “Revolucioni Indian” i dijetarit Islam Muhammed Fadli Hak Hajrabadin, Anglezët për herë të parë në vitin 1600 morën leje nga Shahu Ekber, për të hapur dyqane në Kalkuta.

Shahu Ekber ishte një njeri me besim të prishur. I vlerësonte të gjitha fetë njëllë. Gjithashtu ka mbledhur dijetarë nga fe të ndryshme dhe është munduar të krijojë një fe të vetme të përbashkët për të gjithë. Këtë fe të cilën e emëroi **“Feja Hyjnore”** e shpalli zyrtarisht në vitin 1582. Që nga kjo periudhë, në të gjithë Indinë, por sidmos në pallatin e Sulltanit, prestigji i dijetarëve Islamë filloi të bjerë dhe filluan të ngrejnë krye pjesëtarët e fesë së re të nxjerrë nga Shah Ekberi. Ja në një periudhë të tillë u futën Anglezët në Indi. Në kohën e Shahut të parë Muhammed Behadir Shah bin Alemgir.^[1] për herë të parë blenë toka në Kalkuta, Për të ruajtur këto toka sollën ushtarë. Në vitin 1714 për arsye se kuruan Shahun Ferruh bin Shah, iu dha e drejta për të blerë toka në të gjithë Indinë. I hoqën Indianët muslimanë nga sundimi me anë të parave. Në vitin 1837 u bë shah Behadiri i dytë, ky duke mos e duruar dot shtypjen e Anglezëve dhe me mbështetjen e popullit, në vitin 1857 organizoi një kryengritje të madhe.

Megjithëse pas kësaj kryengritjeje fitoi të drejtën të shtypë para me emrin e tij dhe të këndoje hytbe, reagimi i Anglezëve për këtë ngjarje ishte shumë mizor. Kur u futën ushtarët Anglezë në Dehli plaçkitën shtëpitë dhe dyqanet e morën të gjitha pasuritë. I

[1] Shahu i parë Alemgir vdiq më 1712 (Hixhri 1124)

masakruan me shpata të gjithë muslimanët pa bërë dallim meshkuj, femra pleq apo fëmijë. As ujë për të pirë nuk gjendej dot.

[VEREJTJE: Që nga koha e Ademit ““alejhis-selam” e deri në ditët tona, njerëzit e këqinj gjithmonë i kanë sulmuar të mirët. Allahu teala e ka krijuar gjithçka për një qëllim. Dënimin e të këqinjve e jep me anë të njerëzve të këqinj. Ata që bëjnë krime dënohen edhe në këtë botë. Krahas të këqinjve vuajnë edhe të mirët. Muslimanët që vdesin në luftë dhe ato që vdesin nëpër aksidente janë të gjithë Shehidë. Muslimanët e mirë dhe të pafajshëm që vuajnë në këtë botë do të kenë të mira me bollëk në Ahiret, kështu shkruhet në librat e fesë. Libra të tillë gjenden me shumicë në mbarë botën. Ato që i lexojnë këto libra dhe nuk u besojnë atyre quhen Kafirë, ato që nuk kanë dëgjuar kurrë në jetë për Islamin nuk quhen kafirë. Ata që i besojnë Islamit dhe që thonë **“La ilahe il-lall-llah”** bëhen Muslimanë. Kjo ka kuptimin **“Ekziston një Allah i Cili ka krijuar gjithçka”**. Ata që bëhen Muslimanë ndjekin rrugën e Pejgamberit të Tij të fundit. Në shumë vende kafirët dhe tiranët, kanë masakruar muslimanët së bashku me gratë dhe fëmijët e tyre. Muslimanët që vriten bëhen shehidë. Nuk i ndejnë fare torturet që u bëhen kur i vrasin. Gjatë vdekjes janë të gëzuar se në ato momente shohin të mirat e xhenetit që meritojnë. Gëzohen dhe lumturohen shumë nga kjo gjë. Thuhet: **“Varret e muslimaëve janë nga kopështet e xhenetit”**]

Njëri nga komandantët e ushtrisë, Baht hani e bindi Shahun që të tërhiqej së bashku me ushtrinë, por një komandant tjetër Mizra Ilahi Bahsh me qëllimin për ti hyrë në sy Anglezëve e mashtroi Shahun Behadir, duke i thënë se po të dorëzohej ai mund ti bindte Anglezët se Shahu ishte i pafajshëm e kështu do ta falnin. Kështu Shahu Behadir u shkëput nga pjesa kryesore e ushtrisë së tërhequr dhe u fsheh në tyrben e Shahut Humajun, që ndodhej brenda Dehlit, 10 kilometra larg Kalai Mualasë.

Prifti Hudson që njihej për pafytyrësinë e tij, në atë kohë kryente rolin e spiunit në shërbim të ushtrisë Angleze. Ky mësoi strehimin e Shahut nga një tradhëtar me emrin Rexheb Ali dhe menjëherë ia përcolli këtë informacion komandantit të ushtrisë Angleze, gjeneralit Wilson. Kërkoi ndihmë për ta kapur atë. Kur Wilsoni i tha se nuk kishte ushtarë me pagesë që mund t'i jepte, Hudsoni i propozoi që ta bënte vetë këtë punë me disa ushtarë. Gjithashtu i tha se për të bërë të mundur që Shahu të dorëzohej, duhet t'i jepnin atij sigurinë për jetën e vet dhe të familjes. Wilsoni në fillim ishte i pavendosur, por më vonë e pranoi këtë propozim. Pas kësaj marrëveshje Hudsoni i cili shkoi në tyrben e Shah

Humajunit sëbashku me 90 veta të tjerë e siguruan Shahun se ai vetë dhe familja e tij nuk do të prekeshin. Behadir Shahu i cili u mashtrua nga fjalët e këtij prifti u dorëzua. Më pas Hudsoni u mundua të kapte edhe dy djemtë e Shahut, sëbashku me nipin e tij, por nuk arriti t'i kapte dot këto se ruheshin nga roje të shumtë. Për t'i kapur këto kërkoi garanci nga Wilsoni edhe për mos prekjen e djemve dhe të nipit të Shahut. Tradhëtari Hudson me mjete të ndryshme arriti t'i dërgonte lajm djemve dhe nipit të Shahut se po të dorëzoheshin, nuk do të prekeshin. Hudsoni sapo i kapi këto duke përdorur politikën dhe hilet Angleze, menjëherë i lidhi me zinxhirë.

Gjatë rrugës që po i sillnin dy djemtë e Shahut në Dehli, me duar të lidhura, Hudsoni i zhveshi dy princat e rinj dhe i bëri shehidë duke i qëlluar vetë me plumba në gjoks. Piu nga gjaku i tyre. I vari trupat pajetë të dy princave në derën e kështjellës, me qëllim për të frikësuar popullin. Një ditë më vonë ua preu kokat dhe ua dërgoi komandantit Anglez Henri Bernardit. Më pas gatuan supë me mishin e princave dhe ia dërguan Shahut dhe gruas së tij që ta hanin. Ngaqë ishin shumë të uritur e futën menjëherë në gojë, por megjithëse nuk e dinin se me çfarë mishi ishte gatuar nuk e përtypën dhe nuk e përcollën dot. Vollën dhe i lanë në tokë tasat me supë. Tradhëtari Hudson u tha: “Përse nuk e hëngrët? Eshtë supë shumë e mirë. E kam gatuar me mishin e djemve tuaj”, shahu Behadir i dytë që u zbrit me dhunë nga froni në vitin 1858 u gjykua si fajtor i kryengritjes dhe si shkakëtar i vrasjes së Evropianëve. Në datën 29 Mars u dënua me burgim të përjetshëm dhe u internua në Rangona. Në Nëntor të vitit 1862 në një shtet larg atdheut të tij, mbylli sytë në burg Shahu Behadir, Sulltani i fundit i perandorisë Islame Gurgani. Në vitin 1861 edhe Andaman Fadli Hak, u vra në një burg në ishujt Andaman.

Në vitin 1877 gjatë periudhës së luftës Osmano-Ruse, Anglia e shpalli Indinë një shtet nën sundimin Anglez. Njëri nga dëmet më të mëdha Islamit ia ka bërë Mit'hat pasha i cili ka qenë i regjistruar në organizatën e famshme Skoceze të masonëve, ky u bë shkaktar që perandoria Osmane u fut në luftë me Rusinë. Po ky ka ndihmuar Anglezët në vrasjen e Sulltan Abdulazizit.

Anglezët kishin vënë në postet më të çmuara të qeverisë Osmane, njerëzit e pregatitur prej tyre. Këto njerëz me emër ishin Osmanllinj, ndërsa me mendime dhe vepra ishin Anglezë. Njëri nga më të famshmit prej tyre Mustafa Reshid pasha, në datën 28.10.1857, kur kishte vetëm 6'të ditë që ishte zgjedhur sadrazam (kryeministër), përgëzoi Anglezët për masakrat që u bënë

Muslimanëve në Dehli. Edhe më parë Anglezët për të shtypur kryengritjet në Indi, të cilat kishin filluar për shkak të dhunës Angleze, kërkuar leje nga perandoria Osmane për të lejuar ushtarët e tyre të kalonin përmes Egjiptit. Këtë leje arritën ta mernin po me ndihmën e masonëve.

Anglezët në Indi nuk kanë lejuar hapjen e asnjë shkolle të re, por kanë mbyllur edhe të gjitha medresetë të cilat janë themeli i fesë Islame. Të gjithë dijetarët dhe njerëzit e fesë që mund të kryenin rolin e liderit në popull i vranë. Bile edhe nxënësit i kanë vrarë. Këtu e shohim të përshtatshme të tregojmë një kujtim që na e ka treguar një miku jonë i cili ka vizituar Indinë në vitin 1971. Pasi vizitova varrin e Imam Rrabbanit dhe të evlijave të tjerë “Kadesallahu sirr-rruh”, në qytetin Serhend të Indisë, shkova në qytetin Paniput dhe që aty në Dehli. Pasi fala namazin e Xhumasë në xhaminë më të madhe të Paniputit, imami i xhamisë më mori mysafir në shtëpinë e tij. Gjatë rrugës pashë një derë të madhe të kyçur dhe të lidhur me zinxhirë të trashë. Nga shkrimi sipër derës e kuptova se ishte shkollë fillore. U çudita dhe pyeta imamin se pse qëndronte e mbyllur. Imami më tha se qëndronte e mbyllur që prej vitit 1947. Anglezët provokuan hindut dhe i bënë ato që të vrisnin të gjithë muslimanët, pa bërë dallim burra, gra, fëmijë apo pleq. Kjo shkollë qëndron e mbyllur që atëherë. Ky zinxhir dhe ky kyç na kujton neve dhunën angleze. Unë jam i ardhur në këtë qytet dhe jetoj këtu prej disa kohësh.

Anglezët këtu zhdukën dijetarët, librat dhe shkollat e Islamit, ashtu siç kanë bërë në të gjithë shtetet e tjera muslimane që kishin nën sundim. Edukuan një rini komplet injorante nga ana e fesë. Anglezi i famshëm Lord Macauley i cili erdhi në Kalkuta në vitin 1834, ndaloi botimin e çfarëdo lloji libri në gjuhën arabe dhe persiane, bile ndërpreu edhe botimin e atyre librave që kishin filluar të botoheshin, si edhe urdhëroi ndalimin e qarkullimit të tyre. Për këtë gjë që bëri pati mbështetje të madhe nga anglezët. Këto dhuna i kanë ushtruar sidomos në Bengal, qytet ku shumica e banorëve janë muslimanë. Anglezët në Indi mbyllën të gjitha medresetë muslimane dhe në vend të tyre hapën 160 kolegje, 8 prej të cilëve ishin për vajza. Të rinjve që kanë studjuar në këto kolegje u kanë bërë lavazh truri dhe i kanë edukuar në mënyrë që të jenë armiq të feve të të parëve të tyre. Dy të tretat e ushtrisë angleze që ushtronte terror dhe dhunë në Indi, përbëhej nga vendasit të cilëve u kishin bërë lavazh truri dhe i kishin bërë të krishterë.

Ligjet e vitit 1833 lehtësuan zgjerimin e veprimtarisë misionare

dhe bënë të mundur që organizata e fesë protestante të fuqizohej shumë në Indi. Përpara se të perhapeshin veprimtaritë misionare dhe India të kalonte plotësisht nën sundimin Anglez, Anglezët tregonin respekt për besimin Islam, gjuanin me topa në ditët e bajramit, ndihmonin në riparimin e xhamive dhe mesxhideve, bile kishin edhe detyra në shoqatat Islame që punonin në ndihmë të medreseve dhe tyrbeve. Me urdhërat që erdhën nga Anglia në vitin 1833 dhe në vitin 1838 u ndalua që Anglezët të merrnin pjesë në këto veprimtari. Kjo veprimtari e tyre tregon qartë se politika e tyre me shtetet Islame që duan të sulmojnë është, në fillim duken si miq, i ndihmojnë ato, thonë se i duan muslimanët dhe punojnë për përhapjen e Islamit, në këtë mënyrë arrijnë të mashtrojnë muslimanët dhe të fitojnë besimin e tyre, pasi ia kanë arritur këtij qëllimi veprimtaria e tyre është të zhdukin ngadalë dhe me dinakëri themelet e Islamit që janë librat, shkollat dhe dijetarët. Me këtë politikë dyfytirëshe i bëjnë dëmin më të madh Islamit dhe po thajnë rrënjët e tij. Më pas qëllimi i tyre ishte që të bënin anglishten gjuhë zyrtare dhe të krishterizojnë rininë. Për këtë qëllim hapën shkolla të cilat ishin krejtësisht nën kontrollin e misionerëve. Bile qeverisësi Anglez i Indisë Lord Palmerston dhe shumë Lordë të tjerë Anglezë kanë thënë: Allahu ia ka dhënë Indinë Anglezëve për të bërë të mundur që Indianët të përfitojnë nga të mirat e krishtërit.

Lord Macauley është munduar shumë që të krijojë në Indi një popull me gjak dhe ngjyrë Indiane, por me dëshira, mendime, besime, moral dhe zgjuarsia si Anglezë. Për këtë arsye në shkollat e hapura nga misionerët, i dha rëndësi të veçantë mësimi të gjuhës dhe letërsisë Angleze dhe mësimi të fesë krishtere. Nuk i dha fare rëndësi shkencave (matematikë, fizikë, kimi ejt.). Kështu edukuan njerëz të krishterizuar, që nuk dinin asgjë tjetër përveç gjuhës dhe letërsisë Angleze. Këto i punësuan si zyrtarë.

Për shkak se muslimanët që dalin nga feja bëhen murted dhe sipas hinduve ata që dalin nga feja hindu quhen të pa fe, vendasit që krishterizoheshin e humbisnin të drejtën e trashëgimisë të pasurisë së familjeve të tyre. Misionerët për ta penguar këtë gjë me anë të ligjeve të nxjerra në vitet 1832 dhe 1850 në Bengal bënë të mundur që në të gjithë Indinë çdo vendas qoftë i krishterë, murted apo i pa fe të gëzonte të drejtën e trashëgimisë. Për këtë arsye hindutë i quajtën shkollat Angleze në Indi, **Shkollat e Shejtanit**, shkrimtari Francez Marcelle Perneau i cili ka vizituar Indinë në vitin 1925 në librin e tij thotë: “Qyteti i rrënuar i Kalkutës, qyteti kryesor i Indisë, nuk krahasohet aspak as me lagjet e shkatërruara

nëpër rrethinat e Parisit dhe Londrës, nëpër klube njerëzit janë përzier me kafshët, fëmijët qajnë dhe të sëmurët rënkojnë. Nëpër rrugë shihni të shtrirë si të vdekur njerëz të droguar dhe të rraskapitur. Njeriu kur sheh njerëz kaq të varfër, të uritur, të dobët dhe të rraskapitur, pyet vetveten se çfarë pune mund të bëjnë këta njerëz.

Këto njerëz të shumtë që vrapojnë për të punuar nëpër fabrika, sa përqind të fitimit të këtyre fabrikave paguhen? Nevojat, vuajtjet, sëmundjet ngjitëse, pijet dhe droga po e shfarosin fare popullin e dobët dhe pa rezistencë. Në asnjë vend tjetër të botës nuk tregohet një pakujdesi e tillë ndaj njerëzve, siç tregohet këtu. Asnjë mundim dhe asnjë punë nuk quhet e rëndë dhe e dëmshme për shëndetin. E kujt do t'i bëhet dëm po vdiq një punëtor? Nesër menjëherë punësohet një tjetër në vend të tij. Gjëja e vetme që mendojnë Anglezët është si e si të shtojnë prodhimet dhe të fitojnë sa më shumë para”.

Ish ministri i jashtëm i SHBA-së Williams Jennings Bryan, thotë se qeveria Angleze është më mizore se ajo Ruse dhe në fund të librit të tij **“Sundimi Anglez në Indi”** shkruan: (Anglezët që u urojnë shëndet dhe mirëqenie Indianëve të mbetur në jetë, kanë çuar në varr miliona Indianë. Ky popull që gjatë gjithë kohës thotë se ka krijuar gjykata dhe forca policore në çdo vend të Indisë, në të vërtetë me një plaçkitje zyrtare u kanë vjedhur Indianëve të gjitha pasuritë deri në kopsat e rrobave. Megjithëse fjala vjedhje mund të quhet pak si e rëndë, nuk është e mundur të shpjegohen ndryshe veprimet e qeverisjes Angleze. Populli Anglez që hiqet si popull i krishterë nuk dëshiron t'i dëgjojë thirrjet për ndihmë të muslimanëve Indianë që rënkojnë nën zinxhirin e robërisë.)

Mister Hodberk Keombtun në librin e tij **“Jeta e Indianëve”** thotë: “Zotërinjtë [Anglezët] i shtypin Indianët, ndërsa ato vazhdojnë të punojnë deri sa të vdesin e të humbasin gjithçka”. Ky është vetëm një nga shkrimet e shumtë të Anglezëve të ndërgjegjshëm dhe të mëshirshëm, të cilët shprehin padrejtësinë e Anglezëve.

Gjendja e muslimanëve Indianë të cilët Anglezët i çonin të punonin në kolonitë e tjera të tyre, ishte akoma edhe më e keqe. Në vitin 1834, industrialistët Anglezë, në vend të afrikanëve vendas filluan të përdornin si punëtor Indianët, shpërngulën me mijëra Indianë nga India, në kolonitë e tyre në Afrikën e jugut. Gjendja e këtyre punëtorëve, të cilët mbanin emrin **Kuli**, ishte akoma më e keqe se gjendja e skllevërve. Këto punonin në punë që quheshin **Indentured Labour**, punë me kontratë. Kështu

punëtorët Indianë nënshkruanin një kontratë që i detyronte ato të punonin 5 vjet. Gjatë këtyre 5 vjetëve, punëtorët nuk kanë të drejtë të braktisin punën, të martohen dhe janë të detyruar të punojnë ditë e natë nën goditjet e kërbacit. Gjithashu ishin të nënshtruar të paguanin një taksë prej 3 florinjsh Anglezë në vit. (Këto i janë bërë të njohura të gjitha botës me shkrimet **Labour in India** dhe **Post-Lecturer in the University of New York.**)

Gandi i famshëm u kthye në Indi, pasi përfundoi studimet e tij në Angli. Është djali i kryepiftit të Porbandarit, babai i tij ka qenë një Indian i krishterizuar. Në vitin 1893 një firmë Angleze e dërgoi atë në Afrikën e Jugut. Kur pa gjendjen tepër të rëndë që jetonin dhe shtypjen që pësonin punëtorët Indianë atje, filloi t'i kundërvihet Anglezëve. Megjithëse ishte djali i një njeriu të edukuar dhe të krishterizuar nga Anglezët, nuk mundi ta duronte dot dhunën dhe shtypjen e tyre. Që me këtë veprim filloi të fitonte famë.

Themeli i politikës Angleze në vendet Muslimane mund të përmbledhet me këto tre fjalë: “Copëto, sundo dhe zhduk fenë.”

Nuk kanë asgjë pa bërë për t'ia arritur qëllimeve të tyre.

Puna e parë e tyre në Indi, ishte të gjenin persona që të bashkëpunonin me to. Duke përdorur këto persona, dalëngadalë i vunë flakë zjarrit të intrigave. Për të realizur qëllimet e tyre përdorën hindutë që jetonin nën sundimin e Muslimanëve. Ua mbushën mendjen hinduve të cilët jetonin nën drejtësinë Muslimane, se të zotët e vërtetë të Indisë ishin hindutë. U thanë atyre se muslimanët i përbuznin zotat e hinduve dhe për këtë arsye hindutë duhet t'i kundërviheshin kësaj gjëje. Kështu bënë të mundur që t'i kalonin hindutë nga ana e tyre dhe i punësuan ato si ushtarë me pagesë. Kur erdhi puna për të krijuar ushtrinë që urdhëroi Mbretëresha Elizabetë, u bashkuan së bashu injoranca e hinduve, armiqësia e Anglezëve ndaj Islamit dhe lakmia për para. U prishën marrëdhëniet midis qeveritarëve Muslimanë dhe pasanikëve hindu dhe kështu filloi lufta. Anglezët gjithashtu blenë me para edhe njerëz Muslimanë me besim të dobët.

Përfaqësuesi i mbretit dhe kryetari i organizatës për Indinë, Sir John Strachey, thotë kështu mbi armiqësinë mes Muslimanëve dhe hinduve: “Çdo lloj veprimi që mund të bëhet për të sunduar dhe për të përçarë, është i përshtatshëm për qeverinë tonë. Ndihma më e madhe për politikën tonë në Indi është se këtu jetojnë dy armiq të njëri-tjetrit.” Anglezët vazhdimisht e kanë shtuar këtë armiqësi dhe që nga viti 1750 e deri në vitin 1870 sëbashku me hindutë, kanë bërë masakra të mëdha ndaj muslimanëve të Indisë.

Luftërat midis Muslimanëve dhe hinduve, të cilat filluan në vitin 1858, erdhën vazhdimisht duke u rritur. Anglezët i hidhnin hindutë në luftë kundër Muslimanëve dhe vetë rrinin e bënin sehir të kënaqur të njetën gjë e bënë edhe në Bosnjë në vitin 1990, ku futën në luftë Serbët kundër Boshnjakëve. Anglezët bënin sehir të kënaqur se si vriteshin rrugëve fëmijët Boshnjakë. Në Indi nuk ka kaluar asnjë vit ku të mos dalin ngatërresa dhe përlshje të gjakshme me shumë të vrarë për shkak të bërjes kurban të një lope. Anglezët për t'i shtuar sa më shumë këto zënka nga një anë u mbushnin mendjen Muslimanëve se të bënin kurban një lopë ishte më e pëlqyer tek Allahu se sa të bënin kurban 7 dele. Nga ana tjetër u thonin hinduve se ishte sevap i madh t'i shpëtonin zotat e tyre (lopët) nga therja. Këto zënka kanë vazhduar edhe pas largimit të Anglezëve. Në lidhje me këtë po ju përcjell një shkrim të shkëputur nga libri **Ittilaat**, i botuar në Iran në kohën e Musaddikut.

(Një ditë bajrami dy muslimanë me mjekër dhe çallmë blenë një lopë për ta bërë kurban. Kur po kalonin nga lagja e hinduve u del përpara një hindu dhe i pyet se çfarë kishin ndërmend të bënin me lopën. I'u përgjigjën se do ta bënin kurban. Ky filloi të bërtiste “Ej njerëz! Vraponi, duan të bëjnë kurban zotin tonë”. Muslimanët thërritën “O Muslimanë, vraponi, duan të na marrin kurbanin nga duart”. U mblodhën hindutë dhe Muslimanët. Filluan të përlsheshin me shkopinj dhe thika. U vranë me qindra Muslimanë. Ndërsa dy burrat që po kalonin lopën nga lagja e hinduve u panë të futeshin në ambasadën Angleze. Kjo ngjarje tregon se ato që e kanë organizuar këtë ngatërresë janë Anglezët. Më pas ky shkrimtar shkruan “Ne e dimë se si ia keni prishur ju Muslimanëve festën e Kurbanit”, me ngatërresa dhe përçarje të shumta si këto, jeni munduar gjatë gjithë kohës të shfarosni Muslimanët.

Kur e panë se dalëngadalë hindutë filluan të ngrejne kokën kundër tyre, atëherë Anglezët në vitin 1870 këtë radhë filluan të mbështesin Muslimanët kundër hinduve.

Edukuan armiq të Ehli syneetit të cilët mbanin emrin Muslimanë, por në të vërtetë e luftonin Islamin duke thënë se xhihadi me luftë nuk është farz dhe duke u thënë hallall gjërave të ndaluara nga Islami, sir Sejjid Ahmed, Gulam Ahmed Kadijani, Abdullah Gaznevi, Ismail Dehlevi, Nezir Husejn Dehlevi, Siddik Hasan han Pehupali, Reshid Ahmed Kenkuhi, Vahid-uzzaman, Haydar abadi, Eshref Ali Tahnevi dhe nipi i Shah Abdulazizit, Muhammed Is'haku, janë disa prej këtyre. Duke mbështetur këto

bënë të mudur krijimin e sekteve të reja fetare dhe gjatë gjithë kohës janë munduar t'i tërheqin Muslimanët në këto sekte.

Sekti më i njohur prej këtyre është **Kadijanizmi**, i krijuar në vitin 1879 (Hixhri 1296) nga Gulam Ahmedi. Ky sekt pretendon se xhihadi me luftë dhe me armë nuk është farz, farz është xhihadi me fjalë dhe me këshilla. Edhe Agjenti Anglez Hempheri, po të njejtat gjëra i thoshte Nexhdi Muhammedit.

Gulam Ahmedi ishte një jo besimtar që vinte nga sekta Ismaili. Ky vdiq në vitin 1908 (Hixhri 1326). Anglezët e blenë këtë duke i ofruar një shumë të madhe parashë. Në fillim tha se ishte Muxhedid e më vonë filloi të pretendonte se ishte “Mehdiu”. Më në fund e shpalli veten profet dhe krijoi një fe të re. Njerëzit që arriti të mashtronte, i quajti ymetin e tij. Thonte se shumë ajete të Kur'anit lajmëronin ardhjen e tij dhe se ai kishte më shumë mrekulli se të gjithë Pejgamberët e tjerë. I quajti kafirë të gjithë ato që nuk i besuan atij. Të gjitha mendimet e tij i përhapë tek popujt injorantë të Pancabit dhe Bombayit. Në ditët e sotme është vënë re se kjo fe ka filluar të përhapet edhe në Evropë dhe Amerikë, nën emrin **Ahmedijje**.

Muslimanët Syni janë munduar t'i bindin njerëzit se xhihadi me luftë dhe armë është farz dhe se bashkëpunimi me Anglezët është kufër. Muslimanët që bënin një propogandë të tillë mernin dënime të rënda dhe shumica e tyre vriteshin. Librat e Ehli syнетit u mblodhën dhe u zhdukën.

Dijetarët e Islamit të cilët nuk arrinin dot t'i blinin dhe t'i bënin të bashkëpunonin me to, i armiqësonin me popullin. Nga frika se po t'i vritnin këto besimtarë do t'i kthenin në heronj, nuk i vrisnin por i kalbnin në burgun e famshëm të Andamanit. Edhe dijetarët e Islamit që i mblodhën duke i mashtruar se do të bënin revolucion, po në këtë burg i mbyllën. [Kur pushtuan Stambollin pas luftës së parë botërore, i mblodhën të gjithë dijetarët dhe pashallarët Osmanllinj dhe i internuan në Maltë.]

Për të fshehur armiqësinë e tyre nga Muslimanët morën fetva se India nuk është “Darul Harp” por “Darul Islam”. Më pas e përhapën gjithandej këtë fetva.

Me anë të munafikëve që punonin për to përhapën mendimin se Sulltanët e perandorisë Osmane nuk janë Halife, e drejta për tu bërë Halife është vetëm e Kurejshëve dhe Osmanllinjët e kanë marrë atë me dhunë, për këtë arsye nuk duhet t'u bindesh atyre.

[Hadithi sherif “**Halifet do të jenë nga fisi** [pasardhësit e tyre] **i Kurejshëve**” do të thotë se nëse mes atyre që kanë cilësitë e

duhura dhe e meritojnë të bëhen Halife ka edhe Kurejshë, duhet që të zgjidhen Kurejshët [psh Sejidët]. N.q.s mes atyre që e meritojnë të bëhen Halife nuk ka asnjë prej Kurejshëve, atëherë zgjidhet dikush tjetër. Tregohet bindje edhe ndaj atij që nuk është zgjedhur Halife, por që e ka marrë pushtetin me forcë ngaqë nuk e pranon Halifen e zgjedhur, sepse në të gjithë botën duhet të ketë vetëm një Halife dhe të gjithë Muslimanët duhet t'i binden vetëm atij.]

Për ta shembur Islamin nga brënda, mbyllën të gjitha medresetë fetare dhe hapën Universitetin e Aligarhit dhe në Aligarh një medrese ku mësoheshin dituritë e fesë Islame. Këtu edukuan njerëz të paditur nga ana fetare dhe armiq të fesë. Dëmi që i kanë bërë njerëz të tillë fesë ka qenë tepër i madh, studentët që zgjidhnin në këto shkolla i çonin në Angli dhe pasi i edukonin atje në mënyrë që ta shembnin nga brënda Islamin, i kthenin përsëri në vendin e tyre dhe i vedosnin prijës të Muslimanëve. Ejjup han ishte njëri nga këto dhe Anglezët e vendosën atë prijës të shtetit në vend të M.Xhinaahut.

Anglezët, megjithëse hiqeshin sikur kishin dalë fitimtarë nga lufta e dytë botërore, në të vërtetë dolën të humbur, sepse shteti i tyre që e kishin quajtur “Shteti ku nuk perëndon Dielli” shkoi në gjendjen e një shteti ku nuk lind shumë Dielli. I humbën shumicën e kolonive të tyre dhe ngelën si pula të rjepura.

Ali Xhinnah që patën bërë prijës të shtetit ishte Shiit dhe bashkpunëtor i Anglezëve, ndërsa Ejubi që vendosën në vend të tij në 1948 kur ai vdiq, ishte mason. Ky e mori pushtetin në duar duke bërë grusht shteti. Gjenerali Jahja i cili u vendos në vend të tij ishte Alevi i betuar. Në vitin 1972 humbi luftën kundër Indisë dhe për shkak se i iku nga duart Pakistani lindor e burgosën. Pas gjeneral Jahja-it në drejtim të shtetit hipi Zulfikar Ali Butto. Ky kishte kryer studimet në Angli dhe ishte agjent Anglez. Në vitin 1974 u ekzekutua, sepse dha urdhër për ekzekutimin e të gjithë opozitarëve të tij.

Zijaul Hak'u që mori pushtetin pas ekzekutimit të Zulfikar Ali Buttos e kuptoi se çfarë mendonin armiqtë e Islamit për muslimanët, e kuptoi se ato mundoheshin të shfarosnin Islamin dhe nuk pranoi të bashkëpunonte me to. U mundua shumë që shteti i tij të përparonte në shkencë dhe në teknikë. E kuptonte se rruga e vetme për mirëqenien dhe lumturinë e popullit ishte Islami dhe për këtë arsye dëshironte që t'i formulonte ligjet në përputhje me fenë Islame. Këtë dëshirë të tij ia paraqiti popullit. Në referendumin që u bë për këtë gjë, i gjithë populli i Pakistanit votoi pro.

Tradhëtarët që punonin për Anglezët i bënë atentat Zijaul Hakut dhe e vranë atë së bashku me të gjithë bashkpunëtorët e tij. Më pas Benaziri, e bija e Ali Buttonit, e cila u zgjodh kryetare shteti, liroi nga burgu të gjithë tradhëtarët të cilët ishin dënuar për veprimtari kundër fesë Islame dhe i vendosi këto në postet e larta të shtetit. Kështu në Pakistan filluan trazirat dhe përlëshjet, u plotësuan dëshirat e Anglezëve.

Në fund të luftërave botërore në shumë shtete kanë vënë në krye njerëz që punojnë për interesin dhe për realizimin e planeve të tyre. Këto shtete kanë pasur himnet, flamujt dhe presidentët e tyre, por asnjëherë nuk kanë patur lirinë fetare.

Në tre shekujt e fundit pas perdes së të gjitha tradhëtive që kanë pësuar popujt muslimanë e në veçanti perandoria Osmane, gjithmonë kanë qenë Anglezët.

E shembën perandorinë Osmane dhe e copëtuan atë duke formuar 23 shtete të vegjël, shkaku për këtë është të pengojnë Muslimanët të kenë një shtet të madh e të fuqishëm.

Mes shteteve që quhen Muslimane kanë nxitur armiqësinë dhe i kanë vënë të gjithë këto shtete kundër njëri-tjetrit. Psh në Siri ku shumica e popullsisë përbëhet nga Muslimanët, shtetin e drejtojnë Nusajritë, të cilët përbëjnë vetëm 9% të popullsisë. Në vitin 1982 kanë sulmuar me ushtri qytete Hama dhe Humus, të dy qytetet u shkatërruan krejtësisht dhe Muslimanët Syni të pa armatosur dhe të pa mbrojtur u vranë nga bombardimet.

U vranë të gjithë dijetarët e vërtetë të Ehli Syneetit dhe u asgjësuan të gjithë librat fetarë, përfshi këtu edhe Kur'anët. Në vend të dijetarëve të vërtetë sollën në krye njerëzit pa medhheeb dhe gjoja njerëzit e fesë të cilët i kishin edukuar vetë. Prej këtyre:

Xhemaleddin Efgani lindur në Afganistan në vitin 1838 (Hixhri 1254). Ky lexonte shumë libra filozofie. Në Afganistan ka luajtur rolin e agentit Rus. Më pas shkoi në Egjipt ku u bë mason dhe krijoi organizatën e masonëve. Egjiptiani Edip Is'hak ka shkruar në librin e tij **“Ed-Durer”** se ky ka qenë prijësi i organizatës masone në Kairo. Në faqen 127 të librit **Les Franco Maçons**, të botuar në Francë në vitin 1960 shkruhet: “Në krye të organizatës masone të krijuar në Egjipt u vendos Xhemaleddin Efgani, e pas tij u vendos Muhammed Abduh. Këto kanë dhënë një ndihmesë të madhe për përhapjen e masonizmit mes muslimanëve.”

Ali Pasha që ka kryer 5 herë detyrën e sadrazamit (kryeministrit) gjatë sundimit të Sulltan Abdulmexhidit dhe Sulltan Abdulazizit, ishte një mason i varur nga masonët e Anglisë.

Ky e solli Efganin në Stamboll dhe i dha atij detyrë shetërore. Hasan Tahsini, rektori i atëhershëm i Universitetit të Stambollit, për të cilin është dhënë fetva se ka qenë kafir, e lejoi Efganin të jepte konferenca të shumta. Hasan Tahsini ishte Edukuar nga një mason tjetër që punonte për Anglezët, sadrazami Mustafa Reshid pasha. Ky u mundua të përhapte gjithandej mendimet e tij të gabuara, shejhul Islami i asaj kohe Hasen Fehmiu e turpëroi Xhemaleddin Efganin, duke vërtetuar se ishte injorant dhe i pa fe. Pas kësaj Ali pasha u detyrua që ta largonte atë nga Stambolli. Kështu ky u detyrua të shkonte në Egjipt ku filloi të përhapte mendimin e revolucionit dhe reformës në fe, sëbashku me ato që përgatitën rrëzimin e Arabi pashës hiqej sikur ishte kundër Anglezëve. U bë shok i ngushtë i Ahmed Abduhut, myftiut të Egjiptit dhe i injektoi atij mendimet për të bërë reforma në fe. Me ndihmën e masonëve të Parisit dhe Londrës filloi të botonte një revistë. Në vitin 1886 shkoi në Iran, ku i vazhdoi përsëri aktivitetet e tij. Këtu e lidhën me zinxhirë dhe e lëshuan në kufijtë e perandorisë Osmane, shkoi në Bagdad dhe Londër ku bëri shumë shkrime kundër Iranit. U kthye përsëri në Stamboll dhe filloi politikën me ndihmën e Behaive të Iranit.

Më i famshmi nga ata që u mashtruan nga politika e Xhemaleddin Efganit ëdhtë **Muhammed Abduhu**. Muhammed Abduhu lindi në Egjipt në vitin 1849 dhe vdiq po aty në vitin 1905. Jetoi një periudhë në Bejrut, që aty shkoi në Paris dhe aty me nxitjen e Xhelaleddin Efganit filloi të bashkpunonte me masonët. Këtu sëbashku botuan librin **El-urvet-ul-Vuska**. Kur u kthye Bejrut dhe në Egjipt filloi të punonte sipas planeve të masonëve. Me ndihmën e Anglezëve arriti të bëhet Myftiu i Egjiptit dhe filloi të sulmonte Ehli synetin. Në fillim u mundua të prishte programin mësimor të medresesë Xhemiul Ez'her, në mënyrë që t'i pengonte studentët të mësonin dituritë më të rëndësishme. I hoqi fare nga programi mësimor mësimet që ishin për nivelin e universitetit, studentëve të universitetit u vuri në program mësimet e arsimit të mesëm. Nga një anë hoqi nga programet mësimore lëndët e fesë dhe nga ana tjetër filloi të shante dijetarët e vërtetë të Islamit se gjoja pengonin mësimin e shkencave dhe vetë thoshte se mundahej t'i fuste këto shkencë në fe. Në librin e tij **Islamijjet ve nasranijjet** ka thënë "Të gjitha fetë janë një. Vetëm pamja e jashtme e tyre është e ndryshme". Me këtë ka dashur të shprehë se Çifutët, të krishterët dhe Muslimanët duhet të ndihmojnë njëri-tjetrin. Në një letër që i ka shkruar një prifti në Londër thotë: "Pres që dy fe të mëdha siç janë Islami dhe Krishtërimi, t'i japin

dorën njëra-tjetrës dhe të përqafohen. Atëherë Teurati, Ungjilli dhe Kur'ani do të bëhen libra që mbështesin njëri-tjetrin, do të lexohen në çdo vend dhe do të repektohen nga çdo popull". Gjithashtu ka shprehur se mezi pret kohën kur Muslimanët do të fillojnë të lexojnë Teuratin dhe Ungjillin.

Në tefsirin e Kur'anit që ka bërë sëbashku me profesorin e medrese së Xhemiul Ez'her, Shalut'in, ka dhënë fetva se kamata e bankave është e lejuar. Më vonë pas presionit të madh të muslimanëve ka bërë sikur i ka tërhequr mbrapsht këto fjalë.

Në faqen 197 të librit **Dairetul meariful masonije**, të botuar në vitin 1961 nga kryetari i organizatës masone të Bejrutit, Hanna ebu Rrashid, shkruhet: "Xhemaleddin Efgani ka qenë prijësi i organizatës masone të Egjiptit. Rreth 300 anëtarë të kësaj organizate përbëheshin nga dijetarë dhe pushtetarë. Pas tij në krye të kësaj organizate u vendos Muhammed Abduhu. Abduhu ishte një mason i madh. Asnjë nuk mund ta mohojë se ky është njeriu që e ka përhapur frymën mazonizmit në Evropë."

Njëri nga kafirët më të famshëm që hieqj si dijetar i Islamit në Angli dhe që lavdërohej shumë nga Anglezët është Sir Sejjid Ahmed Han'i. Ky lindi në Dehli në vitin 1818. Babai i tij ishte shpërngulur në Angli në kohën e Shah Ekberit. Karrierën e tij e filloi në vitin 1837, si sekretar i xhaxhait të tij gjykatës. Në vitin 1841 u bë gjykatës dhe në vitin 1855 u bë kryegjykatës.

Një nga dijetarët e tjerë të rremë në Indi është Hamidullahi. Ky ka lindur në Hajdarbad, qytet ku shumicën e popullsisë e përbëjnë pjesëtarët e sektit Ismaili. Në sektin Ismaili u edukua si armik i betuar i Islamit. Ka punuar për të bindur njerëzit se Muhammedi "alejhis-selam" është Pejgamber vetëm për Muslimanët. Arma më e fuqishme e Anglezëve në luftën për zhdukjen e Islamit ka qenë nxjerrja nga feja e njerëzve, duke përdorur propagandën se gjoja po e përshtasnin Islamin sipas kohës, po e modernizonin atë dhe po e kthenin atë në identitet.

Dijetari i madh i Islamit, Shejhulislami Mustafa Sabri, ishte njëri nga ato që i kuptonin shumë mirë qëllimet e Anglezëve. Për t'iu kundërvënë këtyre ka shpjeguar qartë se të mos bësh pjesë në asnjë nga medhhebet e vërteta është një urë që të nxjerr nga feja, dhe gjithashtu shpjegonte me fakte qëllimet e vërteta të armiqve të Islamit.

Armiqtë e fesë gjithashtu janë munduar të prishin teqet dhe rrugët e tasavufit, janë munduar të zhdukin sinqeritetin, që është pjesa e tretë e Islamit. Njerëzit e tasavufit nuk merreshin kurrë me

politikë dhe nuk prisnin ndonjë privilegj nga askush, shumica e njerëzve të mëdhenj të tasavufit kanë qenë dijetarë të mëdhenj dhe muxhtehidë, sepse tasavuf do të thotë të ecësh në rrugën dhe në gjurmët e Muhammedit “alejhis-selam” pra çdo fjalë dhe vepër e tyre ka qenë në përputhje të plotë me Islamin, por prej kohësh, injorantët, gjyqharkarët si edhe shumë agentë, kanë përdorur emrat e njerëzve të tasavufit, për t’ia arritur qëllimeve të tyre, dhe kështu janë bërë shkak për prishjen e fesë Islame dhe ligjeve të saj. Dhikër, do të thotë të përmendësh Allahun. Kjo gjë bëhet me zemër. Kur bën dhikër zemra pastrohet. Pra del nga zemra dashuria për botën dhe krijesat e saj dhe futet në zemër dashuria për Allahun. Mbledhja në një vend e burrave dhe grave dhe bërëtitja me zë të lartë nuk quhet dhikër. Rruga e dijetarëve të mëdhenj dhe e Es’habëve kiram është harruar. Ahmed ibni Tejmije që është njeri pa medhheb dhe armik i tasavufit është quajtur dijetar i fesë. Në rrugën e krijuar nga ky është krijuar **Vehabizmi**. Me ndihmën e Anglezëve dhe me ndërmjetësinë e **Rrabita-tul-alem-il islami**, që është qendra e Vehabive, janë përhapur në të gjithë botën librat e Vehabive. Ndërtesave të mëdha që kanë ndërtuar në çdo shtet u kanë vënë emrin “Medreseja Ibni Tejmije”. Përzierjes së mendimeve të prishura të Ibni Tejmijes me shpifjet e agentit Anglez Hemherit, i’u vendos emri **Vehabizëm**. Dijetarët e vërtetë të Islamit dhe të Ehli syneetit kanë shkruar shumë libra ku shpjegojnë me argumenta se librat e Ibni Tejmijes janë të gabuar dhe mendimet e tij të prishura. Njëri nga këto është libri “**El-makalatus-sunnijje fi keshfi-dalalat-i Ahmed Ibni Tejmije**”, i dijetarit Somalez sheh Abdurrahman Abdullah bin Muhammed Harrin. Ky ka lindur në vitin 1920 Në qytetin Herer të Somalisë. Libri i tij është botuar në vitin 1994 në Bejrut. Në këtë libër përmenden emrat dhe titujt e librave të dijetarëve që e kanë refuzuar Ibni Tejmijen. Në të gjitha sektet e gabuara të krijuara nga Anglezët, si: Vehabizmi, mos pranimi i medhhebeve, reformatorët, selefizmi, Kadjanizmi, Mevdudizmi, etj... ekziston armiqësia ndaj tasavufit.

Armiqët e Islamit e sidomos Anglezët, duke përdorur çdo lloj rruge i kanë lënë Muslimanët prapa në shkencë, teknologji dhe kanë penguar tregëtinë e zhvillimin e tyre. Për të arritur të prishin moralin e Islamit, për të shkatërruar qytetërimin dhe për të penguar rininë të mësojnë dituritë e kësaj feje, kanë përhapur alkoolin, prostitucionin, dëfrimet, lojërat me top e të tjera si këto. Për të shthurur rininë muslimane kanë përdorur si agjente vajzat Armene, të krishterë dhe jo muslimane. Me një mjeshtëri të

madhe kanë arritur t'i tërheqin vajzat muslimane në vende si qendra mode, kurse kërcimi dhe shkolla modelesh e artistesh, me këto mënyra janë munduar t'i fusin këto vajza në rrugë të keqe. Për këtë arsye prindërve Muslimanë u takon një detyrë tepër e vështirë. Duhet të tregohen shumë të zgjuar që të mos i lejnë fëmijët e tyre të bien në duart e këtyre kafirëve.

Në periudhat e saj të fundit perandoria Osmane dërgoi në Evropë për studime studentë dhe njerëz të shtetit. Disa nga këta studentë dhe njerëz të shtetit u mashtruan dhe u bënë masonë, studentëve që kishin shkuar për të mësuar shkencë dhe teknologji, i'u mësuan rrugët për të shembur perandorinë Osmane. Ai prej këtyre që i ka bërë dëmet më të madha Islamit dhe muslimanëve është Mustafa Reshid pasha. Gjatë kohës që gjendej në Londër për studime, u edukua si një armik tinëzar i Islamit. Filloi të bashkpunonte me masonët e Skocisë, sulltani Mahmud Han arriti ta kuptonte tradhëtinë e Reshid pashës dhe urdhëroi ekzekutimin e tij, por nuk i mjaftoi jeta për ta bërë një gjë të tillë. Reshid pasha me shokë, të cilët u kthyen në Stamboll pas vdekjes së Sulltanit, i kanë bërë dëmet më të mëdha Islamit dhe Muslimanëve.

Abdulgexhidi, i cili u bë Sulltan në vitin 1893, në atë kohë ishte vetëm 18 vjeç. Ishte i ri dhe pa përvojë. As dijetarët rreth tij nuk ia tërhoqën vëmendjen. Kjo gjendje u bë një pikë kthese e frikshme për historinë e Osmanllinjve. Për shtetin e fuqishëm Islam filloi periudha e shkatërrimit, sulltani i ri e me zemër të pastër u mashtrua nga fjalët e bukura të Anglezëve dhe caktoi me detyra të ndryshme njerëzit e përgatitur nga masonët Skocezë, si ambasador në Stamboll u dërgua Lord Rading i cili ishte anëtar i organizatës masone të Skocisë, e cila ishte krijuar nga Anglezët me qëllim për të luftuar Islamin. Ambasadori Lord Rading iu lut shumë Sulltanit që si sadrazam të caktonte Mustafa Reshid pashën. E mashtroi Sulltanin duke i thënë “N.q.s Emëron sadrazam këtë njeri të suksesshëm e më kulturë të madhe, atëherë të gjithë mosmarrëveshjet midis perandorisë tuaj dhe shtetit Anglez marrin fund dhe perandoria juaj përparon në fushat sociale, ekonomike e ushtarake.”

Mustafa Reshid pasha menjëherë sa u zgjodh sadrazam futi në qarkullim ligjin e **Reformës**, të cilin e kishte përgatitur sëbashku me Lord Radingun, në kohën kur ishte ministër i jashtëm. Më pas me mbështetje të këtij ligji krijoi në të gjithë qytetet grupe masone. Grupet e agjentëve dhe tradhëtarëve filluan veprimtarinë e tyre. Me planet e përgatitura në Londër, nga njëra anë filluan të bënin ndryshime në pushtet, ushtri e bujqësi. Me këto ndryshime u

munduan të blinin besimin e popullit. Nga ana tjetër filluan të prishin ligjet e Islamit, dashurinë për paraardhësit e tyre dhe dashurinë për atdheun. Në krye të detyrave vendosën të gjithë njerëzit që kishin përgatitur vetë. Në këto vite Evropa po bënte hapa gjigandë në shkencë si fizika dhe kimia, kishin bërë shumë zbulime të reja dhe kishin përparuar shumë. Ndërtonin vazhdimisht fabrika të mëdha, universitete teknike dhe prodhonin mjete moderne lufte. Në perandorinë Osmane nuk u bë dot asnjë nga këto. Bile nxorrën nga programi mësimor i medreseve mësimet e shkencës, llogaritjes, gjeometrisë dhe astronomisë, që mësoheshin në këto medrese që në kohën e Sulltan Fatihut. U bënë një pengesë e madhe për edukimin e dijetarëve të kompletuar duke thënë se dijetarët e fesë nuk kanë nevojë për dituritë shkencore. Armiqtë e fesë që erdhën më vonë, u munduan të largojnë fëmijët nga Islami duke thënë se njerëzit e fesë nuk marrin vesh nga shkencë, njerëzit e fesë janë të paditur dhe të prapambetur. Gjërave të dëmshme për Islam dhe gjërat që i pengojnë njerëzit të mësojnë fenë, i quajtën moderne dhe përparimtarë. Çdo ligj që nxorën ishte në dëm të shtetit Musliman. Të zotët e vërtetë të këtij shteti, të cilët ishin Muslimanët, përfunduan në gjendjen e shtresës së dytë.

Për muslimanët që nuk shkonin ushtarë vendosën një gjobë shumë të lartë që shumica e njerëzve nuk kishte mundësi ta paguante, ndërsa për jo muslimanët vendosën një gjobë tepër simbolike. Në kohën kur bijtë muslimanë të popullit binin dëshmorë në luftërat e nxitura nga Anglezët, si pasojë e lojërave të Reshid pashës dhe të bashkpunëtorëve të tij, e gjithë teknologjia dhe tregëtia e vendit kaloi në duart e masonëve dhe jo muslimanëve.

Përandori Francez Bonaparti i tretë për të penguar zbarkimin Rus në detin Mesdhe, me preteksin Cari Rus Nikolla i parë nxiste ortodoksët në luftë kundër katolikëve të Kudusit, i shtyu këto në luftën Osmano-Ruse të Kirit. Këtë luftë që e organizuan për përfitimet e tyre ua prezantuan popullit Osman si suksesi diplomatik i Reshid pashës, sulltani i ri i cili i kuptoi përpara të gjithëve qëllimet e vërteta të armiqve, të cilët i maskonin këto me reklama të bukura e me miqësi të rreme, shpesh herë mbyllej në pallat dhe qante me orë të tëra. Kërkone rrugë për të larguar nga atdheu armiqtë dhe i lutej vazhdimisht Allahut për këtë. Për këtë arsye e hoqi disa herë nga detyra Reshid pashën, por ky gjithmonë arriti ti mposhte kundërshtarët e tij dhe të hipte përsëri në këtë detyrë. Për fat të keq Sulltani u sëmur me tuberkuloz nga brengat

e mëdha dhe humbi jetën në moshë fare të re. Në kohët e mëvonshme ato që ndanin detyrat e qeverisë mes njëri-tjetrit, profesorët e rinj të universiteteve, gjykatësit etj, ishin po masonët e përgatitur nga Reshid pasha. Kështu filloi periudha e vështirë për këtë perandori dhe shteti Osman u quajt **Njeri i sëmurë**.

Profesori i ekonomisë Omer Aksu, në një shkrim të tijin të botuar në 22 Janar 1989 në gazetën Türkiye, shkruan: “Tek ne si fillimi i shkuarjes drej perëndimit tregohet ligji i Reformave i nxjerrë në vitin 1839. Ne nuk kemi arritur ta kuptojmë se ajo gjë që duhej të mernim nga perëndimi ishte teknologjia, ndërsa kultura duhej të qëndronte kultura e të parëve tanë. E kemi parë shkuarjen drejt perëndimit si një lëvizje që bëhet duke kopjuar sjelljet dhe zakonet e të krishterëve. Marrëveshja tregëtare që ka bërë Mustafa Reshid pasha me Anglinë, i ka dhënë goditjen më të rëndë zhvillimit të teknologjisë tek ne.”

Sundimi i masonëve Skocezë në Perandorinë Osmane vazhdoi gjatë. U vranë shumë pashallarë dhe u penguan të gjitha veprat që ishin në të mirë të shtetit dhe popullit. Kryengritjet dhe revolucionet ndoqën njëri-tjetrin. Vranë Sulltan Abdulhamidin, njeriu që i luftoi më shumë këto tradhëtarë të vendit, sulltan Abdulhamidi filloi ta rimëkëmbte ekonominë e perandorisë, ndërtoi shumë shkolla dhe bëri hapa gjigandë në rindërtimin e vendit. Ndërtoi një fakultet mjekësie që nuk gjendej askund tjetër në botë, vetëm një në Vienë mund ta konkuronte. Në vitin 1876 hapi fakultetin e shkencave politike. Në vitin 1882 krijoi fakultetin e drejtësisë dhe këshillin e lartë të drejtësisë. Në vitin 1886 hapi shkollën e lartë të inxhinierisë dhe një shkollë konviktore për vajzat. Për të ndaluar largimin e të rinjve që të mos shkonin me studime në Evropë ku mund të mashtroheshin nga masonët, mori profesorët nga Evropa dhe i solli të jepnin mësim në universitetet që hapi vetë. Këto profesorë i sillte të jepnin mësim në perandorinë Osmane duke i joshur me shuma të mëdha parash. Bëri të mundur që edhe vajzat të mernin mësim shkence nga keto profesorë. Edukoi njerëzit me dashurinë për atdheun, popullin, fenë dhe shkencën, solli në Stamboll ujin e liqenit Terkos. Hapi shkollën e tekstilit në Bursa dhe shkollat e bujqësisë dhe veterinarisë në Stamboll. Ndërtoi fabrikën e letrës në Hamidije, fabrikën e gazit natyral në Kadikoy dhe portin e Bejrutit. Krijoi institutin e sigurimeve. Ndërtoi minierat e qymyrit në Ergeli dhe Zonguldak. Hapi një spital për të sëmurët mendor, spitalin Hamidije Etfalet në Shishli dhe një Azil për njerëzit pa përkrahje. E fuqizoi përsëri ushtrinë dhe e bëri atë ushtrinë tokësore më të

madhe të kohës. I ankoroi të gjitha anijet në portin e Haliçit dhe i paishi ato me armë dhe me paisjet më të fundit të kohës, që i kishte sjellë nga Evropa. Ndërtoi shumë hekurudha. Në përandorinë Osmane u ndërtua hekurudha më e gjatë në botë e kohës. Veprat e këtij Sulltani ekzistojnë akoma edhe sot. Ata që udhëtojnë me tren e shohin me krenari se stacionet e trenit në mbarë turqinë janë ndërtuar nga Sulltan Abdulhamidi.

Çifutët dëshironin të krijonin në palestine një shtet Izraelit nën mbrojtjen dhe mbështetjen e Anglezëve, sulltan Abdulhamidi i cili i njihte shumë mirë veprimtaritë dhe qëllimet e këtyre dhe të Sionistëve, dha urdhër që të mos u shiteshin toka Palestineze Çifutëve. Kryetari i organizatës botërore të sionistëve, Theodor Herzi, së bashku me Hahamin (lideri shpirtëror i Çifutëve) Moshe Levi, vizituan Sulltanin dhe i kërkuan Sulltanit që t'i lejonte Çifutët të blinin toka në Palestinë. Përgjigja e Sulltanit ishte: “Edhe sikur të më luten të gjithë shtetet e botës dhe sikur të derdhin të gjitha pasuritë e tyre nën këmbët e mia, nuk ju jap asnjë pëllëmbë tokë. Toka që të parët tanë e kanë marrë dhe e kanë ruajtur deri tani me gjak nuk shitet me para.”

Çifutët bashkpunuan me forcën politike Ittihat ve Terakki (bashkëpunim dhe zhvillim) dhe i mblodhën të gjitha forcat kundër Sulltanit. E zbritën me forcë nga fronti në vitin 1909 duke lënë kështu jetimë të gjithë Muslimanët. Me ndihmën e masonëve drejtuesit e forcës politike Ittihat ve Terakki u vendosën në detyrat më të larta të shtetit. Bile edhe shejhulislamët Hajrullah dhe Musa Kazim që u emëruan prej këtyre, ishin masonë. E mbytnë vendin në gjak. Këto skllëvër të Anglisë duke ndjekur me përpikmëri planet dashakeqe të tyre e shtynë vendin në luftërat e Ballkanit, Çanakalesë, Rusisë dhe Palestinës, si rezultat i këtyre luftërave u shkatërrua ushtria tokësore më e madhe në botë e formuar nga Sulltan Abdulhamidi. Qindra mijëra bij të popullit ranë dëshmorë në këto luftëra. Njerëzit që erdhën në krye të shtetit në sajë të hileve Angleze, në kohën kur populli kishte më tepër nevojë për bashkëpunimin dhe mbrojtjen e tyre u arratisën dhe e lanë vendin pa zot. Me këtë veprim e vërtetuan se ishin tradhtarë.

Jo muslimanët që u mashtruan nëpër shkollat dhe kishat e hapura nga masonët ngritën krye ndaj perandorisë Osmane. Agjentët dhe gazetarët Evropianë që vinin të maskuar si mësues shkollash ose si priftërinj kishash, në çdo vend që shkonin dërgonin armë dhe shuma të mëdha parash. Organizuan kryengritje të mëdha. U bënë shumë masakra nga ana e

Armenëve, Bullgarëve dhe Grekëve, që tani mbushin faqet e historisë si njolla të njerëzimit. Ata që i sollën Grekët në Izmir ishin Anglezët. Allahu teala duke treguar një mëshirë të madhe për popullin Turk dhe në fund të një përpjekjeje të madhe për pavarësi arritëm të shpëtonim atdheun tonë të bukur.

Kur u shemb perandoria Osmane, shtetet e botës filluan të përlesheshin në njëri-tjetrit, sepse perandoria Osmane ishte një shtet si tampon, ishte mbrojtëse e Muslimanëve dhe pengesë që kafirët të përlesheshin me njëri-tjetrin. Pas Sulltan Abdulhamdit nuk ka patur paqe dhe rehati në asnjë vend. Në Evropë nuk mbaruan kurrë gjakderdhjet dhe vrasjet, në fillim nga luftërat botërore e më pas si shkak i komunizmit.

Ata që bashkëpunuan me Anglezët dhe qëlluan pas shpine Osmanllinjë, nuk kanë gjetur kurrë rehati. Më pas u penduan për këtë gjë dhe bile filluan t'i këndojnë hytбет në emër të Halifes së Stambollit. Vlera e perandorisë Osmane u kuptua më mirë kur në Palestinë me ndihmën e Anglezëve u krijua shteti Izraelit. Torturat dhe masakrat që Izraelitët i bëjnë popullit të Palestinës i janë bërë të qarta të gjithë botës me anë të gazetave dhe televizioneve. Ministri i jashtëm i Egjiptit Ismet Abdulmexhid, në vitin 1990 ka thënë "Egjipti paqen, rehatinë dhe ditët më të qeta në historinë e tij, i ka jetuar në kohën e Osmanllinjve."

Në çdo vend ku qëndrojnë interesat e vendeve të krishterë të Evropës dhe Amerikës, gjenden misionerët. Misionerët janë njerëz që nën pretekset gjoja për të përhapur krishtërimin, për t'i shërbyer Isait "alejhis-selam" që e quajnë zot, për të çuar paqen, qetësinë dhe dashurinë në këto vende, në të vërtetë prishin rehatinë e këtyre vendeve, duke u munduar vetëm të arrijnë qëllimet e tyre. Detyra e tyre kryesore është që t'i lidhin shtetet ku shkojnë për mision, pas shteteve të krishtere. Misionerët i mësojnë shumë mirë gjuhën, zakonet dhe kulturën e vendeve ku shkojnë. I mësojnë shumë mirë strukturat gjeografike, ekonomike politike dhe ushtarake dhe më pas ua kalojnë këto informacione vendeve të tyre. Këto njerëz mbajnë emra të zakonshëm të vendasve, por në të vërtetë janë ose injorantë të krishterizuar ose tradhëtarë të shitur.

Njerëzit që bëhen misionerë edukohen në vendet ku do të ushtrojnë aktivitetin e tyre ose stërviten nga një misioner që ka jetuar e është edukuar në atë vend.

Pas ligjit të Gulhanes të nxjerrë nga masoni Reshid pasha, aktivitetet e masonëve u shtuan shumë në perandorinë Osmane. U hapën kolegje në çdo cep të Anadollit. 21 vjet pas daljes së ligjit, u

hap në Harput **Kolegji i Fratit**. Nuk kursyen asnjë shpenzim për ndërtimin e këtij kolegji. Në atë kohë misionerët kishin krjuar 62 qendra të tyre në luginën e Harputit. Në 62 nga gjithësej 66 fshatrat Armene ishin ndërtuar qendra masone dhe për çdo tre fshatra ishte ndërtuar një kishë. Me aktivitetet e tyre arritën ti bëjnë të gjithë Armenët, të mëdhenj e të vegjël, armiq të Osmanllinjve. Edhe gratë misionere kanë bërë përpjekje shumë të mëdha për të bërë të njejtën gjë edhe me gratë e vajzat Armene. Misjonerja e famshme Maria A. West, në librin e saj me titull **Romance of Mission**, thotë “U futëm në zemrat e Armeneve dhe bëmë revolucion në jetën e tyre” Këto veprimtari vazhduan në të gjithë vendet ku jetonin Armenë. Qendrat më të rëndësishme të veprimtarive tona kanë qenë **Kolegji i Antepit** në Gaziantep, **Kolegji i Anadollit** në Merzifon dhe **Kolegji Robert** në Stamboll. Psh në kolegjin e Merzifonit nuk studjonte asnjë Turk. 108 nga 135 studentët ishin Armenë, ndërsa 27 të tjerët ishin Grekë. Këto ishin studentë konviktorë që i kishin mbledhur nga çdo cep i Anadollit. Drejtori i këtij kolegji, si në çdo kolegjet tjetër, ishte një prift. Në këtë kohë Anadolli filloi të ziente. Bandat Armene filluan të vrasin në mënyrë të pa njerëzishme muslimanët, digjin fshatrat e tyre dhe terrorizonin të gjithë Osmanllinjët. Pas masakrës së madhe të bërë nga Armenët në vitin 1893 u vërtetua se banditët që bënë masakra fshiheshin në keto kolegje. Po në këto kolegje bëheshin planet e të gjithë veprimtarive të këtyre bandave. Gjithashtu edhe komandantët e këtyre bandave ishin profesorë në këto kolegje, këto quheshin Kajajan dhe Tumajan. Pas kësaj ngjarjeje misionerët e ngritën të gjithë botën në këmbë. Në Amerikë dhe në Angli u bënë demonstrata të mëdha për të shpëtuar jetën e këtyre dy tradhëtarëve. Për këtë arsye u prishën mardhëniet midis Anglisë dhe perandorisë Osmane. I çuditshëm është edhe fakti se njëri nga organizatorët e demonstratave në Londër ishte drejtori i Kolegjit të Anadollit në Mefrizon. Këto masakra të bëra ndaj muslimanëve në Anadoll u shkruajtën të manipuluar në librat e historisë në shtetet e krishtere. Njëri nga këto libra është “**El-munxhid**” i botuar në Bejrut në gjuhën Arabe.

Në librin “**Kujtimet e Burgut**” i botuar në Stamboll në vitin 1978, të shkruar nga Ejub Sabri Efendi, në atë kohë punonjës i gjykatës në Gaziantep shkruan: “Sipas Anglezëve të shtypësh muslimanët dhe t’u bësh keq atyre është një detyrë kombëtare. Në vitin 1919 më tepër se 20 mijë muslimanë janë dërguar në spitalin Abbasijje, në Egjipt, ku u kanë hequr sytë dhe u kanë prerë duart e këmbët. Të gjithë pengjet i zhveshën si i kishte lindur nëna dhe i

çuan përpara komandantit Anglez. Njëri nga pengjet Abdullah hoxha iu lut shumë komandantit që të paktën t'i lejonte pengjet të mbulonin vendet e turpshme, por komandanti nuk e pranoi këtë gjë dhe u tall me të dhe me të gjithë pengjet e tjerë. Bashkë me ne të burgosur ishin edhe prijësi i Jafës, Omer Bajtar, prijësi i Akkas, Esad Shakir, shumë dijetarë si edhe anëtarë i parlamentit të Nablusit Sejjedin Efendi. Masakrat e shekujve të kaluar dhe masakrat e Engizicionit nuk ishin asgjë përpara masakrave që na bënë Anglezët ne. Anglezët na bënë ne torturat dhe poshtërimet që nuk mund t'i bëjë asnjë popull tjetër,”

Në vitin 1893 misjonerët i shpërndanë pupullit Armen 3 milion Bibla dhe 4 miljon libra të tjerë të fesë së krishtere, sipas kësaj, po të numërohen edhe fëmijët e sapolindur, i bie që të jenë shpërndarë 7 libra për çdo Armen. Vetëm qeveria Amerikane shpenzonte 285 000 dollarë në vit për këto.

Nuk është logjike që të mendojmë se misionerët shpenzonin shuma kaq të mëdha parash vetëm për të përhapur fenë, sepse për misionerët feja është një lloj tregëtie. Misionerët që punonin me të gjitha mundësitë për të shkatërruar Islamin e perandorinë Osmane, duke përdorur propogandën “Osmanllinjtë po vrasin Armenët, duhet t'i ndihmojmë ato”, kanë mbledhur qindra fishin e parave të shpenzuara.

Pjesa e Tretë

PERMBLEDHJE

Jusuf Nebhani “rrahmetullahi alejh”^[1] në përmbledhjen e këtij libri shkruan:

Falenderimet i takojnë Allahut! Atë që dëshiron Ai e çon në rrugë të drejtë dhe atë që dëshiron e len në errësirë. [Atyre që dëshirojnë të shpëtojnë nga errësira dhe të fitojnë lumturinë e pafund ua pranon duatë me drejtësi.] Paqa dhe mëshira e Allahut qofshin mbi pejgamberin dhe njeriun më të lartë Muhammedin “alejhis-selam”! Gjithashtu u bëjmë dua edhe familjes dhe eshabëve të Tij, të cilët ndriçojnë në tokë, si yjet në qiell.

Faqet e këtij libri janë të pakta, por dituritë që bejnë pjesë në të janë shumë të mëdha. Njerëzit e ditur dhe të mençur po t'i lexojnë këto me ndërgjegje të pastër i besojnë se janë të drejta. Ata që me dëshirën e Allahut e kanë gjetur rrugën e drejtë i kuptojnë menjëherë këto. Ky libër i vogël na bën të dallojmë rrugën e drejtë që të çon drejt shpëtimit të Allahut, nga rruga e errësirës. Kësaj përmbledhjeje po i vendos emrin “Përmbledhja e fjalëve që të ndihmojnë të zgjedhësh fenë Islame”.

O njeri që dëshiron ta shpëtosh veten tënde nga mundimet e përrjetshme dhe dëshiron të fitosh të mirat e pafund! Për të kuptuar këtë të vërtetë kaq të rëndësishme dhe për të gjetur rrugën që të shpëtosh nga dënimi i pafund, edhe sikur të mendosh gjithë kohën, të kërkosh në çdo vend, të punosh me të gjitha forcat e tua për këtë gjë, të kërkosh ndihmë nga të gjithë njerëzit e tjerë, të gjitha këto mundime janë shumë të vogëla në krahasim me rëndësinë e rrugës që të çon në shpëtim. Këto mundime në krahasim me rëndësinë e rrugës së drejtë, është njëlloj sikur të japësh një thërmije rërë në këmbim të të gjitha pasurive të botës. Vlerat e rrugës së drejtë nuk mund të shpjegohen dot në këtë përmbledhje të vogël, por kjo përmbledhje vlen si shenjë për ata që përdorin logjikën. Ata që janë të mençur nga një shenjë e vogël kuptojnë gjëra të mëdha. Më poshtë do të mundohem të shkruaj disa gjëra për ta shpjeguar më mirë këtë:

Njeriut i pëlqejnë gjërat që është mësuar të bëjë. Asnjëherë

[1] Jusuf Nebhani vdiq në Bejrut në vitin 1932 (Hixhri 1350)

nuk dëshiron të heqë dorë prej tyre. Kur lind mësohet duke pirë qumësht. Nuk dëshiron të heqë dorë nga kjo gjë. Kur rritet mësohet me shtëpinë, lagjen, qytetin e tij. E ka shumë të vështirë të ndahet prej tyre. Më vonë mësohet me pronën e vet, me punën që bën, me familjen, me fëmijët, me fenë dhe me pikëpamjet e tij. Kurrë nuk dëshiron të heqë dorë prej tyre. Kështu dalin në pah, grupe, fise, dhe popuj të ndryshëm. Pra çdo njeri e do fenë e tij, jo sepse beson se feja e tij është feja më e drejtë, por sepse është mësuar me të. Ai njeri që është i mençur duhet ta studiojë fenë e tij dhe të gjitha fetë e tjera, të gjejë se cila është feja e vërtetë mes tyre dhe ta jetojë atë, sepse të jetosh një fe të gabuar të çon në fatkeqësi dhe dënim të pafund. O njeri, zgjohu nga gjumi i përtacisë! N.q.s thua: (Si mund ta kuptoj se cila fe është feja e vërtetë. Unë besoj se feja që jetoj dhe që jam mësuar është feja e vërtetë. Unë e dua këtë fe.), atëherë duhet të dish se (Fe, quhet t'i bindesh urdhërave dhe ndalesave që Allahu teala na i ka dërguar me anë të Pejgamberëve.) Këto urdhëra janë detyra që njerëzit kanë ndaj Allahut dhe ndaj njerëzve të tjerë.

Cila fe nga të gjitha fetë që ekzistojnë, është ajo që i shpjegon në mënyrë më të përsosur cilësitë e Allahut, mënyrat e ibadetit dhe mardhëniet midis njerëzve? Mendja është një fuqi që arrin ta dallojë të mirën nga e keqja. Prej të keqes duhet të largohesh dhe të mirën duhet ta veprosh, studimi i fesë bëhet duke studiuar mënyrën se si është shfaqur ajo fe, duke studiuar pejgamberët, es'habët, ymetin, dijetarët dhe njerëzit e shquar të asaj feje. Po të pëlqejnë këto, atëherë zgjidh atë fe! Bindju mendjes dhe jo nefsit! Nefsi të mashtron ty duke të bërë që të kesh turp nga familja, shoqëria, nga njerëzit e fesë së gabuar në të cilën je, dhe të frikësohesh prej tyre, por edhe n.q.s mund të të vijë ndonjë e keqe prej tyre, ajo e keqe nuk është asgjë në krahasim me dënimin e përjetshëm. Një njeri i cili arrin ta kuptojë mirë këtë gjë, patjetër që zgjedh fenë **Islame**, dhe i beson pejgamberit të fundit Muhammedit “alejhisselam”. Në thelb feja Islame urdhëron që t'i besosh të gjithë pejgamberëve. Islami bën të ditur se fetë e të gjithë pejgamberëve janë hak, por me ardhjen e çdo pejgamberi ligjet e fesë të pejgamberit të mëparshëm dalin nga veprimi dhe veprohet vetëm sipas ligjeve të pejgamberit të asaj kohe, gjithashtu edhe me ardhjen e Pejgamberit të fundit Muhammedit “alejhisselam” ligjet e feve të tjera nuk aplikohen më, por ekzistojnë vetëm ligjet e fesë Islame. Për nefsën është një gjë shumë e vështirë që një njeri ta kuptojë se feja që ka jetuar që i vogël është e gabuar dhe pasi ta kuptojë këtë ta braktisë fenë e tij dhe t'i besojë Muhammedit

“alejhis-selam” . Kjo ndodh, sepse nefsi është krijuar si armik i Allahut, Muhammedit “alejhis-selam” dhe fesë së tij. Kjo armiqësi e nefsit quhet **(rob i injorancës)**. Prindërit, shoqëria dhe dijetarët e feve të gabuara [radiot, televizionet, gazetat dhe njerëzit e shtetit] e forcojnë akoma më shumë këtë armiqësi. Për këtë kanë thënë se t'i mësosh diçka një fëmije është si të shkruash diçka në shkëmb. Për ta zhdukur këtë armiqësi të nefsit duhet një punë shumë e madhe, duhet të bësh xhihad me nefsin dhe të bindësh mendjen duke përdorur argumente logjike. Po t'a lexosh me kujdes shkrimin më poshtë do të të ndihmojë shumë në këtë xhihad:

Njeriu i beson një feje për të arritur lumturinë e përrjetshme dhe për të shpëtuar nga fatkeqësitë e pafund. Nuk është diçka që njerëzit të mburren me fenë e prindërve të tyre. Pejgamberi është një njeri i cili i ka të gjitha cilësitë që duhet të ketë një Pejgamber dhe që i shpall njerëzve ligjet e Allahut. Një pejgamberi të tillë duhet që t'i besosh dhe t'i bindesh fesë së tij. Ata që i besojnë putave, statujave, e gjërave të tjera si këto, si edhe ata që nuk i besojnë asgjëje [ateistët, masonët, komunistët] janë njëlloj si kafshët. Feja e Krishtere dhe Çifute janë bërë fe të gabuara për arsyt e mëposhtme:

Në fenë Islame ekzistojnë cilësitë e përsosura të Allahut teala, Allahu nuk ka mangësira. Është shumë e lehtë të bësh ibadetet e kësaj feje. Mardhëniet midis njerëzve janë ndërtuar mbi bazën e drejtësisë. Ndërsa në fetë e tjera mënyra e ibadeteve dhe marrëdhëniet midis njerëzve janë ndryshuar me kalimin e kohës dhe nuk përshtaten më me logjikën njerëzore.

Po të studioni jetët e Muhammedit, Isait dhe Musait “alejhimus-selam” do të vini re se ndër to Muhammedi “alejhis-selam” është më i pastri, më fisniku, më i miri, më i dituri, më i mençuri, më i larti dhe ai që i njihte më mirë dituritë e kësaj bote dhe të ahiretit. Në një kohë që Ai ishte analfabet, pra nuk kishte lexuar asnjë libër e nuk kishte mësuar asgjë nga njerëzit e tjerë.

Mrekullitë e Muhammedit “alejhis-selam” kanë qenë shumë më tepër se mrekullitë e të gjithë pejgamberëve të tjerë sëbashku. Mrekullitë e pejgamberëve të tjerë kanë mbaruar dhe nuk ekzistojnë më, ndërsa një pjesë e mrekullive të Muhammedit “alejhis-selam” , sidomos mrekullia e Kur'anit kerim, do të vazhdojnë deri në ditën e kijametit. Mrekullitë e ymetit dhe të evlijave të tij shihen gjithmonë dhe kudo.

Ndërmjet burimeve që na tregojnë për këto tre fe, burimet e fesë së Muhammedit “alejhis-selam” , Kur'ani dhe hadithet, janë në numër më të madh dhe më të sakta se burimet e feve të tjera.

Të gjitha dituritë rreth fesë Islame janë shkruar nëpër libra dhe janë përhapur në të gjithë botën. Kur Muhammedi “alejhis-selam” arriti moshën 40 vjeçare iu shpall se ishte zgjedhur pejgamber. Muhammedi “alejhis-selam” u nda nga kjo jetë në moshën 63 vjeçare. Pra jetoi 23 vjet si pejgamber. Ai u nda nga kjo botë kur i gjithë gadishulli Arabik iu bind atij, kur feja e tij u përhap dhe u kuptua në çdo vend, kur ftesa e tij për në rrugë të drejtë u dëgjua kudo nga lindja në perëndim dhe kur numri i sahabeve të tij arriti 150 mijë. Haxhin e lamtumirës e bëri sëbashku me 120 mijë sahabe. 80 ditë pas këtij haxhi u nda nga kjo botë. Në këtë haxh zbriti edhe ajeti i tretë i sures Maide **“Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova dhuntinë time ndaj jush, zgjodha për ju fenë Islame”**. Të gjithë sahabet e tij ishin besnikë dhe të drejtë, shumica e tyre ishin dijetarë të mëdhenj të fesë dhe që të gjithë ishin evlija. Këto e përhapën fenë dhe mrekullitë e Resulullahut në mbarë botën, sepse u përhapën në çdo vend të botës për të bërë xhihad. Në vendet që shkonin u tregonin njerëzve për fenë dhe për mrekullitë e Resulullahut. Njerëzit që i dëgjonin dhe i besonin këto më pas ua tregonin njerëzve të tjerë. Në këtë mënyrë dijetarët e çdo shekulli edukuan më shumë dijetarë të brezave të ardhshëm. Këto dijetarë i mblodhën dituritë e tyre nëpër libra. I ndanë hadithet sherif që mësuan në disa grupe si sahih, hasen etj. Në asnjë mënyrë nuk kanë futur në librat e tyre hadithe të rreme të shpikura nga gënjeshtarët [Çifutët]. Janë treguar shumë të kujdesshëm dhe të matur mbi këtë çështje. Me anë të përpjekjeve të tyre feja Islame u ndërtua mbi themele të sigurt dhe u përhap pa iu bërë as edhe një ndryshim. Asnjë nga fetë e tjera nuk ka arritur të transmetohet dot në një mënyrë kaq korrekte dhe të sigurtë si feja Islame.

Në fenë tonë janë treguar qartë dhe pa asnjë ndryshim, mrekullitë e Pejgamberit tonë të dashur, Muhamedit “alejhis-selam” , argumentet se Ai është Pejgamber i vërtetë, dituritë themelore dhe të domosdoshme të fesë, ekzistenca e Allahut, se Allahu është Një i vetëm, të gjitha cilësitë e përsosura të Tij, se Muhammedi “alejhis-selam” është pejgamber, është i drejtë, besnik dhe është më i larti i të gjithë pejgamberëve të tjerë, se njerëzit do të ringjallen përsëri pas vdekjes dhe do të merren në pyetje, është treguar ura e Siratit, të mirat e Xhenetit, torturat e Xhehenemit, është treguar se është obligim falja e 5 kohëve të namazit, yleja, ikindia dhe jacia janë 4 rekatë ndërsa sabahu është 2 rekatë dhe akshami është 3 rekatë, kur të dallohet në qiell hëna e Ramazanit është farz të fillosh agjërimin, kur të duket në

qiell hëna e Shevalit bëhet bajram dhe është farz të shkosh të paktën një herë në jetë në haxh, [është haram që vajzat të dalin jashtë të zbuluara] zinaja dhe alkooli janë haram [haram është edhe përdorimi qoftë edhe një pikë e atyre pijeve alkoolike që të dehin po të pish shumë] është haram që një person xhunup ose një vajzë gjatë të përmuajshmeve të falë namaz, të gjitha këto dhe dituri të tjera të domosdoshme si këto janë përcjellë deri tek ne të sakta dhe pa asnjë ndryshim. Këtë gjë arrijnë ta kuptojnë edhe ato të Krishterë dhe Çifutë të ndërgjegjshëm e që përdorin logjikën. Vetë këto e pranojnë se rruga që është përcjellë feja e tyre nuk është kaq e besueshme dhe e sigurtë sa rruga që është përcjellë feja Islame. Profeti Muhammed “alejhis-selam” ka jetuar në një kohë më të afërt se pejgamberët e tjerë dhe dijetarët e Tij janë të shumtë në numër, kjo gjë ka penguar që në Islam të përzihen besime të kota dhe t’i bëhen shtesa fesë. Feja e krishtere dhe ajo Çifute nuk i kanë patur këto dy gjëra që e kanë ndihmuar fenë Islame që të qëndrojë e pandryshuar, sipas historianëve Muhammedi “alejhis-selam” ka jetuar rreth 600 vjet pas Isait “alejhis-selam”. Historianët mendojnë kështu, sepse thonë që shpërngulja e Muhammedit “alejhis-selam” nga Meka në Medine ka ndodhur 621 vjet pas lindjes së Isait “alejhis-selam” [Por sipas dijetarëve Islamë Muhammedi “alejhis-selam” ka jetuar 1000 vjet pas Isait “alejhis-selam”]. Gjatë kësaj kohe kaq të madhe në të gjithë botën u përhap injoranca. U bë shumë e vështirë të dalloheshin ligjet e vërteta të fesë nga ato të trilluarat.

Isai “alejhis-selam” jetoi vetëm një kohë të shkurtër si pejgamber. Kur ishte në moshën 33 vjeçare dhe kishte vetëm tre vjet që ishte shpallur pejgamber, Allahu teala e ngriti atë në qiell. Gjatë kohës së shkurtër që ishte pejgamber ishte i pafuqishëm ndaj kafirëve. Nuk e linin të qetë të bënte detyrën si pejgamber. Gjithashtu edhe Çifutët bashkë me qeverinë e Romës e pengonin. Ndihmësit e tij të cilët quheshin Havari ishin të pakët në numër. Havaritë që i kishin besuar atij ishin vetëm 12 gjuetarë. Të gjithë këto ishin njerëz të pafuqishëm. Pas ngritjes së Isait “alejhis-selam” në qiell, ditoritë dhe thëniat e tij u mblodhën dhe u shkruan në librat e Ungjillit, më pas këto libra iu shpërndanë njerëzve të paditur. Këto libra pësuan shumë ndryshime kur u përkthyen në gjuhë të ndryshme. Tek këto Ungjillë ka shumë gjëra që nuk përputhen me Ungjillët e tjerë dhe nuk i përshkruajnë logjikës. Bile gjërat që shkruhen aty shpeshherë përgënjeshtrojnë shkrimet e Ungjillëve të tjerë. Kjo gjë ndodh edhe në botimet e

ndryshme të të njejtit Ungjill, ku vihen re ndryshime dhe mospërputhje, si pasoje e këtyre ndryshimeve të mëdha priftërinjtë janë detyruar që të mblidhen çdo shekull për të korigjuar Ungjillët, gjatë korigjimeve kanë bërë ndryshime, shtesa, shkurtime dhe kanë futur brënda gjëra që nuk kanë të bëjnë fare me fenë. Më pas i kanë detyruar njerëzit që t'u besojnë këtyre librave, shumica e këtyre shkrimeve nuk janë fjalët e Isait “alejhis-selam” dhe të Havarive të tij. Për këtë arsye janë ndarë në sekte të ndryshme. Në çdo shekull kanë dalë në pah sekte të rinj shumica e sekteve të rinj janë ndarë nga sektet e mëparshme. Të gjithë këto e dinë se Ungjilli që i besojnë nuk është libri i vërtetë që i ka zbritur Isait “alejhis-selam” .

Po kështu janë edhe librat e Çifutëve të cilët tregojnë mrekullitë dhe fenë e Musait “alejhis-selam” . Këtu ndryshimi i kohës është akoma më i madh, sipas një thënieje Musai “alejhis-selam” është ndarë nga kjo jetë 2348 vjet përpara shpërnguljes së Muhammedit “alejhis-selam”. Gjatë këtyre shekujve të injorancës u bë e pamundur që feja e Musait “alejhis-selam” të përcillej e saktë dhe pa ndryshime. Tiranë të tillë si Bahtun-nasar kanë vrarë shumicën e dijetarëve të fesë së Musait “alejhis-selam” . Po ky një pjesë të dijetarëve të cilët nuk i vrau i dërgoi robër në qytetin e Babilonisë. Ka patur edhe kohë të tilla në të cilat në Kudus nuk ka patur as edhe një person që të lexonte Teuratin. Megjithëse Danjalli “alejhis-selam” bëri të mundur që njerëzit ta mësonin përmendësh Teuratin e ta shkruanin atë nëpër libra dhe e mbroi atë për një kohë nga ndryshimet, pas vdekjes së tij librat që kishte shkruar ky nuk i shpëtuan dot ndryshimit të njerëzve. Në këto libra u përzien shumë shkrime të shëmtuara që nuk i shkojnë për shtat Allahut teala dhe Pejgamberëve të Tij.

Të gjithë popujt e dinë se pas largimit të Muhammedit “alejhis-selam” nga kjo botë, në ymetin e Tij nuk është përhapur injoranca. Tek muslimanët dituria është lartësuar, janë krijuar shtete të mëdha e të fuqishme Islame të cilat kanë përhapur në çdo vend të botës diturinë, shkencën, drejtësinë dhe të drejtat e njerëzve. Tani një njeri i mençur dhe i ndërgjegjshëm i cili i studion të tre këto fe, patjetër që i beson fesë Islame, sepse qëllimi këtu është që të gjeshe dhe të besosh fenë e vërtetë të Allahut. Gënjeshtra dhe shpifja janë haram në fenë Islame. Ajetet kerime dhe Hadithet sherif i kanë ndaluar me rreptësi të dyja këto. Kur është gjynah i madh të shpifësh për një njeri të zakonshëm, atëherë të shpifësh për Pejgamberin është një gjë shumë më e keqe dhe haram shumë më i madh. Për këtë arsye në librat që flasin për Muhammedin

“alejhis-selam” dhe për mrekullitë e tij, nuk ka mundësi që të ketë gënjeshtër, gabime dhe shpifje. Një njeri i mençur po të jetë i ndërgjegjshëm duhet ta braktisë menjëherë fenë që të çon në shkatërrim dhe të besojë e të veprojë fenë që të çon në shpëtim. Jeta e kësaj bote është shumë e shkurtër. Çdo ditë që kalon nuk kthehet më e na afron më shumë me vdekjen. Të gjithë njerëzit janë të vdekshëm dhe të gjithë do të vdesin një ditë. Pas vdekjes njerëzit i presin ose torturat e pafundme ose miresitë e përjetshme. Koha po na mbaron të gjithëve me shpejtësi.

O njeri! Ki mëshirë për veten tënde! Hiqe perden e përtacisë nga mendja! Kuptoje të gabuarën dhe largohu prej saj! Besoje të vërtetën dhe kapu fort pas saj! Vendimi që do të marrësh është shumë i madh dhe ka një rëndësi të madhe. Ndërsa koha që ke në dispozicion është shumë e shkurtër. Padyshim një ditë do të vdesësh! Mendoje kohën e vdekjes para se të jetë vonë! Përgatite vetën për gjërat që do të vijnë pas saj! Nuk ka mundësi të shpëtosh nga dënimi i pafund pa besuar dhe pa iu bindur Allahut, Krijuesit tënd! Të pendohesh në çastin e fundit nuk ka asnjë vlerë. Besimi në momentin e fundit të jetës nuk pranohet, por besimtarëve të cilët bëjnë teube për gjynahet e tyre në momentin e fundit të jetës, kjo teube u pranohet. Çfarë përgjigje do të jepni n.q.s në atë ditë Allahu ju thotë “O robi Im! Ty të dhashë mendjen. Me këtë të urdhërova që të më besosh Mua, Pejgamberit Tim dhe fesë Islame që të solla me anë të Tij. Për ardhjen e këtij pejgamberi të pata lajmëruar edhe me anë të Teuratit edhe me anë të Ungjillit. Emrin dhe fenë e Tij e përhapa në çdo vend të botës. Nuk mund të thuash që nuk kam dëgjuar për të. Ditë e natë punove për të grumbulluar mall dhe për të plotësuar qejfet e kësaj bote. Jetoje në harresë dhe re në kthetrat e vdekjes.”

O njeri! Mendoji ato që do të të ndodhin! Mblidhe mendjen përpara së të të vijë fundi! Të gjithë njerëzit që kishe përrtheth, njerëz që i doje, i respektoje, që i kishe frikë, të gjithë vdiqën një e nga një. Ikën aq shpejt sa hap e mbyll sytë. Mendohu mirë! Sa torturë e frikshme është të digjesh në zjarr në pafundësi! Po në të njëjtën kohë sa mirësi e madhe është të jetosh përgjithmonë në të mirat e Xhenetit. Tani o njeri e ke vetë në dorë të zgjedhësh një nga këto të dyja. Patjetër që fundi i çdo njeriu është vetëm një nga këto të dyja. Është e pamundur që t'i shmangesh këtij fundi. Të mos e mendosh këtë gjë dhe të mos marrësh masa është injorancë dhe marrëzi e madhe. Allahu na bëftë të gjithëve nga ata njerëz që të përdorim logjikën! Amin.

Në librin “**Kavl-us-sebt fi redd-i ala deavil-protestanet**” thuhet: i nderuari Allame Rrahmetullah^[1] në librin e tij “**Izhar-ul-hak**” shkruan: Përpara se të vinte Islami asgjëkund nuk gjendej Teurat ose Ungjill i vërtetë. Ato që qarkullojnë tani në botë janë libra historie në të cilët janë përzier të vërtetat me gënjeshtër e trillime. Teurati dhe Ungjilli që përmenden në Kur’anin kerim nuk janë librat e sotëm të cilët quhen Teurat dhe Ungjill. Tek këto libra janë të vërteta vetëm ato pjesë që janë në përputhje me Kur’anin, pjesët që e kundërshtojnë Kur’anin nuk janë të vërteta, janë trillime. Nuk mund të themi të drejta ose të gabuara për ato gjëra të cilat nuk janë cilësuar në Kur’anin kerim. Nuk ka ndonjë argument që të vërtetojë se katër Ungjillët janë fjala e Allahut. Këtë gjë e ka pranuar edhe prifti Anglez që predikonte në Angli, gjithashtu ka thënë edhe se këto argumente kanë humbur që në vitin 313 ku në botë ndodhën trazira dhe mosmarrëveshje të mëdha mes njerëzve. Në vëllimin e dytë të komentit të Ungjillit të shkruar nga Horni, në faqen e 65 të librit të historisë të shkruar nga historiani Mocheim dhe të botuar në vitin 1913^[2] dhe në faqen 124 të vëllimit të pestë të komentit të Ungjillit të autorit Lardis, Shkruhet se Ungjillëve iu janë bërë shtesa dhe ndryshime. Cirum^[3] ka thënë: “Gjatë përkthimit të Ungjillit, vura re se nuk ngjasonin me njëri-tjetrin”. Adam Clarke^[4] në vëllimin e parë të komentit të tij shkruan: “Ungjilli gjatë përkthimit në gjuhën Latine ka pësuar shumë ndryshime. I janë bërë shtesa që nuk përputhen me njëra-tjetrën. Katoliku Ward^[5] në faqen e 18^{të} të librit të tij të botuar në 1841 shkruan: “Ateistët e Lindjes kanë ndryshuar shumë vende të Ungjillit. Në raportin që priftërinjtë Protestantë i dhanë mbretit James i parë thuhet Zeburët në librin tonë të duave nuk ngjasojnë me origjinalin në gjuhën Hebreje. Ka rreth 200 shtesa, mangësira

[1] Rrahmetullah Hindi vdiq në Mekke në vitin 1889 (Hixhri 1306)

[2] Mocheim Johann Lorenz Von, prift protestant dhe historian i shquar. Lindi në Lübeck në vitin 1694 dhe vdiq në Goffinden në vitin 1755. Vepra e tij më e famshme është “Ungjilli i shenjtë”

[3] Cirum Jerome Saint, ka jetuar tre vjet në Stamboll. Në vitin 382 shkoi në Rumani. U bë sekretar i Papës. Ka përkthyer Librin e shenjtë, Ungjillin në Latinisht. Data 30 Gusht bëhet festë për nder të tij. Ungjilli i përkthyer prej tij u bë Ungjilli zyrtar i kishës.

[4] Adam Clarke 1760-1832, predikues i Ungjillit, Irlandez. Një nga shkrimet më të njohura është Komenti i Librit të shenjtë.

[5] Ward William George 1812-1882, prift i famshëm Katolik, Anglez. Vepra e tij më e famshme është “**Ideali i kishës Krishtere**”]

dhe ndryshime të tjera”. Priftërinjtë protestantë i shtuan akoma edhe më tepër këto ndryshime. Me këto i përfundoi fjalët e tij i nderuari Rrahmetullah. Në librin **“Izhar-ul-hak”** përmenden edhe shumë ndryshime të tjera të bëra në këto Ungjillë.

Të gjithë priftërinjtë e dinë se Isai “alejhis-selam” nuk ka shkruar asgjë, nuk ka urdhëruar askënd që të shkruajë dhe nuk ka lënë asgjë të shkruar. Nuk e ka predikuar fenë e tij duke e shkruar atë. Pas ngjitjes së tij në qiell pasuesit e Isait “alejhis-selam” ranë në mosmarrëveshje mes tyre. Nuk u bashkuan që t’i mblidhnin në një vend ligjet e fesë së tyre. Më pas shkruan më tepër se 50 Ungjillë të ndryshëm. Nga këto u zgjodhën vetëm katër Ungjillë. 8 ose 12 vjet pas Isat “alejhis-selam” u shkrua në Palestinë në gjuhën Surjani Ungjilli i **Mateut**. Ky shkrim nuk ekziston, ekziston vetëm përkthimi i tij në gjuhën Greke. Ungjilli i **Markut** u shkrua në Romë 30 vjet më vonë. Ungjilli i **Lukës** u shkrua 28 vjet më vonë në Kajro, në gjuhën Greke. Ungjilli i **Johanit** u shkruajt në qytetin e Efesit 38 ose 65 vjet më vonë. Në të gjithë këto libra shkruhen thënie, histori dhe disa ngjarje të ndodhura disa vjet pas Isait “alejhis-selam”. Luka dhe Marku nuk janë nga Havaritë e Isait “alejhis-selam”. Në librat e tyre kanë shkruar gjëra që kanë dëgjuar nga të tjerët. Autorët e këtyre të katër librave, librave të tyre nuk u kanë vendosur emrin Ungjill. I quajten librat e tyre libra historie. Më vonë njerëzit që i përkthyen këto libra në gjuhë të tjera i quajten përkthimet e tyre Ungjill.

Në librin e botuar në gjuhën Turke **“Izah-ul meram”** thuhet:

Unjilli i vërtetë ishte në gjuhën Hebreje dhe kur Çifutët kapën Isain “alejhis-selam” për ta ekzekutuar, zhdukën edhe këtë libër. Gjatë kohës tre vjeçare që Isai “alejhis-selam” jetoi si pejgamber, një pjesë e këtij libri nuk ishte shkruar. Të krishterët e mohojnë Ungjillin e vërtetë. Në të katër ungjillët e sotëm që përdorin të Krishterët nuk bëhet fjalë fare për asnjë ibadet (adhurim). Në to shkruhen vetëm mosmarrëveshjet që ka patur Isai “alejhis-selam” me Çifutët. Në një kohë që libër feje quhet ai libër që shpjegon ibadetet. N.q.s thonë se ibadetet i bëjnë sipas Teuratit, atëherë përse nuk i bëjnë ato ibadete që urdhëron Teurati, si dhënia rëndësi ditës së Shtunë, bërja synet, bërja e lutjeve në këmbë çdo mëngjes dhe mbrëmje, agjërimi në ditë të caktuara, dhënja e të drejtës së ndarjes grave dhe mos përdorimi i mishit të derrit. Në librat e tyre nuk ka asnjë lajm që thotë se nuk duhet t’i binden urdhërave të Teuratit. Ndërsa në Kur’anin kerim zënë një vend të madh ibadetet, edukata e mirë, ligjet, tregëtia, bujqësia si edhe

nxitja për të mësuar dritën.

Megjithëse shumë poetë, shkrimtarë, letrarë e kafirë të shumtë kanë 1400 vjet që mundohen nuk kanë arritur të shkruajnë dot asgjë të ngjashme me asnjë nga ajetet e Kur'anit kerim. Fjalët e Kur'anit janë në gjuhën Arabe dhe përdoren në gjuhën e përditshme, por megjithatë asnjë nuk mund të formojë po me këto fjalë diçka të ngjashme me ajetet e Kur'anit kerim. Kjo është një shenjë e qartë se Kur'ani kerim është një mrekulli. Mrekullitë e tjera të Muhammedit “alejhis-selam”, kanë mbaruar, u ka mbetur vetëm emri, ndërsa Kur'ani kerim do të vazhdojë të ndriçojë si dielli në çdo vend dhe në çdo kohë. Do të vazhdojë të jetë shërim dhe rrugëzgjdhje për çdo sëmundje dhe çdo problem. Allahu teala e ka zbritur atë për t'ia dhuruar robët të Tij të dashur Muhammedit “alejhis-selam” dhe për të lumturuar krijesat e Tij. Me dëshirën dhe mëshirën e pafund të Allahut ky libër do të mbrohet i paprekur dhe i pandryshuar deri në pafundësi. Allahu nuk e ka dhënë një garanci të tillë edhe për librat e tjerë hyjnorë. [Allahu teala Kur'anin kerim ia zbriti Pejgamberit të tij Muhammedit “alejhis-selam” me anë të engjëllit Xhebrail, në 23 vjet. Halifeja e parë Ebu Bekri “radijallahu anh” i mblodhi këto ajete të zbritura nga Allahu, në një libër. Kështu doli në pah një libër i madh i quajtur **Mus'haf**. 30 mijë sahabë e vërtetuan të gjithë se ky libër ishte i njëjti me ato që i kishin zbritur Muhammedit “alejhis-selam”. Në faqen 375'të të librit “**Rijad-un-nasihin**” shkruahet: “Kur'ani kerim ka 6236 ajete”. Disa ajete të gjatë ndahen në ajete më të vogla dhe kështu numri i ajeteve rritet. Për këtë arsye ka edhe mushafë me 6666 ajete. Muhammedi “alejhis-selam” i'a ka shpjeguar sahabëve të tij çdo ajet të Kur'anit. Dijetarët e Islamit i mësuan këto nga sahabët dhe i shkruan nëpër libra të shumtë. U shkruan shumë libra me komente të Kur'anit dhe u përhapën anembanë botës. Të gjithë Kur'anët që qarkullojnë sot në të gjithë botën janë të njëjtë me njëri-tjetrin. Në mes tyre nuk ndryshon as një pikë, asnjë shkronjë.]

Fetë e të gjithë pejgamberëve ngaqë kanë qenë për popuj të ndryshëm dhe për kohë të ndryshme kanë qenë të ndryshme nga njëra-tjetra, por thelbet e besimit kanë qenë të njëjta tek të gjitha fetë. Tek të gjitha fetë thuhet se Allahu është një dhe se pas vdekjes vjen ringjallja. Në pjesën e katërt të Tesnijes thuhet “Zotëruesi i qiejve dhe i botërave është një, nuk ka tjetër” në pjesën e gjashtë thuhet “O Izrael dëgjo! Allahu jonë, Krijuesi jonë është një” në “Sifrul Mukadesi thalith” shkruhet se Sulejmani

“alejhis-selam” gjatë ndërtimit të mesxhidit Aksa në Kudus ka thënë: “O Allahu i Izraelit! Në tokë dhe në qiej nuk ka Zot si ty. Ty nuk të nxë dot e gjithë Toka dhe qiejt, e jo më kjo shtëpi që po ndërtoj unë.” Në “Sifrul Mukadesi evel” në ajetin e 29 të pjesës së 15 të **Samoilit** shkruhet se Pejgamberi **Samoil** ka thënë: “Zoti, Krijuesi i Izraelit nuk thotë gënjeshtër dhe nuk pendohet, sepse Ai nuk është njëri”. Në pjesën e 45’të të librit **Eshija** që thuhet se i përket një Pejgamberi shkruhet: “Unë jam Krijuesi! Nuk ka Allah tjetër përveç meje! Unë kam krijuar të mirën dhe të keqen” Në pjesën e 19 të Ungjillit të Mateut shkruhet: “Një njeri i tha atij, o dijetar i mirë! Çfarë vepre të mirë të bëj që të fitoj jetën e pafund? U përgjigj përse më thua, i mirë? Nuk ka tjetër të mirë përveç atij që është një. Ai është Allahu. N.q.s do të fitosh jetën e pafund ndiq këshillat e Tij!” Në pjesën e 12 të librit të Markut shkruhet: “Njëri nga shkruesit pyeti, çfarë është urdhëri i parë? Isai “alejhis-selam” i’u përgjigj. Urdhëri i parë është, Allahu është një. Dua je Krijuesin tënd me të gjithë zemrën dhe të gjithë fuqinë tënde”. Edhe Muhammedi “alejhis-selam” po kështu ka thënë.

Ai që nuk i beson Muhammedit “alejhis-selam” nuk i ka besuar asnjërit prej pejgamberëve.

Besimi i Trinisë (**Ekanimi thelathe**) (besimi në tre zota), i përgënjeshtrohet që të gjithë pejgamberët. Ky besim në tre zota (trinia) është shfaqur shumë kohë pas ngjitjes së Isait “alejhis-selam” në qiell. Përpara kësaj të krishterët besonin tek një Zot i vetëm dhe zbatonin ligjet e Teuratit, por me futjen e shumicës së besimtarëve të putave dhe i filozofëve Grekë, në fenë e Krishtere, në këtë fe u fut besimi në tre zota. Në librin “**Kurretun-nufus**” të botuar në gjuhën franceze e më pas të përkthyer në Arabisht thuhet se besimi në tre zota është shfaqur në vitin 200 nga një prift me emrin Seblis, dhe për këtë është derdhur shumë gjak. Në atë kohë shumë dijetarë e mbrojtën besimin tek një Zot i vetëm dhe thanë se Isai “alejhis-selam” ishte pejgamber dhe një njeri si gjithë të tjerët. Në vitin 300 Arjus, në Aleksandri vërtetoi dhe u bëri të ditur njerëzve se ekziston vetëm një Zot dhe se besimi në tre zota është i gabuar. Në vitin 325 Kostandini në mbledhjen e priftërinjve të mbajtur në Iznik ndaloi besimin në një zot të vetëm dhe e nxorri nga feja Arjusin. As vetë nuk e dinë se çfarë kuptimi ka “ruhul kuds” “fryma e shenjtë” që e quajnë si zotin e tretë. Thonë se shtatëzania e Merjemes, nënës së Isait “alejhis-selam”, ka ardhur nga kjo frymë e shenjtë.

Shemseddin Sami bej (Sami Frashëri) në librin e tij “**Kamus-ul-**

a'lam” të botuar në vitin 1898, shkruan: “Pejgamberi i fesë Islame është Muhammedi “alejhis-selam”. Babai i tij është Abdullahi, gjyshi është Abdulmuttalib bin Hashim bin Abdi Menaf bin Kusaj bin Kilab, sipas historianëve ka lindur në qytetin e Mekkes në mëngjesin e 20 Prillit të vitit 571, ditë që përkon me ditën e 12 të muajit Rebiul Evvel. Nëna e tij ishte Emineja, nëna e saj ishte Vehibe dhe babai Abdi Menaf bin Zuhre bin Kilab. Kilab është stërgjyshi i Abdullahut, babait të Pejgamberit. Abdullahu shkoi për tregëti në Damask dhe në kthim vdiq në **Dar-un-nabiga**, në afërsi të Medines. Kur vdiq ishte në moshën 25 vjeçare dhe nuk arriti ta shihte dot djalin e tij. Pejgamberi pas lindjes jetoi 5 vjet tek fisi i Halimesë, nënës së tij të qumështit. Ky ishte fisi që e fliste më mirë gjuhën Arabe. Për këtë arsye Muhammedi “alejhis-selam” fliste shumë qartë. Në moshën gjashtë vjeçare Emineja e çoi djalin e saj tek dajat dhe aty vdiq. Dadoja e tij Ummi Ejmen e dërgoi atë në Mekë dhe ia dorëzoi gjyshit të tij Abdulmuttalibit. Në moshën 8 vjeçare i vdiq edhe gjyshi dhe kështu shkoi të jetonte tek xhaxhai i tij Ebu Talibi. Në moshën 12 vjeçare shkoi me xhaxhain e tij Ebu Talibin në Damask, për të bërë tregëti. Në moshën 17 vjeçare xhaxhai i tij Zuberi e mori me vete në Jemen. Në moshën 25 vjeçare shkoi për tregëti në Damask me karvanin e Hatixhes “Radijallahu anha”. U bë i dëgjuar me zgjuarsinë, edukatën, moralin, shkathtësinë dhe dëshirën e tij për të punuar. Dy muaj më pas u martua me Hatixhenë. Në moshën 40 vjeçare iu shfaq engjëlli me emrin Xhebrail dhe i shpalli se ishte zgjedhur Pejgamber. Në fillim i besoi Hatixheja më pas Ebu Bekri dhe Aliu bashkë me Zejd bin Harise, të cilët ishin akoma fëmijë. Në moshën 43 vjeçare u urdhërua për të thërritur të gjithë popullin në besim. Mushrikët (njerëzit që adhurojnë shumë zota) i dolën kundra dhe i nxorrën shumë pengesa e mundime. Në moshën 53 vjeçare me lejen e Allahut u shpërngul në Medine-i Muneverre. Në 20 Shtator të vitit 622, ditë që përkon me ditën e 8 të muajit Rebiul Evvel, mbërriti në fshatin Kuba të Medines. Në kohën kur Halife ishte Hazreti Omeri dita e parë e muajit Muharrem, të vitit që Resulullahu u shpërngul në Medine, u pranua si dita e parë e vitit **Hixhri Kameri**. Dita e 20 e Shtatorit u caktua si dita e parë e vitit **Hixhri Shemsi**. Viti 623 është viti 1 Hixhri Shemsi dhe Hixhri Kameri. Pasi u dha urdhër për të luftuar kundra Kafirëve, në vitin e dytë pas shpërnguljes u bë **lufta e Bedrit**. Nga 950 kafirë 50 u vranë dhe 44 u morën peng. Në vitin e tretë pas shpërnguljes u bë **lufta e Uhudit**. Kafirët ishin 3000 ndërsa muslimanët 700 vetë. Në

këtë luftë ranë shehidë 75 sahabe. Në këtë vit zbritën ajetet që urdhërojnë mbulimin e grave. Në vitin e katërt të shpërnguljes u bë **lufta e Hendekut** dhe në vitin e pestë u bë **lufta e Beni Mustalakut**. Në vitin e gjashtë u bë **lufta e Hajberit** dhe në Hudejbije u arrit marrëveshja **Biat'ul-ridvan**. Në vitin e shtatë iu dërguan letra për t'i ftuar në Islam, perandorit Bizant Kajserit dhe Shahut të Iranit, Kisra. Në vitin e tetë u bë **lufta e Mutes** kundra ushtrisë Bizante të Herakliut, u mor Mekka dhe u bë **lufta e Hunejnit**. Në vitin e nëntë u bë **lufta e Tebukut**. Në vitin e dhjetë u bë **Haxhi i lamtumirës**. Në vitin e njëmbëdhjetë qëndroi 13 ditë i sëmurë me ethe dhe ditën e Hënë më 12 të Rebiul Evvelit, ndërroi jetë në moshën 63 vjeçare në dhomën e tij ngjitur me mesxhidin.

Resulullahu “Sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem” ishte gjithmonë me fytyrë të qeshur dhe fliste gjithmone me fjalë të ëmbla. Fytyra e tij ndriçonte nga nuri. Kush e shihte menjëherë ndjente dashuri për të, sjelljet e tij të mira, durimi i tij, edukata, morali e cilesi të tjera të larta të tij janë shkruar nëpër mijëra libra. Nga Hatixheja “radijallahu anha” i lindën 2 djem dhe katër vajza. Nga Maria nga Egjipti i lindi një djalë. Përveç vajzës së tij Fatimes, fëmijët e tjerë vdiqën që kur Resulullahu ishte në jetë. Me kaq përfundoi shkrimi i “**Kamus-ul-alam**”.

Imam Gazaliu në librin “**Kimja-i seadet**” shkruan: “Allahu teala i dërgoi Pejgamberë robëve të tij. Me anë të këtyre pejgamberëve Allahu u tregoi robëve të tij gjërat që bëhen shkak për të arritur lumturinë ose dënimin. Pejgamberi më i lartë dhe i fundit është **Muhammedi** “alejhis-selam”. Është Pejgamber për të gjithë njerëzit dhe për të gjithë popujt. çdo njeri në botë duhet t'i besojë dhe ti bindet Këtij Pejgamberi”

PERFUNDIM

Fe quhen ligjet e zbritura nga Allahu me anë të pejgamberëve, të cilët tregojnë gjërat që mbetet i kënaqur Allahu, ibadetet që duhen bërë dhe gjërat që duhen bërë për të fituar lumturinë në këtë botë dhe në botën tjetër. Nuk mund të quhen fe imagjinatat e krijuara nga mendjet e njerëzve. Mendja shërben për të kuptuar dhe për të vepruar urdhërat dhe ndalesat e fesë dhe për t'iu përshtatur atyre. Mendja nuk është në gjëndje që të kuptojë sekretin që fshihet pas këtyre urdhërave, ose shkakun përse janë vendosur ato. Nuk mund të krijojë një mendim të vetin në lidhje

me këto. Këto sekrete dhe arsyet e vendosjes së urdhërave, Allahu ua ka treguar pejgamberëve dhe i ka vendosur në zemrat e evlijave, ne i mësojmë këto prej tyre. Kjo gjë arrihet vetëm me dëshirën e Allahut.

Për të fituar lumturinë në këtë botë dhe në botën tjetër dhe për të fituar kënaqësinë e Allahut, duhet të bëhesh musliman. Ai që nuk është musliman quhet, **kafir**. Që të bëhesh **Musliman** duhet të **besosh** se Muhammedi “alejhis-selam” është pejgamber, dhe të bësh **ibadet**. Ibadet do të thotë që me të gjithë fjalët dhe veprat t’i përshtatesh fesë së Muhammedit “alejhis-selam”. Ibadetet nuk duhet të bëhen kurrë për të pritur ndonjë përfitim, por duhen bërë vetëm, sepse janë urdhëruar nga Allahu. **Ahkam’i Islamiye** quhen urdhërat dhe ndalesat e fesë, të cilat janë përcaktuar në Kur’anin kerim dhe Hadithet sherif, këto dituri mund të mësohen nga librat e Fikhut. Çdo musliman, mashkull apo femër e ka **farz** (obligim) të mësojë ahkami Islamiyen, pra gjërat që urdhëron Islami. Këto janë shërim për të gjitha sëmundjet trupore dhe shpirtërore. Ashtu si mësojmë vite të tëra në gjimnaze dhe universitete për të mësuar mjekësi, shkencë, tregëti etj, po ashtu duhet të shpenzojmë vite të tëra edhe për të mësuar dituritë e fikhut. Ato që nuk i mësojnë dhe nuk i dinë këto dituri mashtrohen lehtë nga agjentët anglezë dhe nga munafikt, njerëzit e shitur që hiqen si dijetarë të fesë dhe kështu bien në fatkeqësi si në këtë botë ashtu edhe në botën tjetër.

Të thuash **Kelimei shehadetin** dhe ta **besosh** atë. Ai që e thotë këtë, ia di kuptimin dhe e beson atë, quhet **Besimtar**. **Kelimei shehadeti** është “Esh’hedu el la ilahe il-lall-llah ve esh’hedu enne Muhammeden abduhu ve Resuluh”. Kuptimi “Nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe Muhammedi “alejhis-selam” është robi dhe i dërguari i Tij”. Do të thotë se Ai është pejgamberi i fundit dhe se pas Tij nuk do të vijë më pejgamber tjetër. Në librin “**Merakil felah**” në sqarimin e Tahtavit thuhet: “Nuk është e mjaftueshme vetëm të besosh se Allahu teala ekziston. Edhe kafirët që besojnë se ka edhe zota të tjerë e besojnë Zotin. Besimtarët gjithashtu duhet të besojnë edhe cilësitë [Eshtë Një, jeton, është i plotfuqishëm, di gjithçka, ...] duhet të besojnë se sheh dhe dëgjon gjithçka dhe se nuk ka krijues tjetër përveç Tij. Të besosh se Muhammedi “alejhis-selam” është **Pejgamber, Resul**, do të thotë se duhet të besosh se të gjitha fjalët që ka folur Ai kanë qenë fjalët që i’a ka mësuar Allahu. Allahu teala ia tregoi Atij **Islamin**, pra dituritë e besimit, me anë të Kur’ani kerimit. Urdhërat që janë

obligim të bëhen quhen **Farze**. Ndërsa ndalesat quhen **Haram**. Të dyja sëbashku quhen “**Ahkami Islami**”, ligjet e Islamit. Një njeri sapo të bëhet musliman e ka farz që të mësojë dituritë e Islamit. Po të mos i japë rëndësi mësimi të këtyre diturive dhe të thotë se nuk është e nevojshme që të mësohen, i humbet besimi dhe bëhet **Kafir**. Në ajetet e Kur’anit kerim dhe me anë të haditheve sherif është shpjeguar qartë se ai person që vdes si kafir nuk meriton fare falje në ahiret dhe do të digjet në pafundësi në zjarrin e xhehenemit. Kjo shpjegohet më hollësisht në letrën e 266’të në librin “**Müjdeci Mektublar**”. Ai person të cilit i humbet besimi quhet **Murtetd**. Ata që i besojnë siç duhet Kur’anit kerim dhe haditheve sherif quhen **Ehl-i synet**. Allahu teala ngaqë është shumë i Mëshirshëm nuk e ka treguar çdo gjë haptazi. Disa gjëra i ka lënë të fshehta. Ata që i besojnë Kur’anit kerim dhe haditheve sherif, por që në disa vende nuk u japin atyre kuptim ashtu si kanë rënë dakord dijetarët e Ehl-i synetit, quhen njerëz **pa Medhhe**. Prej atyre pa medhhe ato që u japin kuptim të gabuar vetëm atyre gjërave që janë lënë të fshehta, quhen **njerëz të Bid’atit**, ose muslimanë në **rrugë të gabuar**. Ata që u japin kuptim të gabuar gjërave të qarta quhen **Mulhid**. Mulhidi megjithëse e quan veten e tij musliman, në të vërtetë është kafir. Ata që bëjnë bid’at nuk janë kafirë, por patjetër që do të vuajnë dënim në xhehenem. Një nga librat me shumë vlerë që flet për rëndësinë e rrugës së ehl-i synetit dhe tregon se është me të vërtetë rruga e drejtë, është libri “**Mahzen-ul-fikh-il-kubrra**” i të nderuarit Muhammed Sulejman efendi. Kafirët të cilët maskohen si njerëz të fesë dhe duke përdorur mendjen e tyre ose shkencën, u japin kuptim të gabuar diturive të qarta, quhen **Zindik**.

Dijetarë të ndryshëm të ehl-i synetit disa gjëra që nuk janë shprehur haptazi i kanë kuptuar në mënyra të ndryshme nga njëri-tjetri. Për këtë arsye kanë dalë katër medhhebe në veprim. Këto janë **Hanefi**, **Maliki**, **Shafi** dhe **Hanbeli**. Besimi i të katër këtyre medhhebeve është i njëjtë. Kanë vetëm disa ndryshime të vogla përsa i përket ibadeteve. Janë si vëllezër me njëri-tjetrin. Çdo musliman është i lirë të zgjedhë cilindo prej këtyre dhe të veprojë sipas tij. Çdo ibadet e bën sipas medhhebit që ka zgjedhur. Ndarja e muslimanëve në katër medhhebe vjen nga mëshira e madhe e Allahut. Kjo është një mëshirë e madhe për muslimanët. Kur një musliman has ndonjë vështirësi në kryerjen e ibadetit sipas medhhebit të tij, këtë vështirësi e kapërcen duke e bërë këtë ibadet sipas një medhhebi tjetër. Kushtet që duhet të

plotësohen me qëllim që të ketë leje të bësh një veprim sipas një medhhebi tjetër janë shpjeguar hollësisht në librin **“Seadeti Ebedije”**.

Ibadeti më i rëndësishëm është namazi. Ai që fal namaz dallohet se është musliman. Për atë që nuk fal namaz është e dyshimtë është musliman apo jo. Një person që i jep rëndësi namazit por megjithëse nuk ka ndonjë arsye, nuk e fal atë nga përtacia sipas medhhebeve Maliki, Shafi dhe Hanbeli dënohet me vdekje nga gjykata. Ndërsa sipas medhhebit Hanefi burgoset derisa të vendosë të falet. Në librat **“Durr-ul-munteka”**, **“Ibni Abidin”** dhe **“Kitab-us-salat”** shkruhet: “Të braktisësh faljen e namazit pa arsye dhe të vonosh kohën e faljes, janë dy gjynahe të mëdha nga njëri-tjetri. Ai që nuk e ka falur namazin duhet ta bëjë kaza, ai që e ka falur pasi i ka kaluar koha duhet të bëjë haxh dhe teube.” Teubeja e atij që nuk e ka bërë kaza namazin nuk pranohet. Gjithashtu është e nevojshme të bëhen kaza edhe synetet që Resulullahu i ka falur vazhdimisht, në këtë mënyrë mund të shpëtojmë nga gjynahu i madh. Atij personi që ka borxhe farzesh, pra nuk i ka kryer ato, edhe po të fali synete nuk i pranohen ato, pra nuk i fiton dot sevapet dhe të mirat që ka premtuar Allahu, kjo përmendet në shumë libra të besueshëm. Këto janë shpjeguar në mënyrë të hollësishme edhe në librin **“Seadeti Ebedije”**. Të lesh pa falur namazin për shkak të arsyeve të forta nuk është gjynah, por sipas të katër medhhebeve personi sapo të ketë mundësi duhet që t'i bëjë kaza këto namaze, sipas medhhebit Hanefi është e lejuar që falja e namazit kaza të vonohet aq kohë sa personi është duke punuar për të siguruar jetesën ose sa për të falur synetet e forta ose namazet nafile që përmenden në hadithe sherif. Pra është mirë që falja e kazave të vonohet për këto arsye, por sipas tre medhhebeve të tjerë nuk është e lejuar që në vend të bëhen kaza namazet që nuk janë falur për shkak të arsyeve të forta, të falen synete të forta ose nafile, sipas këtyre tre medhhebeve kjo është haram. Nuk duhet të ngatërrohen me njëri-tjetrin namazet që nuk janë falur si shkak i arsyeve të forta, me namazet që janë lënë pa falur pa patur arsye. Në librat **“Durr-ul-muhtar”**, **“Ibni Abidin”**, **“Durr-ul-munteka”** dhe **“Merakil-felaf”** tregohet qartë se këto nuk janë e njejta gjë. [Kur fal namaz rrugës është e nevojshme të dish drejtimin e kiblës. Për të gjetur këtë ngulim një shkop në një vend ku bie drita e dillit, shohim në kalendar **“Kohën e Kiblës”**, drejtimi i kiblës është drejtimi i hijes së shkopit në orën që është koha e kiblës.]

Në faqen e kalendarit **Türkiye** të datës 13 Shtator 1996 shkruhet:

Armiqtë e Islamit herë duke përdorur forcën e herë duke përdorur lojëra politike, kanë futur në dorë shtete të ndryshme Islame dhe i kanë shfrytëzuar ato. Kanë marrë të gjitha pasuritë mbi dhe nën tokësore. Përveç kësaj si pasojë e shtypjes me kalimin e kohës filluan të humbasin edhe pasuritë shpirtërore si fenë dhe gjuhën, shteti kryesor që ka përfituar nga këto shfrytëzime është Anglia.

Kolonia më e rëndësishme e Anglisë ka qenë India. Ajo që i ka dhënë Anglisë për shumë vjet me radhë sundimin e botës kanë qenë pasuritë e pafund të Indisë. Vetëm gjatë luftës së parë botërore Anglia ka marrë nga India 1,5 milion ushtarë dhe 1 miliard Rupit.

Shumicën e këtyre pasurive i ka përdorur për të copëtuar perandorinë Osmane. Gjithashtu edhe gjatë kohës së paqes po India ka qenë ajo që e ka mbajtur në këmbë ekonominë dhe industrinë e Anglisë.

Për dy arsye India ka qenë shumë më e rëndësishme se kolonitë e tjera të Anglisë: e para, në Indi jetohej feja Islame dhe drejtohej nga muslimanët, Anglezët e shihnin Islamin si pengesa kryesore për të sunduar botën. E dyta, pasuritë natyrore të Indisë. Për të arritur të mbante nën sundim Indinë, Anglia futi përçarje dhe mosmarrëveshje tek të gjithë shtetet fqinjë me Indinë, i bëri vëllezërit armiq të njëri-tjetrit dhe i vodhi ato duke i përdorur për vete të gjitha pasuritë e tyre.

Pika kryesore e politikës së Anglisë ishte që me marifete të ndryshme të fuste perandorinë Osmane në luftë kundër Rusisë, në mënyrë të tillë që perandoria Osmane të mos kishte mundësi t'i dërgonte ndihmë Indisë.

Gjatë luftës perandori Osmane-Rusi, Anglia e shpalli Indinë pjesë të mbretërisë së saj. Masoni Mit'hat Pasha duke e futur perandorinë Osmane në luftë kundër Rusisë i ka bërë të keqen më të madhe Islamit. Edhe vrasja e **Sulltan Abdulazizit**, ka qenë komplot i Anglezëve.

Anglezët arritën të fusin në poste të larta të perandorisë Osmane njerëzit që kishin përgatitur vetë. Këto njerëz me emër ishin Osmanllinj, ndërsa me zemër dhe vepra ishin Anglezë. Njëri prej tyre Mustafa Reshid pasha në datën 28.10.1857 kur kishte vetëm gjashtë ditë që ishte bërë kryeministër uroi anglezët për

masakrën që u bënë muslimanëve të Dehlit. Po ky edhe më parë u dha leje forcave Angleze që ishin nisur të shtypnin kryengritjen e Muslimanëve në Indi, që të kalonin nga Egjipti.

Anglezët në Indi për të larguar popullin nga feja Islame mbyllën të gjitha medresetë dhe shkollat e fëmijëve. Të gjithë dijetarët që mund të bëheshin liderë në popull i vranë.

Anglezët në të gjithë shtetet muslimane që kishin në zotërim kanë bërë të njejtën gjë, kane zhdukur të gjithë librat dhe dijetarët e Islamit dhe kanë mbyllyr të gjitha medresetë e shkollat. Kanë bërë që rinia të rritet krejtësisht larg diturive të fesë.

Njerëzve që përdornin për të mbajtur nën sundim këto vende, mbanin emra muslimanë si Ahmet, Mehmet, Mustafa, Ali etj, por lidhja e tyre me fenë Islame nuk shkonte më larg se ngjasimi i emrave. Këto shtete gjoja kanë patur parlamentet e tyre të pavarura, por fakti është se gjithmonë kanë qenë të varur nga Anglia.

BOTIMET E HAKIKAT KİTABEVİ

GJUHË SHQIPE:

- 1- Besimi dhe Islami, 96 fq.
- 2- Libri Namazit, 208 fq.
- 3- Rrefimet e Agentit Anglez, 112 fq.

GJUHË ANGLEZE:

- 1- Endless Bliss I, 304 pp.
- 2- Endless Bliss II, 400 pp.
- 3- Endless Bliss III, 336 pp.
- 4- Endless Bliss IV, 432 pp.
- 5- Endless Bliss V, 512 pp.
- 6- Endless Bliss VI, 352 pp.
- 7- The Sunni Path, 128 pp.
- 8- Belief and Islam, 128 pp.
- 9- The Proof of Prophethood, 144 pp.
- 10- Answer to an Enemy of Islam, 128 pp.
- 11- Advice for the Muslim, 352 pp.
- 12- Islam and Christianity, 336 pp.
- 13- Could Not Answer, 432 pp.
- 14- Confessions of a British Spy, 128 pp.
- 15- Documents of the Right Word, 496 pp.
- 16- Why Did They Become Muslims?, 304 pp.
- 17- Ethics of Islam, 240 pp.
- 18- Sahaba 'The Blessed', 560 pp.
- 19- Islam's Reformers, 320 pp.
- 20- The Rising and the Hereafter, 112 pp.
- 21- Miftah-ul-janna, 288 pp.
- 22- Muslim Ritual Prayers (Kitab as-salat), 256 pp.
- 23- O Son, 352 pp.

GJUHË GJERMANE:

- 1- Islam, der Weg der Sunniten, 128 Seiten
- 2- Glaube und Islam, 128 Seiten
- 3- Islam und Christentum, 352 Seiten
- 4- Beweis des Prophetentums, 160 Seiten
- 5- Geständnisse von einem Britischen Spion, 176 Seiten
- 6- Islamische Sitte, 288 Seiten

GJUHË FRENGIE:

- 1- L'Islam et la Voie de Sunna, 112 pp.
- 2- Foi et Islam, 160 pp.
- 3- Islam et Christianisme, 304 pp.
- 4- L'évidence de la Prophétie, et les Temps de Prières, 144 pp.
- 5- Ar-radd al Jamil, Ayyuha'l-Walad (Al-Ghazâli), 96 pp.
- 6- Al-Munqid min ad-Dalâl, (Al-Ghazâli), 64 pp.

ESPANOL:

- 1- Creencia e Islam, 112.
- 2- Libro Del Namâz, 224.

GJUHË RUSE:

- 1- Всем Ну́жная Вера, (128) стр.
- 2- Признания Английского Шпиона, (128) стр.
- 3- Китаб-ус-Салат (Молитвенник) Книга о намазе, (224) стр.
- 4- О Сын Мой (256) стр.
- 5- Религия Ислам (320) стр.

GJUHË BOSHNAKIE:

- 1- Iman i Islam, (128) str.
- 2- Odgovor Neprijatelju Islama, (144) str.
- 3- Knjiga o Namazu, (192) str.
- 4- Nije Mogao Odgovoriti, (432) str.
- 5- Put Ehl-i Sunneta, (128) str.
- 6- Ispovijesti Jednog Engleskog Spijuna, (144) str.